


# DIELLI U DUK PERSERI

roman

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

154-31

216



luan  
qafëzezi

SH-31

2016

S


LUAN QAFËZEZI

R

# DIELLI U DUK PËRSËRI

(Roman)

58776



35612

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1972



## SE D R A

— Ajo — tha me vete, dhe menjëherë ngriti receptorin e telefonit.

— Jam Marta, Gjergj. Si të vete puna?

Ai u hodhi një vështrim të shpejtë akrepave të orës, që kish vendosur mbi tavolinë dhe u habit kur pa se po afronte mesnata. Pastaj:

— Ja — tha — ja edhe pak e mbarova, Martë! Veç më vjen keq që ti s'passe rënë akoma.

— Jo, jo — ja ktheu ajo ëmbël — Edhe unë gjer tani kisha punë. Posa mbarova me ditarin e nesërm.

— Sidoqoftë, edhe pak dhe erdha — tha prap ai, i lodhur dhe, duke ulur receptorin, hodhi sytë nga zyra e shefit të aparatit politik të njësisë. Por nuk pa dritë.

«Paska mbaruar» tha me vete, duke menduar punët e shumta të tij, dhe ashtu, pa fjalë, filloi t'i mblidhte ato fije letra të përhapura mbi tryezë. Pastaj i qetë e i sigurtë se askush s'kish mbetur në zyrat e asaj komande, u ngrit e doli, duke kyçur zyrën. Po me të shkelur në oborr, i zunë sytë një dritare të ndezur. I heshtur, e kundroi për një çast.

— Çudi — tha — akoma vazhdoka të punojë! Me siguri përgatitet për ndonjë material që do t'i çojë Ministrisë, o ndofta edhe për fjalën që do t'u mbajë nesër ushtarëve të rinj para betimit ushtarak.

Dhe ashtu, i heshtur, e përfytyroi duke folur komandantin e njësisë, atë njeri të dliirët e të hekurt, siç e

quante shpesh ai. Pastaj, me hap të lehtë, për mos ta shqetësuar atë që akoma po punonte, çau përmes oborrit e doli në rrugën kryesore që zbriste në qendër të qytetit.

Të nesërmen, përsëri erdhi shpejt në zyrat e komandës. Ai e kish bërë zakon të shkonte para orarit në repart.

— Ti, Gjergj? — i tha oficeri i rojës kur mbririti në postblok — Të njoha nga hapi që nga larg.

Ai i buzëqeshi.

— A ka ardhur ndonjë nga shokët? — pyeti pastaj.

— Vetëm komandanti. Edhe sonte këtu e gdhui.

Gjergj Martini s'foli, po duke e përfytyruar atë njeri gjithnjë në lëvizje e në krye të çdo veprimi të njesisë, prap tha me vete:

«Njeri i hekurt».

\* \* \*

Në ora 10 salla e madhe e repartit që mbushur plot. Fjalën e rastit e mbajti komandanti i njesisë, gjenerali lejtant Bari Progonati.

— Ai që vendos fatin e fitores në luftë, është njeriu! — u tha ai ushtarëve të rinj, që do të bënin betimin ushtarak — Dhe ju e dini: kolektivi përbëhet prej njerëzish. Ai vepron si një organizëm. Po nëse një detaj i këtij organizmi nuk punon si duhet, ai dëmton gjithë organizmin. Pra, nëse ndonjë nga ne s'ecën me të njëjtin hap me kolektivin, ai kthehet në një plagë për të, në një pengesë për kryerjen e detyrave, në një barrierë që pengon arritjen e fitores. Shkurt: ai dëmton qëllimin...

Ushtarët e rinj, të rrëmbyer nga fjala e tij, dëgjonin me vëmendje të thellë, duke i përpirë ato fraza që duke-shin herë të ashpra e herë si të gdhëndura me daltë. Po që të gjitha, si fishekë të një breshërie, binin mbi të njëjtin objektiv.

Pastaj, ushtarët në grup, njëzëri bënë betimin:

— Betohem se ...

Pas asaj ceremonie solemne, me kalimin e ditëve, se-



cili nisi t'i jepte një kuptim edhe më të thellë përmbajtjes së formulës që kish shqiptuar njëzëri përkrah shokëve: «Beto hem se...»

Tani edhe përgjegjësia gjithkuj filloi t'i dukej edhe më direkte, më e rëndë. Dhe kjo u vu re porsa nisi programi vjetor i stërvitjes. Brezi i kalitjes u kthye për ta në një shesh provash, si në luftë të vërtetë. Po jo gjithkush, që në fillim, mund t'ja delte atij brezi e asaj prove të vështirë. Shumicës së ushtarëve u binin djersë nga balli. Një ndër ta ishte edhe ushtari i ri, Gazmend Sheti.

Ai përsëri s'po mundej t'ja delte mbanë...

«Sa keq! — tha me vete — Po sikur kjo të më ndodhte në luftë? A s'do të isha një pengesë për shokët, për skuadrën, për kompaninë, siç tha komandanti i njësisë?» Dhe ndërta sytë ju errën, fytyra ju ndez pak nga pak.

Dikush e vuri re dhe i vajti pranë.

— Mos u mërzit, Gazmend! — i tha duke i hedhur krahun — Shpejt do të kalitesh, si gjithë ne të tjerët. Trriri i ekuilibrit dhe retikoli janë tepër të vështirë.

Njeriu që i fliste ishte një nga ushtarët e vjetër.

— Më beso, kalimin e kësaj barrikade unë e kam patur shumë më të vështirë sesa ti, në periudhën e parë.

Gazmend Sheti nuk i ktheu përgjigje. Ai heshte në këto raste. Po tani, në orët e lira, edhe diçka tjetër kish filluar të ndodhte me të. I zymtë dhe i heshtur, ai hiqej mënjanë, pa i thënë askujt se ku shkonte.

Duke e vënë re këtë mungesë, i shqetësuar, komandanti i nënrepartit e kërkoi midis shokëve që argëtoheshin. Po askund s'e pa midis tyre. Pyeti, por asnjë s'diti t'i thoshte se ku gjendej. Edhe të nesërmen e të pasnesërmen, po kjo punë. Përsëri asnjë s'diti t'i thoshte se ku mund të ndodhej. E kërkuan, po asnjë s'e gjeti.

— Ku ishe? — i tha në mbrëmje hijerëndë Gjergj Martini.

— Këtu, shoku komandant — tha i zymtë dhe u bë gati të zbrapsetj.

— S'është mirë që rri larg shokëve! Tek e fundit, thua j ku je, që të dimë ku të të kërkojmë! Ja, mua m'u deshe pardje, dje, sot... Por...



I bërë tym, shefi i shtabit, toger Gjetë Sokoli, nduku buzën me dhëmbë, nga që komandanti i nënrepartit, kapiten Gjergji, nuk po e çonte në arrest. «Durim prej tua-fësh!» — tha ai me vete.

Gazmendi i skuqur heshtte e priste më këmbë.

Po të nesërmen, prap po ajo punë.

Çeshtja e tij filloi të bëhej problem i gjithë repartit.

«Do të shoh se ku e shkon kohën e lirë, ky djalos!» mendoi komandanti me vete. Dhe heshtaz u largua. Po dhe Gazmend Sheti, heshtaz e pa u ndjerë, u shkëput prej shokëve të tij. Me kujdes, për të mos u rënë në sy të tjerëve, ju afrua kories pranë e pas pak, duke hyrë në të, humbi. Po këtë herë pa mundur t'i shpëtonte syrit të të gjithëve. Dikush e kish parë, dikush po e ndiqte.

— Ku do të shkojë?

Dhe ja, ai përpara e komandanti pas, bënë përpjetë.

Ushtari qëndroi. Porsa kishte hyrë në brezin e kalitjes.

— Ç'kërkon të bëjë? — mendoi tjetri që nga larg.

— Përse u ndal?

Gazmend Sheti, i heshtur, filloi të stërvitej. Ja edhe trari i ekuilibrit, që shpesh e kishte skuqur para shokëve dhe eprorëve të tij ushtarakë!

«Duhet kaluar me çdo kusht!» tha me vete. Dhe provoi. . . Por u rrëzua dhe prap u rrëzua, gjersa më në fund e kaloi. Disi me druajtje, por e kaloi.

«Duhet përsëritur!» tha dhe prapë e kaloi dhe e rikaloi atë provë të vështirë. Tani, më i qetë se më parë, pa të marrë mëndësh, më shpejt, më lehtë.

Komandanti, i strukur në zabel, mbeti i habitur. Po ushtari i ri ende s'ishte i qetë. Tani kish përpara retikolin. Dhe ai e dinte mirë se ç'do të thosh retikol.

«Sa ndryshe — tha me vete — nga ajo galeria jonë e minierës! Edhe atje duhej të zvarriteshe përtokë, edhe atje të mbushej fytyra me dhe e me pluhur të kuq, tamam si këtu, e, megjithatë, nuk skuqeshe përpara të tjerëve, nuk mbeteshe i varur në telin me gjëmba të retikolit, si ndonjë dordolec për të trëmbur laraskat që fluturojnë rreth teje!»

Dhe vërtet ishte i rëndë çasti i mbetjes në tel! Ti në hall, kurse të tjerët shkuleshin së qeshuri, gjersa ndokush vinte për të të shqitur që andej.

E tmerroi përfytyrimi i asaj skene. Dhe buza s'i qeshi, sado që sot, që me herën e parë, retikolin e kishte kaluar tej e tej. Në vetmi, ai, disi i kish dalë edhe gjatë dy ditëve të kaluara.

«Duhet përsëritur! Duhet përsëritur edhe një herë!» — tha, megjithëse me vështirësi po qëndronte më këmbë. Djersët i kishin mbuluar ballin, kurse kraharori mezi i mbushej me frymë.

Megjithatë, prapë ju vu zvarritjes me shpejtësinë që kërkonte rregullorja ushtarake.

Komandanti, i habitur, po e ndiqte që andej.

«Për mos t'u besuar! — tha më në fund me vete. — Sa fort paska përparuar brënda një kohe kaq të shkurtër!»

Po Gazmend Sheti që s'dinte se kush po e ndiqte nga zabeli, përsëri e përshkoi atë fushë të vështirë.

Vetëm në fund, mbas kalimit me sukses të asaj prove, ai, disi i lehtësuar, mori frymë thellë e u ngrit nga vendi.

Tani s'i pritej gjer të vinte e nesërmja. Përpara shokëve, do të tregonte se ishte i denjë të qëndronte përkrah kolektivit të tij. Po sikur nesër t'i merreshin mëntë? Po sikur nesër, nga druajtja, prapë të mbetej në retikol? Jo! Ajo nuk mund të ndodhte kurrë...

Dhe prapë, nga dyshimi, u sforçua për ta kaluar edhe një herë këtë provë... Por s'arriti.

— Të lumtë! Të lumtë! — dëgjoi një zë nga shkoret.

— Kush më foli? — ja bëri i stepur habie.

Tjetri gazmor ju afrua dhe e përqafoi.

Ushtari i emocionuar uli kryet. Po dhe kapiten Gjergj Martini ishte i emocionuar. Emocione të njëjta. Dhe ashtu të heshtur, me bebëzat që u xixëllonin, shikuan në sy njëri tjetrin.

— Gazmend! — i tha — s'do ta harroj kurrë këtë të papritur.



Djaloshi s'foli.

Me t'u kthyer në repart, kapiten Gjergji u tregoi ushtarëve se ku e kishte gjetur ushtar Gazmend Shetin.

Të tjerëve u erdhi keq që kishin menduar ndryshe për të.

— Më ndje! — i tha një nga shokët e rinj. Unë isha pregatitur të të kritikoj rëndë, kurse ti në këtë kohë, po hapje një rrugë të re për gjithë ne që jemi fillestarë si ti... A s'do të ishte më mirë të të ndiqnim në këtë shëmbull? — dhe heshti.

— Përse hesht? — i tha një tjetër — Çoje mendimin gjer në fund!

— Unë e thashë fjalën time — tha parafolësi — Gazmend Sheti paska ecur mjaft më përpara se shumë prej nesh. Neve s'na mbetet gjë tjetër veçse të ndjekim shëmbullin e tij. Ja, kjo është fjala, dhe ky është propozimi që kam.

Pastaj zëra u dëgjuan:

— Edhe unë e përkrah këtë mendim.

— Edhe unë.

— Edhe unë.

Të nesërmen shëmbulli i ushtar Gazmend Shetit, u kthye në një iniciativë plot vlerë.

I entuziazmuar komandanti i shtrëngoi dorën.



## H E N D E K U

Gjergj Martini e Gjetë Sokoli, megjithse shokë të ngushtë vegjëlie, në sjelljen me ushtarët ndryshonin mjaft nga njeri tjetri. Ndërsa i pari i përmbajtur e i urtë, përdorte kryesisht metodën e bindjes, i dyti, me temperamentin e tij të rrëmbyer, për çdo mungesë që shfaqej në repart, i binte shkurt, duke i kthyer sytë nga masat disiplinore a ndëshkimet për vartësit. Ato risnin që nga heqja për një muaj e së drejtës për të dalë në qytet e gjer tek arrestat e lehta apo të rënda, me ditë të pakta apo të zgjatura, të cilat ai i jepte sipas rastit dhe gjendjes në të cilën ndodhej. Po megjithëse fjalërendë kur nxehej, si dhe i ashpër në dënimet që jepte, zemrën prapëseprapë e kishte të pastër e të ndjeshme: Pas kalimit të nervozizmit, i hequr mënjanë, përbluhej brenda vetes për qëndrimet e pamatura. Kjo ish edhe arësyeja, që të dënuarit e tij, duke përjashtuar rastet e rralla, kurrë s'i vuanin plotësisht dënimet që u jepte. Ai vetë shkonte e i nxirrte para kohe. Megjithatë, nga sedra e krenaria, askujt s'ja pohonte këtë pendim, madje as edhe Gjergj Martinin, të cilin thellë në shpirt e quante jo vetëm si shokun më të ngushtë e më të mirë, po dhe si mësuesin e tij.

Tjetri, i shqetësuar, e këshillonte e i qëndronte përherë pranë. Po jeta e repartit, me problemet e telashet e veta të vazhdueshme, temperamentit të ndezur të Gjetë Sokolit shpesh i jepte flakë. Kjo ishte njera anë e medaljes, që e shtynte të anonte nga dënimet, kurse tjetra

ishite besimi që ai kishte te zbatimi me rigorozitet i rregullores ushtarake në çështjet e disiplinës. Kështu, masat e dënimit ai i quante jo vetëm të dobishme, por si mjetin kryesor për edukimin e ushtarëve, sidhe për mbarëvajtjen në përgjithësi të punës në repart. Ndaj edhe s'kursehej në dhënien e tyre. Por kjo gjendje e pandryshuar e tij e mundonte Gjergj Martinin.

— Gjetë! — i tha një ditë i tronditur — Përse kështu, more shok? Ushtria nuk është burg për ushtarët...

— Po as kazino, Gjergj, që gjithkush të bëjë sipas qejfit...

— S'më vjen mirë... Pse me këtë gjuhë? — ja bëri tjetri me keqardhje.

— Ndofta fjala ime të tingëlloi ters. Po unë s'mund t'u mbaj iso të tjerëve edhe kur mendoj krejt ndryshe nga ata. Ndaj, ja ku ta them hapur: Lëshimet e tua nuk më pëlqejnë aspak. Vlerësimi që i bërë Gazmend Shetit s'është gjë tjetër, veçse një komedi e shpëllarë. Po laraskat s'janë lindur për t'u bërë shqiponja, Gjergj! E qartë?

— Përse e quan ashtu atë djalë aq të mirë? — tha Gjergj Martini me një ton keqardhës.

— Pse ashtu është. Një hamameno e asgjë më shumë a më pak! Bile edhe i çthurur e i parregullt, aq sa jam detyruar gjer më sot ta fus për të tretën herë në arrest.

— Po a mund të më thuash, Gjetë, përse e ke futur? — tha Gjergji, duke u prishur në fytyrë.

— Pse! Ti e di mirë: për shkelje discipline. Për çrregullime në mirëmbajtjen e uniformës. A ka nevojë për më shumë? Besoj, sipas neneve, jam në rregull, në s'gabohem...

— E drejtë — tha tjetri — Mirëmbajtja e uniformës për ushtarakun ka rëndësi të veçantë. Po, megjithatë, arresti është masa e fundit, që mund të merret ndaj tij, e sidomos ndaj një ushtari të ri, ndaj një rekruti që posa e ka kaluar periudhën e karantinës. Ajo mund t'i jepet vetëm atëhere, kur ai vazhdon në të njëjtën rrugë, edhe pas këshillimeve e vërejtjeve që i bëhen me gojë. Bile, edhe pas tyre, s'mund t'i jepet menjëherë arrest, por si masë e parë i hiqet për një kohë të shkurtër e drejta e



liridaljes në qytet. Dhe tani unë pyes: A ke ecur ti në këtë rrugë? Apo në vend të masave të para këshilluese, ke përdorur të fundit: arrestin?

— Po. Me të shtururit unë i bije shkurt... I fus brenda dhe i detyroj t'u vijnë mendtë!

— Keq — tha Gjergj Martini, me një ton të prerë.

— Ndofta.

— Jo ndofta, Gjetë! Mos harro, se edhe muajin e kaluar çove mjaft në arrest. Prandaj të thashë: Ushtria nuk është burg për ushtarët. Jo, kështu nuk mund të ecet, shok! Ti duhet të pyesësh veten se ç'përfitime ke nxjerrë nga ky varg dënimesh, që ke dhënë e po jep vazhdimisht?

— Të pyes veten, the? Do ta pyes, po mbasi ai ta kryejë edhe këtë dënim që i dhashë... .

— Ai? Cili ai?! — tha tjetri, me një shqetësim të dukshëm.

— I përkëdheluri yt... Mëso, se qysh dje, është brenda! Arësyeja që se në ushtrimet e mëngjezit m'u paraqit me vonesë, kur gjithë të tjerët ishin vendosur në rrjesht. Unë s'e pranova: «Mëso herë tjetër të më vish në kohë» i thashë, dhe, pa ja zgjatur, e nisa në arrest.

— Sa keq, Gjetë! Sa keq! Ti i paske shkurtuar krahët tamam tani kur ai po përpiqet të ngrihet në fluturim! Po pse kështu, more shok? A s'të duket i gabuar ky veprim? Kujto për një çast ditët e para të këtij punëtori të nëntokës, kur na erdhi në repart! Kujto si skuqej për çdo vërejtje që i bënim, edhe kur ndonjëherë hidhte hapin gabim! Kujto si dëgjonte kryeulur... Si përpiqej e luftonte me vetveten... Por gjithënjë i heshtur e gjithënjë i pafjalë. Të lutem, shko e liroje! Dhe thuaja edhe ndonjë fjalë të mirë, po munde. Fjala e ngrohtë për të në këto caste ka rëndësi të veçantë.

— Jo, unë nuk mund të bëj një gjë që nuk e ndjej! Sot është dita e dytë. Nesër e treta. Kurse pasnesër e katërta dhe e fundit... Pra, le të ketë durim edhe pak! Pas përkëdheljeve të tua, besoj kashaisja ime do t'i bëjë mirë. E qartë?

— Gjetë! — tha ai me një habi të papërmbajtur — Po



kujt i flet ti me këtë gjuhë e me këtë nëntekst? Kë kërkon të fyesh e kundër kujt kërkon të hakmerresh?

— S'kam ndërmend të fyej njeri. E as të hakmerrem... Po as të lejoj të tjerët të më japin mësim për gjëra që dihen e që komanda i ka përcaktuar me anë rregulloresh. Ndaj në këtë rast, mësim e ligj për mua është vetëm zbatimi i tyre. Kush nuk i zbaton, sipas meje, cilido qoftë ai, nuk është aspak në rregull me komandën e me ndërgjegjen. . .

Gjergj Martini u nxi në fytyrë. Gjeta e vuri re. Ai e njihte mirë. Rastet e tilla ishin shumë, shumë të rralla, për të.

— Të kesh turp — tha ai i prerë e i fyer rëndë.

Dhe s'foli më, po duke nxjerrë një fletë-arresti, diçka shënoi para syve të tjetrit, që i qëndronte përballë.

Gjetë Sokoli u bë flakë në fytyrë.

— Toger Gjeta! — tha tjetri — Ju, para një jave, kini ardhur me vonesë në repart, duke shkelur orarin zyrtar, pra, edhe disiplinën ushtarake. Unë ju hoqa vëmendjen në mënyrë shoqërore, mbasi ushtarët e mbledhur ju prisnin vetëm juve, për të filluar stërvitjen. Para katër ditësh, ju e përsëritët këtë shkelje, e po ashtu edhe sot. Ç'dënim i propozoni ju vetes? Numrin e ditëve të arrestës si dhe llojin e arrestës: të lehtë apo të rëndë, e kam lënë bosh. Ju jap të drejtën ta shënoni vetë. Ju rregulloret i njihni mirë; siç e pohuat edhe vetë pak më parë.

Ishte e para herë që ai i përmendte gradën «toger» e i thërriste me «ju!»

I maramëndur nga ajo e papritur e çuditshme, Gjetë Sokoli u drodh. Pastaj, jo një hendek, por një humnare ju duk sikur u hap midis tyre. E, megjithatë, prapë s'i besohej, prapë i dukej e pamundëshme ajo që ishte duke ngjarë. Dhe ashtu i hutuar, ai kish mbetur i ngrirë më këmbë.

Po Gjergj Martini, përballë tij, akoma qëndronte i zymtë e i prerë, si ndonjë statujë e derdhur në bronz. Gjeta e vuri re. Vështrimi i tij ishte i mprehtë e ngulitës. E tronditi ai vështrim, ajo heshtje kuptimplote, që fliste e godiste në të njëjtën kohë.



Por kjo gjendje nuk zgjati. Zëri i tjetrit e zgjoi.

— Merreni, toger Gjeta! — i tha, duke i afruar fletën e arrestës. Mendojeni me qetësi dënimin që ju takon. Ju thashë: Ju i njihni mirë rregulloret, nen për nen. Fletën për firmë do të ma bëni gati, një orë më vonë.

Dhe ashtu i vrenjtur, Gjergj Martini u ngrit e doli jashtë.

Gjetë Sokolit ju duk sikur një rrufe shkrepri atë çast dhe sikur e tërë ajo ndërtesë u përmbys tej e tej.

— E çuditshme! — tha me tronditje të thellë. Dhe prap, ai hendek i hapur, ju duk si ndonjë humnerë pa fund, buzë së cilës ai qëndronte i topitur e i hutuar.

Dhe ashtu e gjeti edhe Gjergj Martini, kur u kthye mbas një ore në zyrë! Fytyra e tij nxinte.

Tjetri e pa dhe e kuptoi. Nuk ishte më ai Gjeta i herëve të shkuara dhe as ai Gjeta i një ore më parë. Tani, i heshtur e i hutuar, priste më këmbë vetëm një firmë për atë fletën me të cilën do të paraqitej në garnizon. Pastaj, sipas dënimin të rëndë që i kishte dhënë vetes, një oficer kish për ta çarmatosur atje dhe, mandej për pesëmbëdhjetë ditë rrjesht, do të strukej i vetëm në ndonjë nga ato dhomat gjysëm të errëta të izolimit në garnizon. . .

«E tmerrshme!» mendoj me vete. Si? Deri këtu arriti puna, apo më mirë ndarja midis nesh?!»

Dhe në atë përhumbe, ju bë sikur u çel ajo derë burgu... dhe një hendek edhe më i madh u hap dhe e ndau nga repartit e nga Gjergj Martini. Ai nguli vështrimin mbi atë hendek. Dhe për çudi, hapësira e thellimit të tij, në çast ju bë sikur mori përpjestime të çuditshme.

«Humnerë» tha me vete, dhe përsëri ju duk sikur ai e Gjergj Martini tani qëndronin në brigjet e kundërt të atij honi të porsa hapur, që thellohej vazhdimisht.

Tjetri, i vrarë e i menduar, duke ju afruar tavolinës, e mori në duar fletë-arrestin. Gjetë Sokoli i kish dhënë vetes dënimin maksimal që mund të jepej në raste të tilla.

Tani gjithshka kish marrë fund... Pritej vetëm një firmë. Me këto mendime në kokë, Gjeta priti që ai të merrte penën.

Po tjetri hijerëndë, duke qëndruar më këmbë para tavolinës e palosi më dysh atë letër dhe e bëri copë.

— Gjetë! — tha pastaj — po më kërkoi njeri, jam te shefi i aparatit politik të njësisë.

Dhe i menduar e i vrrarë në shpirt, doli jashtë.

Gjetë Sokoli shtangu dhe s'tha dot asnjë fjalë.

Kjo ishte e para e çarë midis tyre...

Pastaj duke e ndjekur me sy Gjergj Martinin që largohej, ju bë sikur ajo humnera, megjithëse filloi të ngush-tohej e të ngush-tohej shumë, prapëseprapë mbeti si ndo-një hendek i gjerë, si ndonjë e çarë e thellë para tij.

Dhe ai u drodh nga ajo e çarë. Dhe ashtu i përhumbur, solli në kujtesë tërë të kaluarën me të...



## E KALUARA

Ata lindën në brigjet e Bunës dhe u rritën diku në një nga fshatrat e krahinës së Velipojës, rrethuar nga një mori liqenesh të vegjël piktoreskë. Jo fort larg këtij katundi, në Mali-Kolaj, një mal i vogël që ngrihet rrëzë fushës së Baks-Rjollit, lindi e u rrit edhe ai që do të quhej më vonë heroi i Kelmendit, Nikë Pjetër Deda. Afërsia e të dy katundeve, sidhe shkolla e përbashkët, i bëri shokë të pandarë që në vegjëli.

— Gjergj e Gjetë! — u thosh Nika — A ngjitemi mbi Mali-Kolaj?

— Po, Nikë.

— Do të vij edhe unë me ju — i luste Marta Prendi, shoqe e tyre e klasës. Pastaj, gazmorë, në pikë të vrapit, të katër të vegjëlit i viheshin majës. Po kush do të arrinte i pari ndërmjet tyre?

Si gjithnjë, aty nga mesi i rrugës, Gjetë Sokoli mbetej pas. Edhe Gjergji deri diku, kurse ajo që e ndiqte këmba këmbës Nikë Pjetrin, ishte Martë Prendi.

— Na u larguan fort! — i thoshte Gjergji Gjetës dhe prapë, duke marrë frymë me zor, mudohej t'u afrohej sa më shumë. Po, ndërkohë, Nikë Pjetri delte mbi majë e që andej fillonte t'i ngiste të dy shokët.

— E kini marrë revan! — u thoshte. — Ngadalë, se mos ju pushon zëmra!

Gjergji qeshte dhe, pa e ndalur çapin, rendëte drejt majës, kurse Gjeta, i ndezur flakë, brehej nga sedra e fortë që e mundonte. Pastaj të katër sëbashku, duke e

parë detin së larti, mahniteshin nga gjerësia dhe kaltërsia e tij! Sa afër u dukej Adriatiku! Dhe me të vërtetë, afër ishte. As tre kilometra s'bëheshin gjithë gjithë. Dhe Nika, Gjergji e Gjeta, e ngandonjëherë edhe Marta me ta, shkolinin gjer atje për t'i parë së afërmi ato valë të kaltëra që niseshin së largu e mbrinin dalëngadalë në breg. Dhe jo vetëm deti, po dhe liqejt e vegjël e të shumtë e ato fusha të bleruara të krahinës, i habitnin me bukurinë e tyre të rrallë.

— Shikojeni! A ka gjë më të bukur? — u tha një ditë Nika i përhumur në atë panoramë të mahnitshme të vendlindjes.

— S'nginjem duke e parë — tha edhe Gjergji — Edhe im vëlla kështu thotë: «Rrallë gjen vise si Velipoja jonë.»

Ai përmendi të vëllanë, se të jatin Gjergj Martini s'ëmbante mend mirë. Atë ja kishin vrarë vite më parë kleri dhe diversantët.

— Edhe im atë, — shtoi Gjeta — kështu thotë për Velipojen...

Pas këtyre fjalëve, të vegjëlit heshtën për një çast. Por ata ende s'i njihnin të gjitha bukuritë e atdheut të tyre. E megjithëse kishin lindur në krahinën e Velipojës, familjet e tyre s'ishin prej kësaj zone. Të parët e tyre rridhnin prej Malësisë së Madhe. Ata e quanin veten gjithmonë kelmendas.

Prindët e Nikës, e po ashtu ata të Gjergjit, Gjetës e të Martës, si mjaft të tjerë, me një pjesë të familjes verën e kalonin në ato male. Shkonin për të nxjerrë bagëtinë në bjeshkë. Po ja tani, Nika, Gjergji, Gjeta e Marta ishin rritur. Ata, plot kureshti, pyesnin për ato anë. Dhe etërit u tregonin për ato male ku kishin lindur, kishin jetuar e luftuar të parët e tyre.

— Baba! — i tha një ditë Nikë Pjetri — a është i bukur Vermoshi?

Tjetri u çel në fytyrë, pastaj, me hollësi i foli për bukuritë e atyre anëve, ku ende shquheshin trojet e gjyshërve të tyre.

— Vitin e ardhshëm do të më marrësh edhe mua,



besoj? — ju lut djali. Mësuesi na ka folur për Vermoshin, po unë kam dëshirë ta shoh me sy vendin dhe shtëpinë ku ke lindur ti.

Pjetër Deda, i habitur nga ato fjalë, e shikoi drejt të birin.

— Mirë — i tha — Po ti akoma je i vogël, Nikë! Vermoshi është katër ditë larg që këtej dhe rruga është tepër e vështirë.

— S'ka gjë — tha djali — unë duroj, baba!

— Po shkollës? Shkollës, si do t'ja bësh? Ne kthehemi në të hyrë të dimrit, kurse këtu mësimet nisin në shtator. Bile që ditën e parë.

Djali u step e s'po dinte si t'i përgjigjej.

— Po pse — tha me angushti — atje s'ka shkollë?

— Ka — tha Pjetër Deda — Po për shkak të të ftohtit të madh, shkolla është verore. Hapet në pranverë, kur zë të ngrohet moti dhe mbyllet në të nisur të dimrit. Atje është malësi, Nikë. Vermoshi është dymijë metro mbi sipërfaqen e detit, kurse Mali-Kolaj as dyqind.

— Ahere aq më mirë — tha djali — Do të vazhdoj atje edhe këtu. Vetëm në mos më pranofshin. . .

Pjetër Deda buzëqeshi. Atë e habiste shkathtësia e të birit.

— Mirë — i tha më në fund. Do të shohim gjer ahere dhe, duke e rrokur ndër krahë, e puthi.

I lumtur, Nikë Pjetri, vrapoi te shokët e tij për t'u folur rreth bisedës që kishte pasur me të atin.

Ç'prej asaj dite, për disa muaj me radhë, Vermoshi u bë ëndrra e tyre e përbashkët. Kështu, kur erdhi dita e nisjes për të nxjerrë bagëtinë nër bjeshkë, të tre të vegjëlit s'ju ndanë prindërve të tyre.

Dhe ata i muarrën.

Udhëtimin, si çdo vit, e bënë bashkë. Me të dalë mbi Leqet e Hotit, Malësia e Madhe u shfaq para tyre me tërë madhështinë e saj. Çfarë malesh! Sa i vogël u duket tani Mali-Kolaj i tyre! Bjeshkë e ngado bjeshkë!

Dhe një ditë, në mbrojtje të atyre bjeshkëve, përkrah kufitarëve, duke u ndeshur me një grup diversantësh, ra Nika, komandanti i ndjekësve të vegjël.

Kjo ndodhi në vitet '50, një mbrëmje të bukur vere. ... Po që atëhere kishte kaluar një kohë e gjatë. Tani edhe Gjergji e Gjeta s'ishin më nxënës të shtatëvjeçareve në Velipojë a Kelmend e as Skënderbegas të vitit të parë, si dikur, po kursantë të vitit të tretë e të fundit të Shkollës së Bashkuar «Enver Hoxha». Shkollë e vështirë. Dhe në ato vështirësi, Gjetë Sokolit shpesh i kujtohej Nika:

«S'ka majë që arrihet pa përpjekje, Gjetë! Kush thyhet a tërhiqet, ai ndahet nga shokët e tij!» — Dhe Gjeta, si atëhere kur me durim ushtrohej për t'ju ngjitur kodrës së Mali-Kolajt, për të vrapuar përkrah shokëve deri në breg të Adriatikut, për t'u ngjitur majë pemëve me shpejtësi si ata, për t'u dalë liqejve të vegjël të Velipojës tej e tej, po ashtu, edhe tani, duke kujtuar ato fjalë, mundohej të mos u ndahej shokëve në mësimet a stërvitjet ushtarake, sado të vështira të ishin ato.

E në këto përpjekje, ai ndjente, në çdo hap përkrahjen e kujdesin e Gjergjit.

Te Gjergji ai kishte njohur gjithmonë shokun më të mirë, vëllanë më të madh. E çudiste vetëm dishka. Përse Gjergji vjete me radhë, e sidomos kohët e fundit, ja kish përmendur shpesh emërin e Marta Prendit. Përse ata vazhdimisht i shkruanin njeri tjetrit. Disa prej atyre letrave i kishte lexuar edhe ai vetë, Ndofta s'kish parë asgjë të keqe, por, megjithatë, hera herë një ndjenjë e heshtur i qe dukur sikur nxirrte krye nëpër to. Mos ndofta ajo ishte shkëndia e ndonjë flake të nesërme?

— Ku ta dish! — thoshte me vete. Ja forconte më shumë këtë mendim edhe puna e atij stilografit dhuratë, që Marta Prendi i dërgonte Gjergjit. «Pranoje këtë dhuratë nga mësuesja e re, që porsa mori rrogën e parë. Po ta dërgoj, që duke shkruar me të, ta kujtosh sa më shpesh miqësinë tonë ...»

Kështu i shkruante ajo. Dhe këto e çuditnin Gjetë Sokolin. Të ishte e vërtetë që ata duheshin? Po nëse ishte kështu, pse Gjergji s'i kishte folur atij? Ai ishte njeri i hapët dhe me zemër në dorë ndaj shokëve. E sidomos ndaj tij...



Kështu mendonte. Dhe prapë, megjithë kureshtjen, i vinte zor ta pyeste.

— Jo, jo. Po të ish gjë, do të ma thoshte ai vetë.

Dhe s'e pyeti asnjëherë. Po dhe Gjergji në vetvete ende s'dinte mirë se ç'po ndodhte me të. Ai gjithmonë diçka kish ndjerë për Marta Prendin. Po këta dy vitet e fundit kjo lidhje midis tyre qe bërë më e afërt, më e fortë. Sidomos gjatë verës së kaluar. Ajo vinte shpesh në shtëpi të tij. Ashtu si shkonte edhe ai tek ajo. Në ato ditë, ishte bërë edhe festa e krahinës së tyre, ku midis atij gëzimi popullor, një fotograf i ardhur nga qyteti, i kishte marrë në dy poza pranë e pranë. Qeshnin, duke e parë në sy njeri tjetrin. Në ato fotografi kish edhe të tjerë, po disi pak mënjane qëndronin këta të dy prej të tjerëve.

Megjithatë, as Marta e as Gjergji, nuk dinin t'i kish fotografuar njeri në këtë festë. Gjergjit i ranë në dorë rastësisht. U gëzua shumë, po prap i erdhi keq që aty, midis tyre, kish edhe të tjerë. A s'mund të veçoheshin ata prej të tjerëve? A s'mund të mbeteshin ata të dy, dhe vetëm ata të dy, në ato fotografi?

Dhe ashtu, një ditë, ju lut njerit prej fotografëve që grumbulloheshin në sheshin «Skënderbej» të kryeqytetit.

— Mos ki merak — i tha tjetri. Këtu veçimi bëhet pa vështirësi. Kur t'i shohësh të zmadhuara, do të kuptosh se ç'fotografi janë këto.

Dhe vërtet, ai kishte bërë një punë shumë të kujdesëshme e të pastër.

— Punë për merak — thosh Gjergji.

Ja, kështu kish ndodhur. Që atëhere ato dy copëza fotografish, në format kartoline, Gjergj Martini kurrë s'i kish ndarë nga portofoli, që mbante në xhepin e brendshëm të xhaketës. Në orët e lira, i veçuar nga të tjerët, shpesh i nxirrte dhe i shikonte.

«Qesh!» thoshte me vete. Dhe i vinte mirë që ajo qeshte në ato copëza letre, ashtu siç ish edhe në jetë: gazmore dhe e çiltër.

Pastaj, me kujdes, prap i fuste në portofol, sapo dëgjonte një zë të njohur që e thërriste: «Gjergj! Gjergj!»

— Gjeta! — thosh, dhe bënte drejt tij. Gjeta kish nevojë për ndihmën e Gjergj Martinit. Barrën e shkollës së re, si në dy vitet e para e, aq më tepër në të fundit, Gjetë Sokoli e kishte ndjerë shumë.

Po megjithatë, asnjëherë s'ishte thyer, asnjëherë s'e kishin lëshuar fuqitë. Dhe, ç'ish e drejta, ndryshimi midis shkollës «Skënderbej» dhe «Shkollës së Bashkuar» me të vërtetë ishte i madh e i ndjeshëm. Kështu, nëse në të parën, stërvitja ushtarake zinte një vend të kufizuar në programin e përgjithshëm shkollor, këtu ajo përbënte pjesën dërrmuese të këtij programi. Nëse atje mësoheshin çështjet fillestare të artit ushtarak, këtu bëhej perfeksionimi, duke u mësuar me themel arti i të luftuarit, arti i luftës sonë popullore, në koordinim me artin ushtarak modern; nëse atje ishte e mjaftueshme të dije si përdorej pushka e pistoleti, automatiku e mitrolozi i lehtë, këtu duhej të bëheshe mjeshër i përdorimit të të gjitha armëve, sipas specialitetit të repartit ku do të bëje pjesë. Dhe po ashtu, s'mund të bëhej asnjë krahasim midis stërvitjeve të atjeshme dhe këtyre të këtushmeve, që bëheshin gjatë ciklit trevjeçar shkollor. Stërvitje të vështira. Stërvitje taktike, ku veprohej në situata rrethimi e daljeje nga rrethimi; luftimi në mësymje e luftimi në mbrojtje, e të tjera e të tjera si këto.

Edhe volumi i gjithë kësaj pune e habiste Gjetë Sokolin. Vazhdimisht qitje. Vazhdimisht alarme, marshime, kalitje fizike. E në të gjitha këto të skuqej fytyra po të mos qëndroje në lartësinë e kërkuar. Ti do të ishe oficeri i nesërm. Ai që do t'u printe në luftë të tjerëve. Ai që do të kish të bënte drejt për së drejti me fatin e tyre, me jetën e tyre.

Dhe Gjeta mendohej.

«Detyrë e lartë po e vështirë».

Dhe ashtu kishte vazhduar gjer në fund të betejës. Ndofta me zikzake, po pa thyerje, pa tërheqje.

— Gjergj! — i kish thënë gjatë ceremonisë së gradimit dhe ndarjes së diplomave. — S'do ta harroj kurrë këtë që bëre për mua... Ti...



— Asgjë më shumë se detyrën, Gjetë! — i qe përgjegjur tjetri; dhe duke e parë në sy shokun e kish përqafuar.

---

Befas një trokitje e fortë u dëgjua në zyrat pranë. Gjetë Sokoli, gjysëm i përhumbur, u shkund e ju shkëput atij vegimi të bukur. Kelmendi, Velipoja e Shkolla e Bashkuar ju mjegulluan menjëherë. Pastaj me trishtim, pa se në zyrë akoma qëndronte i vetëm. Tamam ashtu siç e kish lënë Gjergj Martini, me atë hendekun e madh para tij...

## D R E J T M A J A V E

Mendimi i shfaqur, që çdo repart t'i siguronte bukën e ushqimet vetë, e kish shqetësuar mjaft toger Gjetë Sokolin. Ai vriste mëndjen:

«Cila ushtri në botë nuk mbahet nga populli? Cili ushtar në kontinente nuk është barrë për masat punonjëse të fshatit dhe qytetit?» Megjithatë, sadoqë në gjithë botën ishte kështu, Komiteti Qëndror i PPSH po bënte thirrje për të çarë në një rrugë krejt të re e të panjohur. Dhe ajo thirrje, për Ministrinë e Mbrojtjes menjëherë ishte kthyer në një flamur sulmi. Megjithatë, toger Gjetë Sokoli mendohej i shqetësuar:

«A do të jetë e mundur t'i dilet mbanë? E vështirë... Edhe ushtarë, edhe bujq? Po ku është parë ndonjëherë? Askund!»

Dhe ky mendim, gjatë gjithë javës së parë, shpesh e kishte bërë ta priste syhapët dritën në shtrat. Ai kishte sedër. Kishte ndërgjegje ushtari. Detyra e ngarkuar, barra e marrë përsipër duhej çuar gjer në fund. Po a ishte e mundur që një njeri si ai që s'merrte erë nga toka t'ja dilte tej kësaj vale? Ndofta ndokush do të thoshte: «Ti je bir bujku, Gjetë Sokoli!» Po ç'rëndësi kishte kjo kur ai ishte shkëputur që fëmijë nga bujqësia, nga ara e e nga fara, nga traktori e nga kau? Ahere, si do drejtonte ai, në atë nënrepart? E po kështu edhe të tjerët. Ata kishin kryer studime, jo për agronomë, po për t'u bërë inxhinjerë armësh, mjeshtra betejash, arkitektë të artit ushtarak.



Kjo ishte e vërteta. Dhe kjo, në ato ditët e para që i dukeshin aq të gjata, po e mundonte shumë.

— Gjetë! — i tha Gjergj Martini, duke e vënë re gjendjen e tij të shqetësuar — Kam ditë që të vërej. E përherë e më shumë më dukesh i menduar. Të pyes si shok: Ç'farë ke?

Gjetë Sokoli, që s'ish mësuar t'i fshihte mendimet e tij, i foli hapët.

Tjetri uli kryet e s'u ndje.

— Përse s'më përgjigjesh? — i tha oficeri vartës.

— Se ajo brengë, Gjetë, më mundoi një javë të tërë edhe mua — tha komandanti i nënrepartit. Pastaj, rreth këtij problemi, pata një takim e rrahje mendimi me komandantin e njisisë. Biseda me të më lehtësoi fort, më çliroi nga ai ankth. Me këtë, s'dua të them se ajo që na pret nuk është e vështirë. Por, sidoqoftë, ai më foli me zemër në dorë edhe për detajet e kësaj beteje. S'di, Gjetë, po atë besim të tij, tani më ngjan sikur e ndjej edhe unë! — dhe shtruar, ai i foli për tërë atë bisedë, për betejën e ashpër që i priste, për vështirësitë që do t'u delnin përballë, gjatë asaj ndeshjeje e, pastaj, edhe për mundësitë e perspektivën.

I heshtur, Gjetë Sokoli e dëgjoji me vëmendje. E, në atë heshtje, shpesh i dukej sikur i shfaqej i gjallë komandanti i njisisë: i hekurt e dinamik, si një flamur që gjithnjë çan përpara. Ai kish dëgjuar shumë rreth së kaluarës së këtij njeriu me vullnet të hekurt. Po dhe vetë kish patur rast ta njihte atë në çaste të vështira, gjatë stërvitjeve e lojave ushtarake, në ditë dimri e acari, kur ndonjë pjesë shokësh, të drobitur kishin mbetur rrugës. Po ai, përkrah tyre, me fjalë e vepër shpesh ishte bërë për ta shembull i lartë qëndrese. Dhe pastaj, edhe ajo pjesë shokësh, duke gjetur energji të reja në vete, kish bërë përpara përkrah kolektivit.

Por vallë, tani, mos ndofta, edhe ai vetë, Gjetë Sokoli, ish një ndër ata që po mbeteshin pas të tjerëve? Një ndër ata, që, me ngurrimet e tij, mund t'i bëhej pengesë këtij marshimi të madh të kolektivit?

U zbeh, duke e menduar këtë. Pastaj:

— Jo! — tha — Partia i ka menduar të gjitha. Ajo kurrë nuk hyn në beteja e papregatitur...

I çelur në fytyrë, Gjergj Martini i hodhi krahun.

Mbas pak ditësh nënreparti mori urdhër të ngjitej në kuotën 2026 metra. Me vendim të komandës. ai do të hapte për të parën herë në shekuj, tokat e asaj rrafshnalte. që në jetë gjithmonë kishin mbetur djerrë.

\* \* \*

Nëndor. Fund nëndori 1965.

Kish filluar ngrica. Majat qenë zbardhur. Era me acar frynte e të ngjethte fytyrën. Në një ditë të tillë kur s'pritej, erdhi në atë krahinë malore një ekip i lartë ushtarakësh, i kryesuar nga vetë Ministri i Mbrojtjes Popullore. Ardhja e tij, e sidomos ngjitja në lartësinë mbi 2000 metra të zonës ku mendohej të fillonin punimet për hapjen e tokave të reja, e kish rritur akoma më tepër besimin tek ushtarakët dhe kish bërë që ata ta kuptonin edhe më thellë rëndësinë politike dhe ekonomike të kryerjes së kësaj detyre partie.

Pas largimit të ekipit, drejtimin e kësaj pune të vështirë e kish marrë në duar vetë komandanti i njisisë, gjeneral Bari Progonati. Bile ai kish qënë i pari, që kish shkelur mbi atë kuotë me një grup ushtarakësh. E pastaj, edhe nënreparti i komanduar nga kapiten Gjergj Martini, bashkë me një grup traktoristësh. Rrugë e vështirë. Sidomos ç'prej atij qytetit malor e deri në kuotë. Megjithatë, mbas një seri peripecish, të dymbëdhjetë traktoristët, bashkë me nënrepartin, arritën në rrafshnaltë. Komandanti i njisisë u doli përpara, duke i rrokur në qafë ushtarakë e civilë. Pastaj biseda mori shtruar. Ai pyeste dhe ata i tregonin për peripecitë e asaj rruge të vështirë. Po sado që flitej për mundime e vështirësi, komandanti i njisisë vuri re se, ndër ta, besimi për arritjen e atij objektivi ishte i plotë.

Dhe ai, i gëzuar, u çel në fytyrë. Pastaj, shkoqur, siç



e kishte zakon, si partizanëve dikur, u bëri të ditur gjithë vështirësitë që i pritnin.

— Shokë! — tha — Le ta quajmë këtë takim të parë, një mbledhje të shkurtër pune. Dikur, në kohën e luftës, në mbledhjet tona, caktohej një rend dite. Po nër pikat e këtij rendi, njera nuk lëvizte kurrë. Ajo ishte: «Gjendja e jashtme dhe e brendshme». Le ta vëmë edhe ne në rendin tonë të ditës këtë pikë. Pra ja gjendja: maja malesh, dimër, furtunë, borë... Nga ana tjetër: tokë e pahapur. E përballë këtyre: thirrja e Partisë dhe zëri i Atdheut, që na ftojnë për të shfrytëzuar çdo pëllëmbë toke, për të siguruar bukën në vend. Dhe patatja është bukë. Kjo është gjendja e brendshme, kurse e jashtëmja: rrethin armik: imperialisto-revizionist, me imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë në krye, që e kanë halë në sy vendin tonë socialist. Ja pra, thjesht, kjo është situata dhe kjo detyra! Për ne komunistët dhe ushtarakët, si çdo urdhër, kjo thirrje e Partisë dhe e Komandës është e shenjtë dhe ne do ta kryejmë me përpikmëri, cilatdo qofshin kushtet e vështirësitë e natyrës. Tani, pres të dëgjoj fjalën tuaj, shokë traktoristë e buldozeristë!

— Jam komunist, e dikur kam qënë edhe partizan. Sot pak i shkuar në moshë, po veten prap e ndjej ushtar — tha një prej tyre, duke u skuqur në fytyrë. — Sidoqoftë, koha do ta tregojë, po unë mendoj se flas edhe në emër të shokëve, edhe në emër të t'imit birit, që kam marrë me vete se, asnjë vështirësi natyre apo terreni, nuk do të na zbrapsë, sado e ashpër dhe e egër që të jetë ajo.

— Fjala e tij është edhe e jona! — tha dikush prej tyre.

— Shoku Dedë është brigadieri ynë — shtoi një tjetër. Komandanti i njësisë ju shtriu duart atyre djemve entusiastë dhe, gazmor e inkurajues si përherë, rroku nër krahë brigadierin dhe ish partizanin Dedë Maranaj.

Atmosfera që ngrohur. Edhe lodhja e ngrica e fillimit sikur ishin mërguar nga fytyrat e djemve. Komandanti i njësisë urdhëroi një nga vartësit, që të ardhurit të pajiseshin që të gjithë me kapota, peliçe e kokore,

t'u jepej norma e konjakut për t'i qëndruar të ftohtit në punë, t'u sigurohej ushqim i bollshëm, zjarr në orët e lira, si dhe mbulesa të mjaftueshme, për të fjetur ngrohtë.

Mirënjohës të dymbëdhjetë civilët e falënderuan komandantin. Pritja e përzemërt dhe ai trajtim i ngrohtë shoqëror u kish pushtuar mëndje e zemër. Pastaj ata u ndanë, po kujdesi i tij që nga çasti i parë i mbriajtjes e deri tek i fundit, edhe kur ndodhej larg, i ndoqi hap pas hapi. Dhe ata, këtë kujdes e ndjenë çdo ditë, çdo orë, çdo çast.



## D U E L M E V D E K J E N

2 dhjetor.

Nënreparti ushtarak, me grupin e traktoristëve, posa i kishte filluar punimet për të pluguar djerrinat shekullore të asaj rrafshnalte, që i kalonte të 2000 metrat mbi sipërfaqen e detit. E kjo punë po bëhej në mot tepër të keq... Bora e dy ditëve të para, kish filluar të shpeshohej në mënyrë të çuditshme. Trashësia mbi rrafshnaltë ishte rreth një metër.

Komandanti, gjeneral Bari Progonati, që po i qëndronte në krye kësaj beteje të vështirë, duke parashikuar ditë edhe më të këqia, urdhëroi që të shpejtohej ardhja e rezervave me ushqime e karburant. Për këtë qëllim, ai dërgoi me urgjencë edhe kapiten Gjergj Martinin. Dy ditë më vonë, një autokolonë e përbërë prej gjashtë makinash të ngarkuara me ushqime, si dhe një çisternë me karburant, u nisën nga qyteti malor drejt rrafshnaltës së Shishtavecit. Po rruga ishte e keqe. Malore fillim e mbarim. E ngushtë e gjithë gropa. Vendësit thoshin se dhe në verë, ajo distancë prej gjashtëdhjetë e pesë kilometrash, ishte e vështirë, për t'u përshkuar me automjet. Traseja e hapur tri ditë më parë nga buldozerët e traktorët, që u ngjitën pas komandantit të njësisë, as që dukej gjëkund. Tej e tej ajo zbardhte e mbuluar nga trashësi të ndryshme bore, ku sipas kthesave e grykave, era kish bërë punën e saj. E, megjithatë, sërish fqollat e bardha

s'rreshnin së rëni që lart, ndërsa tufani që vinte nga jugu me një ulërimë të marrë, ngrinte përpjetë vandakë bore nga ai masiv i bardhë e ua përplaste makinave në ngjitje, në kalim. Dhe sa e ngadaltë dhe e rrezikshme që ajo ngjitje! Në krye të autokolonës printe vetë komandanti i nënrepartit, kapiten Gjergj Martini. Ai, bashkë me shefin e shtabit toger Gjetë Sokolin, kishin zënë vend pranë shoferëve në makinën e parë dhe të fundit të autokolonës, duke i udhëzuar e duke ju dhënë zemër për t'i qëndruar asaj vështirësie me të vërtetë të egër.

— Kujdes! Edhe pak... edhe pak e arritëm...

Po djaloshi në timon ishte zbehur. Mbas 16 orësh udhëtimi, autokolona s'kishte bërë as gjashtëdhjetë kilometra, gjithsej. Qenë nisur në ora tetë të mëngjezit e tani po afronte mesnata. Sa ndërprerje gjatë asaj rruge e sa ndalje për hapjen e borës në gryka e kthesa! Vazhdimisht pushime për të marrë pak frymë, për të ngrohur duart e ngrira, këmbët e bëra kallkan... Po bora s'kish të pushuar, e as ai tufan i marrë, që dukej sikur kërkonte ta përpinte autokolonën në ngjitje...

— Ndal! — i tha komandanti i nënrepartit shoferit që kish për krah — pa të shohim a na ndjek autokolona?

Shoferi frenoi. Po asnjë zhurmë s'u ndje nga pas, dhe asnjë dritë s'u duk gjëkund. Zhurmën e makinave e mbyste klithma e fuqishme e atij murlani të egër, kurse dritat e makinave, mjegulla e fortë që tanimë zotëronte ngado. I shqetësuar, kapiten Gjergj Martini zbriti nga makina dhe thirri me sa mundi:

— Shokë! Shokë!

Përsëri asnjë përgjigje, asnjë zhurmë, asnjë dritë...

— Ç'po ndodh kështu? — i tha shoferit.

I habitur, ai e la timonin dhe duke u hedhur në tokë, i thirri në emër shoferit të makinës që vinte mbas tij...

— Vesel! Vesel!

Po askush s'u përgjegj, përveç klithmave të atij tufani të çmëndur. I shqetësuar, komandanti i nënrepartit zbriti.



— Prit! — i tha shoferit, dhe vetë, me një elektrik në duar, bëri tatëpjetë në drejtim të autokolonës së shkëputur. Po tufani e rrëzoi. Me zor u ngrit. Tanimë s'po dinte nga ish drejtimi. Mjegulla e dendur ja erri sytë. Thirri:

— Gjetë! Gjetë! Gjetë!

E pastaj: Vesel! Vesel!

Po as oficer Gjetë Sokoli e as shofer Vesel Dedaj s'e dëgjuan atë thirrje. Qëlloi me automatik, po prapë s'mori përgjigje. Ulurimat e erës i mbytën që në lindje edhe krismat e automatikut.

— E çuditshme! — mendoj dhe, me durim, duke vëzhguar me elektrik dore, u mundua të gjente drejtimin. E gjeti dhe prap ju vu rrugës për të kërkuar autokolonën. Eci edhe pak dhe ja, pas një kthese, vargu i makinave po zvarritej me një gulçim të rëndë. Si i çliruar nga ai ankth mbytës, u qas te xhami i shoferit të automjetit të parë e i thirri.

— Po ku jeni, more?

— Kalohet me shumë zor, shoku komandant — përgjegji tjetri që brenda.

— Durim! Durim! Edhe pak e arritëm! — e, duke i dalë përpara automjetit, u mundua të shpejtonte hapin për te makina e tij.

Autokolona u bashkua. Po rruga nuk kishte marrë fund. Ankthi vazhdoi. Përsëri ndërprerje. Përsëri ndalesa. Tani edhe dy kilometra në orë ishte e vështirë t'i bënte ajo autokolonë e raskapitur në marshim. Nga tufani i rreptë e mjegulla e dendur, dritat e makinave po thuaj me zor dukeshin gjer në pesë metro largësi.

— Të udhëtohet me masa të forta sigurimi! — urdhëroi Gjergj Martini. — Përpara çdo makine të dalë nga një oficer ose ushtar, për të udhëzuar shoferin. Distanca midis makinave të mos jetë më tepër se tre gjer në katër metra.

Dhe marshimi prap filloi. Por ja, aty nga ora dy e mëngjezit, kalimi u bë i pamundshëm. Tufani, duke rrahur me tërbim nga jugu, dukej si një përbindësh me kthetra gjigante që përpiquej të gozhdonte në vënd autokolonën, kurse mjegulla tanimë ish ngritur si një mur i

pakalueshëm. Të ftohtit, disa gradë nën zero, të merrte frymën.

— Shoku komandant! — i tha shoferi — Po më merrren mentë. Këmbët s'i lëviz dot mbi pedale, kursë duart e trupi më kanë ngrirë krejt. Po të lejoni, mund ta drejtojë makinën ndihmës shoferi, ushtar Zenel Metaj.

I shqetësuar, kapiten Gjergj Martini i preku duart. Vërtet që bërë kallkan.

— Ndale! — i tha dhe, në çast, urdhëroi që autokolona të qëndronte e ta priste aty agimin e ditës së re. Tanimë posa kishin arritur në piketë, në afërsi të një fshati buzë xhadesë. Anës, një ndërtesë e vogël e repartit «N» shquante mbi sop të një rruge të ngushtë.

— Kontrollojeni — tha komandanti i nënrepartit — është e hapët?

— E mbyllur! — u dëgjua një zë i mbytur nga era.

— Të hapet! — urdhëroi ai.

Baraka u hap. Pranë saj zunë vend çisterna, një makinë me dy kontenjerë benzinë, sidhe vargu tjetër i automjeteve që përbënin autokolonën. Njerëzit të ngrirë hynë në barakë.

— Zjarr! Ndizni zjarr! — u dëgjua zëri i mekur i një prej shokëve që kish filluar të ngrinte.

Ata që ndiheshin më mirë, shpejtuan dhe ndezën zjarrin. Shpejt flaka bubulloi dhe njerëzit që kishin ngrirë u shtynë drejt asaj flake, duke ngrohur duart, fytyrën, trupin, këmbët.

\* \* \*

Kishin kaluar dy orë... Shoferët me ndihmësit rreth zjarrit që bubullonte dhe lëshonte shkëndia nga ata dru çermëndellesh, akoma ngroheshin dhe dremitnin të qetë. Po befas, shkënditë e shkëputura, duke u ngjitur përpjetë, i dhanë zjarr çatisë prej kashtë thekre.

Zjarri, nga ai tufan i marrë, u kthye në flakë. Dhe flaka sa hap e mbyll sytë, e mbuloi tej e tej atë çati ka-



shte. Pastaj, era, duke rrëmbyer një pjesë të kashtës së ndezur, e vërviti mbi rrugë.

Gjendje e rëndë. Kolektivi u vu në alarm. Një metro pranë ndërtesës ndodhej çisterna, që po furnizonte një makinë, kurse në krah të saj, një automjet prej dy kontenjerësh me dymijë e gjashtëqind litra benzinë.

Rreziku i shpërthimit po trokiste në derë. Gjendja ishte me të vërtetë e vështirë. Pa humbur minutën, që të gjithë u derdhën për të shuar flakët që po shkrumbonin çatinë. Po, ndërkohë, tufani i tërbuar shkëputi vandakë kashte të ndezur dhe i vërviti mbi rrugë. Një prej tyre ra mbi çisternën, që kish brënda katërmijë litra benzinë. I tronditur, Zenel Metaj, mbylli rubinetat e çisternës, për mos t'u lagur me benzinë. Po flaka po rritej pranë autobotit.

— Mbaroi! — mendoi kapiten Gjergj Martini dhe duke hequr mushamanë, e shuk mbi borë, pastaj vetëtimthi e rrëmbeu e bashkë me të u hodh mbi flakët e kashtëve të ndezura, që kishin rënë mbi autobot, e po u afroreshin rubinetave të njomura nga benzina gjatë furnizimit të automjetit. Dhe ajo flakë, si një fitil dinamiti, po ndiqte vazhden gjer në kapsol. Pastaj, shpërthim, flakë, tmerr...

Tani pothuaj, gjithsecili mendonte:

— Prite kur të hidhet në erë!

Po Gjergj Martini, i shtrirë mbi mushamanë e tij sipër çisternës, e mbuloi me trup atë flakë e, krahas saj; edhe rubinetat e lagura me benzinë.

Ushtar Zenel Metaj u zbeh në fytyrë.

— Traktorin! Shpejt traktorin që të largojë makinën e kontenjerëve nga zona e zjarrit e pastaj edhe autobotin! — gjëmoi prerë zëri i komandantit, që akoma s'e kishte përfunduar duelin me vdekjen. I hutuar nga gjëndja, traktorist Anton Seta u drodh e pastaj, si era, afroi traktorin dhe i hodhi kanxhat makinës së dy kontenjerëve. Të tjerët nga pas, e shtynin.

— Shpejtoni! Shpejtoni! — u ndje sërish zëri i komandantit.

Në çast, zhurma e traktorit gjëmoi. Makina lëvizi, por, befas, dy rrotat e saj të prasme ranë në një gropë. Kavua u këput.

— Dreqi, po ku e gjeti në këtë çast? — tha traktoristi i tronditur rëndë, dhe, rrëmbimthi; zbriti e shkurttoi kavon e pastaj shpejt e shpejt e vuri në dy kanxhat e paparakolpit. Hipi dhe, duke i dhënë një kolp të fortë, e nxori dhe e largoi makinën e ngarkuar me benzinë nga zona e flakëve dhe e eksplozionit. Tani radha i mbeti autobotit.

— Shpejt! u dëgjua edhe një herë urdhëri i prerë i kapiten Gjergjit.

Traktoristi shpejtoi. Ndërkohë tufani përsëri hodhi mbi rrugë vandakë kashte të mbuluara me flakë. Dy prej tyre ranë mbi çisternë, Pa u drojtur, Gjergj Martini e rrëmbeu njërin syresh, atë më të madhin dhe e vërviti mbi borë. Tjetrin nuk e vuri ra. Dora dhe fytyra ju përzhitën keq. Po në ato çaste as që e ndjeu atë dhëmbje të fortë. Ndërkaq, flakëza e vandakut të vogël po shtyhej drejt tubit me benzinë, të autobotit. Jeta e kapiten Gjergj Martinin po kërcënohej seriozisht. E me të edhe çisterna pritej nga çasti në çast të hidhej në erë:

«Tani më erdhi radha mua!» tha me vete ushtar Zenel Metaj dhe, duke rrëmbyer një batanie, u hidhet e i vuri gjoksin flakës që po harbonte me të shpejtë. Kurrë s'e kishte patur vdekjen kaqë pranë. Po dhe komandantin e tij kurrë s'e kishte patur më afër se në ato çaste të vështira. E sado që e kishte përkrah, fytyra e tij s'njihej aspak... Ajo nxinte si vetë ajo natë e errët, dhe e gjatë. Flakët ja kishin përzhitur mollëzat ballin, flokët, duart gishtrinjtë... Por, megjithatë i patundur, ai akoma qëndronte atje, mbi autobot, i heshtur, i vendosur...

— Ti Zenel? — i tha — Ti me këtë trup kaq të imtë?

— Po, shoku komandant, unë....

— Të faleminderit S'do të të harroj kurrë! — dhe prapë me dashuri e vështroi njeriun që i kishte shpëtuar jetën.

Ndërkohë, autoboti i tërhequr nga traktori filloi të lëvizte me përtesë. Gjithashtu çisterna me kapiten Gjergj



Martinin dhe ushtar Zenel Metajn kish filluar të dilte nga sfera e atij rreziku kërcënues.

Duke e përfytyruar atë që kish ngjarë, Zenel Metaj psherëtiu. Ai kurrë s'e kishte ndjerë veten më pranë komandantit të tij, se këtë radhë. Ata kishin luftuar e kishin fituar bashkë. Vdekja ishte larguar. Dueli kishte marrë fund. Dhe autokolona, mbas pak, e prirë nga kapiten Gjergj Martini, sërish u nis për në objektiv...

Mbas pak, dita e re zu të fekste.

— Gdhiu — tha ai me vete, dhe, ashtu në heshtje, ju bë sikur ajo akoma po i ankohej: «Gjergj! Më vjen keq që këtë pesëvjetor të martesës s'po e bëjmë bashkë.... Si-  
doqoftë, mos e harro 3 dhjetorin tonë!»

Kjo kishte qënë porosia kur e kish përcjellë. Dhe 3 dhjetori po agonte. Por ndryshe nga ai i pesë vjetëve më parë...

Dhe ai edhe një herë e solli në kujtesë atë ditë, e pastaj edhe atë shëtitjen buzë bregut të kaltër, që s'kish për ta harruar kurrë...

## A J O D H E A I

Kjo ndodhi një ditë vere të vitit 1960, kur ai, pas mbarimit të Shkollës së Bashkuar, kish shkuar në fshat për t'u takuar me të dhe me njerëzit e tij të familjes.

— Martë! — i tha — a dalim nga bregu! Dhe e priti me kureshtje atë përgjigje të saj.

— Po — ja bëri ajo e gëzuar — Kur të duash, Gjergj. Pastaj, pranë e pranë si zakonisht, ecën drejt bregut të detit.

— S'e merr me mend — tha ai duke e hapur atë bisedë — S'e merr me mend sa shpesh të kam kujtuar, Martë!

— Edhe unë — shtoi ajo e çelur — Unë të quaj edhe shpëtimtar, Gjergj!

— Shpëtimtar? Pse shpëtimtar?! — pyeti ai me habi..

Ajo qeshi.

— E paske harruar si duket, po unë kurrë s'kam si ta harroj! Vdekjen kurrë s'e kam parë më pranë se atë ditë. Shkonim për në Vermosh, në të kujtohet. Prindërit në krye, kurse Nika, Gjeta, ti dhe unë pas. Kur dëlëm mbi Leqet e Hotit, një panoramë e mahnitëshme na doli përpara.

«Këto male edhe lulet i kanë ndryshe» — tha Nika, duke këputur një sojesh. — Ndryshe nga ato tonat në Velipojë e në krahinat përçark.

«Të shohim — thashë unë — kush do të mbledhi



një tufë me lulet më të bukura!» — dhe u derdha para jush. Pastaj, të gjithë ju u shpërndatë, duke kërkuar lule. Mblidhnim dhe ecnim gjithnjë përpara. Mua më ra në sy një lule e rrallë, që kish mbirë buzë një honi të thellë. Ngarenda ta këput, po më trëmbi ajo humnerë, që zbriste gjer në fund të Cemit ndonjëmiqë metro tatëpjetë. M'u duk sikur rashë dhe u sprapsa me tmerr. Po prap më erdhi keq ta linja atë lule: «Po të zvaritem — thashë — ndofta mund ta marr!» Dhe u shtrita buzë greminës, ku ndodhej edhe një kaçub i trashë xane. S'di se ç'ngjau më tej, po këmbët më rrëshqitën e unë mbeta e varur me duar në kaçube e këmbët tëposhtë në grykë të honit, që dukej sikur do të më përpinte nga çasti në çast. Klitha e tmerruar. I pari që më dëgjove e më pe, ishe ti...

«Mos u tremb!» më thirre «Erdha, erdha, Martë!» dhe duke hedhur tufën që kishe mbledhur, u derdhe drejt meje, me një frymë. Pastaj, duke u prirur mbi hon, më dhe dorën, duke e vënë jetën tënde në rrezik të plotë. T'u luta të më lëshoje, kurse ti m'u përgjegje: «O do të shpëtojme, o do të biem të dy bashkë, Martë!» Po tani, a të kujtohet? — tha ajo.

— Po — tha ai — Tani po. Sikur e kam para sysh tërë atë skenë...

— Kështu pra — tha ajo. E thuaj pastaj që s'kam të drejtë të të quaj shpëtimtarin tim të vërtetë? — dhe i buzëqeshi:

— Jo — tha prap ai. Po të mos kisha ardhur unë, do të kishin ardhur Nika, ose Gjeta, siç erdhën....

— Ata ishin larg. Kur të mbrinin ata, unë s'do të isha në buzë, po në fund të honit. Ndaj atë s'kam për ta harruar kurrë, kurrë! — dhe në mënyrë të pavetëdijëshme, duke dashur t'i shprehte edhe një herë mirënjohjen e saj, i hodhi krahun dhe e pushtoi, ashtu siç e kishte pushtuar edhe në ato çaste, kur e kishte shpëtuar nga ajo vdekje e sigurtë. Vetëm me një ndryshim, që tani nuk e kishte puthur si atëherë.

Atij i erdhi mirë që e pushtoi dhe, ashtu i qeshur siç ishte, i zuri dorën. Ajo nuk ja largoi. Pastaj të dy ecën një copë herë të heshtur.

— Sidoqoftë, — tha ai, duke thyer heshtjen — unë prap mendoj, se të kam kujtuar më shpesh... Dhe jo vetëm më shpesh, po për çdo ditë, mund të them.

— S'dihet — tha ajo.

— Dihet — tha ai. Pyet Gjetën, të të tregojë...

Ajo u skuq në fytyrë dhe sytë i shndrritën nga një gëzim i fshehtë. Mos vallë ato fjalë ishin parathënia e shprehjes së dashurisë, që ajo e kish pritur prej shumë kohe! E donte ai atë? Apo mos ndofta, edhe ai pohim s'ish gjë tjetër, veçse shprehje e miqësisë së tyre të fortë, të lidhur që në ditët e fëminisë? Sa herë ky mendim e kish munduar... Sa herë gjatë netëve, kur të tjerët flinin, ajo mendohej në shtrat! Mendohej dhe e përfytyronte në të gjithë lidhjen e tyre shumëvjeçare.

I ndodhte shpesh... Herë, — herë, e dizilizionuar, zbehej e qortonte veten rëndë. «Sa keq! Unë s'jam në terezi! Ndjenjat e tij kanë të bëjnë vetëm me miqësinë e një njeriu të pastër e me karakter të fortë, kurse unë... unë, me fantazinë time të sëmurë, i marr ato krejt ndryshe, nga ç'janë në të vërtetë!» Po në rastë të tjera mendonte krejt ndryshe.

Por ja tani ai vetë, po i bënte një pohim, që s'ja kish bërë herë tjetër, dukei përmëndur edhe emrin e Gjetës në atë mes! A thua, të ishin kot ato fjalë, kot ai pohim? Po Gjetën, pse e përmëndi? Pse tha: «... të kam kujtuar më shpesh! Dhe jo vetëm më shpesh, po përditë, mund të them!» Përse ai më ka kujtuar përditë? Mos ndofta të gjitha këto së bashku duan të thonë se ai më do? Se ai... ai...?»

Kështu mendonte ajo, ndërsa ecnin përkrah njeri tjetrit të heshtur. Po dhe Gjergji, i përfshirë nga të njëjtat ndjenja, ish po në atë hall. A e donte ajo me të vërtetë? A i lidhte ata diçka e veçantë, që mund të bëhej shkak, për t'i bërë shokë jete gjer në fund? Apo, ndofta, përzëmërsinë dhe mirësjelljen e saj, ai i merrte krejt ndryshe nga ç'ishin ato në vetvete? Ata vërtet e donin njëri tjetrin, po ndoshta, kjo dashuri, si peng nga koha e vegjëlisë, kish mbetur krejt vëllazërore e s'kish hedhur asnjë hap më tej... Atëhere, me ç'të drejtë ai mund



ta mendonte ndryshe? Po sikur ajo propozimin e tij ta priste keq? Po sikur ajo të fyhej, duke e menduar atë miqësi e afrim krejt ndryshe, nga ç'paskësh menduar ai?

«Sa gjë e rëndë! Plumb e rënd!» — tha me vete dhe, tërthorazi, i hodhi një vështrim asaj. Por ajo s'e vuri re. Ecte me vështrimin e ngulur përtokë.

— Martë! — tha ai, duke e prishur atë heshtje të gjatë. Ke kohë që ma ke dërguar, po unë, duke menduar se ma kishe dërguar ti, s'di pse m'u duk e vështirë të të falënderoja; ndofta nga që gjithnjë të kam quajtur si... Ndofta nga që midis nesh....! — dhe nxorri nga xhepi një stilograf të pruar në ngjyrë ari.

— Asgjë, Gjergj — tha ajo, duke u munduar ta merrte veten. — Unë gëzohem të të ketë shërbyer.

— Po. Gjer në ditën e fundit, Martë. Dhe kisha kënaqësi të shkruaja me të, se më dukej sikur në ato çaste të vështira të provimeve, ti më vije pranë...

Ajo u çel në fytyrë.

Atij i dha zemër ajo çelje.

— Martë! — tha pastaj — nuk e dija që del kaq mirë në fotografi. Sa bukur të kish marrë!

— Ku? — tha ajo.

— Në një fotografi, që më ra rastësisht në dorë.

— Fotografi? Cila fotografi? — tha ajo me kureshtje.

— Ishe me një të ri pranë — tha ai, duke i dhënë seriozitet fjalës. I qeshnit njëri tjetrit. Veçse e kam të vështirë të them, se kush nga ju të dy dukej më i lumtur, që ndodhej përkrah shokut.

— Gjergj! — tha ajo — Ç'thua kështu?

— Atë që pashë, Martë. Atë që pashë — tha rishtas ai.

— E pamundur — tha ajo. — Jo për ndonjë gjë të keqe, po unë s'di të jem fotografuar ndonjëherë me ndonjë të ri të tillë, siç po thua ti.

— Ndofta, Martë! Por unë e pashë me sy. Pastaj, edhe ai vetë më foli gjatë për ty.

— Ai? Po kush është ai? — tha ajo, e shtëpur habie.

— Një njeri, që m'u duk se askush s'do të mund të të donte sa ai.

— E pabesueshme! — tha ajo e zbetë dhe aty për aty

ju duk sikur u shua edhe ai vegim i ëndrës së bukur, që i kish buzëqeshur me aq ngrohtësi, gjer pak çaste më parë.

Gjergji e vuri re dhe u gëzua për veten e tij.

Ajo vërtet ishte tronditur.

— Martë! — tha ai — Këtu s'ka asgjë për t'u shqetësuar...

— Ka — tha ajo — ka Gjergj!

— Sidoqoftë, ai të do! Dhe unë e di mirë këtë.

Të thashë: Ma ka treguar me gojën e tij!...

Ajo u drodh.

— Një njeri i tillë s'ekziston — tha — e asnjë fotografi e tillë.

— Ekziston — tha ai i qetë.

— Atëhere, nxirre atë fotografi! — tha ajo e prerë, duke marrë frymë me të vështirë.

— Do ta nxjerr — tha ai — Ma ka dhënë ai vetë, dhe pret përgjigje, Martë! Sa do të gëzohesha, sikur përgjigja jote për të të ishte «po!» — dhe, duke nxjerrë një zarf nga xhepi, ja dha.

Ajo e mori. Duart i dridheshin dhe sytë i ishin mbushur gadi me lot.

— Hape! tha ai. Njeriu që ma ka dhënë, pret përgjigje.

Ajo, e tronditur, e çeli. Po befas, ngriu e s'po i besoj ajo që po shikonte.

— Gjergj! — tha pastaj e hutuar. Ti këtu?

— Ne të dy — tha ai — Veç mos harro, Martë... ai pret përgjigje.

Ajo s'qe më në gjëndje t'i fliste. Ashtu siç ish, i ra ndër krahë dhe e përqafoi, si atë ditë kur e shpëtoi nga vdekja e sigurtë, buzë humnerës.

S'kaloi asnjë muaj dhe shtëpia e Gjergj Martinit përsëri u mbush plot.

... Po tani ai ishte larg Martës së tij, duke ju ngjitur majave.



## R R A F S H N A L T A

Bora kishte filluar të shpeshohej. Tokë nuk dukej më gjëkund. E as njerëz, aty pranë. Vendësit, të mbyllur nëpër shtëpitë e tyre, rrallë delnin për ndonjë hall. Në atë bardhësi pa fund, vetëm tufani ndihej që ulërinte majave. Ai, as natë as ditë, nuk kishte pushuar. E as bora, që s'e ndalte vrullin e saj asnjë çast.

Megjithatë, hapja e atyre tokave, që s'ishin punuar kurrë nër shekuj, duhej bërë patjetër. Shpejtimi për të kryer puna para se të fillonte rreshja e borave pafund, ishte tani çështja më me rëndësi e ditës. Vetëm ashtu ato toka të kthyer qilizmë do të mund të punoheshin e të mbilleshin pas disa muajsh në pranverë. Por, turri i parë i sipërfaqes që do të hapej s'ishte i vogël. Ai i kalonte të 2000 dynymët, kurse dimri me tërë ashpërsinë e tij, po derdhej në çdo krahë. Bora që binte pa rreshje çohet si dallgë e u përplasej traktorëve, ndërsa era me acar e kthente në akull, duke i bllokuar dyert e makinave. I çuditur, po dhe i cfilitur nga të ftohtit, një nga traktoristët, më i riu i tyre Nikolin Maranaj, u mundua të delte. Po kur e pa se s'po e çelte dot derën, u trondit rëndë.

— Mos e humb gjakftohësinë! — i tha ushtar Zenel Metaj që ish aktuar si ndihmës i tij. Do ta çelim e do të dalim bashkë.

Dhe që të dy provuan të lëvizin dorezën, po doreza s'lëvizte dhe dera nuk po hapej.

Më me forcë! Më, me forcë! — tha traktoristi me shqetësim dhe, sërish provoi me tërë fuqinë që i kishte

mbetur. Dera e ngrirë kallkan, prapë nuk u hap. Ahere, i tronditur, ai briti me sa pat në kokë:

— Ndhimë! Ndhimë, shokë!

Po thirrja s'u dëgjua. Vërshëllima e tufanit mbyste tanimë edhe zhurmat më të fuqishme rreth e qark. Dhe ashtu mbetën ata për më se tri orë resht. Të mbyllur e të vetëm...

I mbetur ngushtë ushtari mudohej ta qetësonte:

— Edhe pak! Edhe pak, e me siguri do ta hapim. Le që do të vinë edhe shokët pa tjetër. Ti je alarmuar, Nikolin! Ti je alarmuar. Jo, kështu nuk është mirë, shok! Neve na takon të luftojmë! — Dhe me durim ushtari vazhdoi përpjekjet gjersa më në fund doreza lëvizi dhe dera u hap. Pastaj.

— Ndhimë! Ndhimë, shokë!

Thirrja u përsërit e u ripërsërit. Traktoristë e ushtarë, me Gjergj Martinin e brigadier Dedë Maranajn në krye, vrapuan andej nga vinte zëri. Po traktorist Nikolin Maranaj tanimë kishte ngrirë pothua krejt. Kur e nxorrën, fytyra i qe murtyer, duart nxirrë, ndërsa nofullat i dri-dheshin me kërcëllimë.

— Baba! — arriti t'i thotë Dedës në atë marramëndje. As në pol s'do të isha ndjerë më keq! — Dhe duke humbur vetëdijen i ra të fikët.

Dedë Maranaj pa e dhënë veten, e mori në krahë dhe bëri përpara. Pas pak ata u gjendën në gazermë, në atë strehë ku pas turneve të punës, ushtarë e traktoristë ngroheshin, pushonin, flinin...

Tani të gjithë ishin grumbulluar rreth Nikolinit. Dikush duke i bërë masazh, dikush, duke i afruar një gotë të madhe konjaku, kurse të tjerët duke i vënë zjarr një turre të madhe drush. Flaka bubulloi e ngrohtësia dalëngadalë e pushtoi trupin e tij të ngrirë. Qepallat e mekura lëvizën, sytë ju çelën.

— Ku jam? — mendoi me vete dhe i hutuar hapi sytë përgjysëm.

— Qetësohu, Nikolin! Qetësohu! — i tha komandanti i njësisë që s'po dinte si ta ngushëllonte Dedë Maranajn.



— Qetësohu! — i thanë edhe Gjergj Martini me të jatën.

Ai hodhi vështrimin drejt njerëzve që e rrethonin. I njohu, u buzëqeshi dhe prapë mbylli sytë.

— Mos e shqetësoni! — u tha shokëve komandanti i njësisë. Ka nevojë të pushojë, të flejë... — dhe, duke marrë me vete brigadierin dhe komandantin e nënrepartit, kaloi në dhomën matanë për të përgatitur planin e ditës së ardhshme.

\* \* \*

Kaloi edhe ajo natë. Të nesërmen, i trembur nga agësia e asaj natyre, traktoristi s'doli me shokët në punë. E as të pasnesërmen, megjithëse, ishte shëruar plotësisht. Në parcelë, traktori i tij heshtte i veçuar, nga të tjerët.

— Ku është Nikolini? — pyeti Dedë Maranaj, i vrarë në sedër. Ai u shërua, pse nuk po duket në punë?

— E thirrëm, por ai thotë se s'ka ndërmend të lerë kokën këtu! — ju përgjegj me thumb një prej traktoristëve. — Më duket, Dedë, se do ishte më mirë ta çoje tek e ëma.«

Brigadier Deda u bë flakë në fytyrë. S'foli. Po, ashtu siç ish, i vrarë e i pezmatuar, vrapoi për tek i biri.

— Përse s'ke dalë në punë? — i tha me nervozizëm.

— Nuk ndjehem mirë, baba! Në krahinën tonë kurrë s'kam punuar në toka të mbuluar me kaq borë! Merrma si të duash, por unë...

Ai u drodh nga ato fjalë.

— Mblidh mëndjen bir, dhe çohu! Mos harro nderin e kolektivit dhe fjalën që i kemi dhënë komandantit të njësisë...

— S'e dinja kështu! tha tjetri. Kurrë s'e mendoja një vështirësi të tillë. Ku është parë që dera e traktorit të ngrijë e të të mbyllë brenda?

— Të thashë: Mos harro nderin!... Më kupton? — tha ai me një zë të shqetësuar dhe mbi ballë ju thelluan rru-dhat.

— E di, baba — Po kur s'mundem, s'mundem. Këtu lozet me jetën.... Këtu...

I ati dalldisi.

— Hutë! — tha, i tmerruar nga ajo përgjigje e papritur. — Unë tani po e kuptoj se ç'djalë paskam! Një frikacak me brirë. Një egoist, që s'do gjë tjetër në botë veç vetes së tij!.. Dhe guxon të quhesh im birë? Biri i një komunisti dhe partizani veteran, që ka në trup aq plagë? Jo, jo! Ti s'do të quhesh kurrë im bir gjërsa të shkosh me këtë mendje. Dhe mos harro: këto që më the mua, eja t'ja thuash kolektivit! T'u thuash me gojën tënde se u theve, se në dejt e tu nuk rrjedh gjak nga i tyre, nga imi, po gjak zvaranikësh. Më kuptove?

Ai dridhej.

— Dhe mos harro se pa atë djaloshin, që është moshatar me ty, ushtar Zenel Metajn, do të kishe vdekur. Do të kishe vdekur nga frika! Por ai shpëtoi veten dhe ty. Dhe tani po të pyes: Ti që e quan veten Nikolin Dedë Maranaj, a do të kishe sy e faqe t'i dilje përballë e ta shikoje në sy ushtar Zenel Metajn? T'u dilje përballë shokëve të tu, që edhe jetën janë të vendosur të japin, po nga fjala e dhënë dhe nga fronti i punës nuk tërhiqen? Folë! Folë!

Ai qe nxirë në fytyrë e mjekra i dridhej nga tronditja.

— Këto kisha për të të thënë. Këto do t'i them edhe para shokëve të tu, edhe në sytë e atij gjeneralit, komandant të njësisë. Komunisti Dedë Maranaj, me plagë e cila predhash në trup, që sot e tutje nuk ka më djalë! E more vesh? Dhe, duke përpjekur me tërbim derën doli përjashta.

Nikolin Maranajt ajo përpjekje dere ju duk sikur e hodhi në ndonjë humnerë. Një rrufe ju bë sikur i shkrepri përpara këmbëve e ja përzhiti trupin dhe fytyrën. Pastaj edhe ballin e sytë ju ndezën.

I zbetë, e i tmerruar, doli menjëherë dhe shpejtoi të arrinte të atin.

— Baba! Baba!

— Ai?! Po përse kjo shtrëngesë? — pyeti veten bri-



gadier Deda — Për të dalë para kalektivit sa më parë? Për t'u larguar së këtejmi sa më shpejt? Apo....? Jo, kjo e fundit s'mund të jetë... Ai ma tha hapur se...

Por s'arriti ta çonte gjer në fund këtë mendim. Njeriun që kish vrapuar pas tij tani e kishte përballë. Mbl fytyrën e tij vezake bula djerse kishin filluar të rignonin.

Dedë Maranaj e shikoi drejt. Vështrimi i tij ishte i prerë, i akullt.

Tjetri u drodh. Sytë e brigadierit flitnin qartë se me ç'përshtypje ishte larguar prej tij.

— Baba! — tha duke marrë frymë me dënesë. — S'di si gabova aq rëndë! Sidoqoftë, le të mblidhet kolektivi, për ta gjykuar, sjelljen time. Në më kërkofshin, jam në parcelë! Në parcelë....

Brigadieri kishte mbetur si i ngrirë, nga ajo e papritur dhe ndofta deshi të thoshte dishka. Po tjetri s'mundti të qëndronte më gjatë. Në pikë të vrapit, u turr drejt parcelës, ku një makinë priste për të vazhduar sulmin e saj.

I prekur, Dedë Maranaj hoqi thellë në zemër.

— Axhami! — tha më në fund me vete. — Akoma s'i ka kaluar të tetëmbëdhjetat! E, veç kësaj, është rritur me përkëdhelje. U tremb ngaqë kurrë s'u është ngjitur këtyre majave e, aq më tepër, në ditë si këto! Dhe që nga larg, edhe një herë hodhi sytë nga djaloshi që, bjer e ngreu, çante përmes asaj bore që e kalonte një metro lartësi, për të arritur traktorin.

— Nikolin! Nikolin! — i thirri.

Po ai s'ju përgjegj. Mbas pak, makina që kishte hequr për orë e orë të tëra, u ndez dhe rrafshnalta ushtoi edhe në atë krah.

## K O M A N D A N T I I N J I S I S E

Qenë të vrullshme ato ditët e para. Po bora e mur-lani e lodhën atë kolektiv luftarak. Ritmi pak nga pak filloi të binte. Gjergj Martini përbluhej, kurse Gjetë Sokoli i ndezur nga gjendja e rëndë, ju shfrynte atyre që tregoheshin të ngathët, apo gati të thyer nga ajo situatë.

— I pandërgjegjshëm! I pandërgjegjshëm! Vjen e më strukesh pas mezhdave, kur shokëve u bije bretku nëpër borë?! Po a s'e di ti more, se unë të çoj në arrest? Ë? A s'e di ti?

Ish pikërisht në këto momente, kur Gjergj Martini u afrua një ditë dhe e gjeti duke i shfryrë rëndë një ushtari. Fytyra i qe ndezur dhe nofullat i dridheshin nga nervozizmi.

Tjetri, i heshtur, ju qas, duke i hedhur një vështrim kuptim plotë.

Po ai, nga furia, e nga sedra, s'e ndali yryshin që kishte marrë.

— Hajt! Në arrest, në arrest, të thashë!

Kokëulur, ushtari u largua, për të zbatuar urdhërin.

Gjergji s'foli. Pastaj, edhe ai, i heshtur, u largua mbas ushtarit.

Gjetë Sokoli, i mbetur vetëm, ndjeu një shtrëngim të fortë në zemër e mandej një goditje në krye,

— E mori dreqi, e mori! Mos ndofta e shkela përsëri? Dhe prapë ju bë sikur dëgjoit edhe një herë zërin qortues e keqardhës të Gjergj Martin:



«Ke gjetur tamam kohën për arresta, Gjetë!»

Dhe kushtet vërtet ishin të rënda. Duke përfytyruar ditët e ardhshme, komandanti i njësisë shpesh përbluhej me shqetësim të thellë. Sikur e bënte enkas, edhe prognoza vazhdimisht jepte lajme të këqija.

— E qartë? — tha më në fund komandanti i menduar. — Kjo është gjendja dhe këto janë forcat. E me këto forca, objektivi duhet arritur me çdo kusht. Rrugë tjetër s'ka. Po kush do t'ja dalë kësaj pune në krye? Kush do ta marrë këtë kuotë? Dhe, duke vrarë mendjen me vete, pa e ndjerë borën që i kish zbardhur kryet e supet, u end nëpër rrafshnaltë.

— Ne të gjithë, — tha pastaj. — Patjetër që do ta marrim... me komunistët në krye — Dhe u nis për në kazermë.

Të ngrirë, traktoristë e ushtarë qenë mbledhur rreth zjarrit.

«Po ngrohen» tha me vete, duke u hedhur një vështrim të shpejtë.

— Urdhëroni!

— Urdhëroni këtu, shoku komandant! — u dëgjuan zëra. Pastaj, ushtarë e traktoristë i hapën vend për t'ju qasur zjarrit që flakëronte.

Ai i falënderoi, por nuk u ul.

«Përse nuk desh të ngrohet?» — mendoi Gjergj Martini me vete dhe, një nyje ju lidh në grykë.

Ish e treta ditë që ai e kish vënë re këtë gjendje të komandantit të njësisë.

Nugshtë e ndjeu veten edhe Ded Maranaj. Pa rënë në sy, u zbraps e ju largua zjarrit. Pastaj, tërthorazi, ktheu kryet për ta parë. Befas shikimet e tyre u ndeshën u kryqëzuan.

Brigadieri u zbeh.

«— Po ngrohe? — ju bë sikur i tha. — Bukur! Po fjala e dhënë? Zotimi që kini marrë?...

Kaq. Pastaj komandanti i ktheu krahët flakës.

— Doli?! — tha Gjergj Martini i shqetësuar dhe, në çast, i shkoi mbrapa.

Po tjetri, i vetëm, kryeulur, filloi të endej nëpër oborr. Ecte dhe mendohej.

— Gjergj! — i tha porsa e vuri re. — Ma thirr Dedën bashkë me dy komunistët e tjerë të kolektivit të tij. Gjithashtu edhe Gjetë Sokolin e ushtar Çelo Labin.

Gjergj Martini shpejtoi.

Mbas pak, Dedë Maranaj vet i tretë ja behu.

— Urdhëroni, shoku komandant! Na thirrret?

— Po, Dedë! — tha ai i menduar. Dhe i afërt e i përzemërt, siç ish gjithnjë, i hodhi krahun mbi sup. — Edhe ti qëndro, Gjergj! Edhe ju, Gjetë e Çelo... Në këto çaste të vështira, secilit nga ne i takon të thotë fjalën e tij. Pra, le të fillojmë, shokë! — dhe duke hequr krahun nga supi i Dedë Maranajt u shtrua këmbëkryq mbi borë.

Të tjerët prisnin më këmbë.

— Uluni, po të doni!

U ulën që të gjithë.

— Dedë — tha ai duke e rimarrë fjalën. — A ka komunist tjetër në kolektivin tuaj veç ju të treve?

— Jo, shoku komandant! Nuk ka.

— Në rregull — tha ai i zymtë. — Pra jemi shtatë gjithë-gjithë.

Po atëhere pse të mos e quajmë këtë shtatëshe komunistësh organizatën bazë të partisë? Dhe si organizatë, së bashku të mendojmë e të vendosim se ç'duhet bërë.

— Unë jam i një mëndjeje me ju — tha brigadieri. — Dhe mendoj se shpreh në këtë rast edhe mendimin e dy shokëve të mi të tjerë.

Dy të tjerët pohuan me kokë.

Komandanti disi u çel në fytyrë. Pohimi ishte i plotë. Po të plota ishin edhe fjollat e borës që i binin mbi krye, mbi supe, mbi ballë...

Ai e shkundi një pjesë të asaj bore. Pastaj:

— Ja kjo është gjëndja! — tha. — Borë dhe vetëm borë. Mbas disa ditësh, trashësia kush e di sa do të arrijë! Po ato ditë akoma janë larg. Dhe neve na takon para tyre ta kemi thënë fjalën tonë. Dhe atë fjalë duhet ta themi ne komunistët me shembullin tonë personal. Gjatë luf-



tës mjaftonte një anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare të ngrinte më këmbë një krahinë të tërë. Ku ish një celulë, atje s'kish forcë armike që e mposhtëte atë vrull. Po a s'jemi ne anëtarë të po asaj partie? A s'jemi ne një celulë? A s'jemi ne gjak i të njëjtit gjak? M'u përgjigjini, shokë?

— Po, shoku komandant!

— Po!

— Po, shoku komandant!

Ai mori frymë thellë dhe përsëri me kurrizin e dorës fshiu borën që i kish mbuluar qepallat dhe sytë.

— Pra shokë, ne duhet të jemi në ballë. Të përsëritim atë që shokët tanë bënë gjatë luftës: të parët mbi çdo fortifikatë, po dhe të parët për të zënë vendin që shoku i rënë a i plagosur kishte lënë zbrazët në front. Se tek e fundit a s'është kjo një ndeshje e vërtetë, a s'është dhe ky një front?

— Plotësisht e drejtë! — tha Gjergj Martini i skuqur në fytyrë.

— Edhe unë bashkohem me atë mendim — tha zëvendës brigadieri me një theks të prerë. — Po edhe dua të kritikoj me këtë rast: kur ndokush ka mbetur me traktorin e tij mbi borë, kush nga ne, si komunist, ka vrapuar për t'ju gjetur në ndihmë? Pothuaj askush! E as unë vetë, që po e bëj këtë kritikë! Kur ndokush është strukur qosheve, kush nga ne ka shpejtuar për ta zgjuar nga ai gjumë i rëndë? Me keqardhje, po edhe në këtë drejtim shembujt flasin vetëm për keq. Apo jo, Dedë? Dhe kjo përgjegjësi bie mbi Dedën dhe mua në radhë të parë, si brigadierë, e zëvendës, pa le pastaj edhe si komunistë.

— E drejtë — tha edhe shoku tjetër i tyre, që kish heshtur gjer në atë çast. — Mua më pëlqen që e zgjidhëm gjuhën e po flasim në këtë mënyrë. Ne kishim e kemi nevojë për një shkundje të fortë. Pra, kjo mbledhje qe shumë me vend.

— Kjo është gjuhë komunistësh! — tha komandanti i njisisë i përtërirë. Secili ka shikuar më shumë që puna

e tij t'i shkonte mbarë, duke harruar se komunisti udlëheq, vë në lëvizje kolektivin, shoqërinë. Dhe ja mungesa e kësaj dore, bëri që ritmi të bjerë. A s'është kështu, shokë?

Dedë Maranaj, pohoi me kokë.

— Edhe diçka tjetër — tha komandanti i njësisë. — Në njëmbëdhjetë ditë kemi hapur vetëm 400 dynym tokë. Për njëmijë e gjashtëqind dynymët që mbeten, mendoj që çështja t'i shtrohet kolektivit. Thirrja jonë duhet të jetë: Të hapim tetëdhjetë gjer më njëqind dynym në ditë! Duhet të bëjmë çmos për të fituar kohë. Çdo minutë e fituar është një pjesë e fitores. Ndryshe, objektivin nuk mund ta arrijmë. Dhe mendoni ç'do të thotë kjo për ne si komunistë...

— E drejtë! — u dëgjuan zëra.

Ai prapë vazhdoi:

— Për këtë qëllim, me që martinelët nuk na mjaftojnë plotësisht, propozoj të punohet me turne e me orë të zgjatura gjer në orët e vona të natës. Veç kësaj, në çdo sektor e në çdo turn të ketë nga dy komunistë: një ushtarak e një civil, që t'u qëndrojnë shokëve në ballë. Vetëm kështu, puna do të mund të kontrollohet e shembulli personal s'do të mungojë.

— Unë propozoj që ne komunistët të bëjmë nga dy turne bashkë — tha Dedë Maranaj.

— Ja! — tha komandanti i njësisë. — Ky është shembulli personal.

— Edhe unë e kisha këtë në mend — tha zëvendës brigadieri.

Gjergj Martini mori frymë thellë. Duke dëgjuar atë rrahje mendimesh, atij i kalonin para syve ditët e ardhshme, kur në krye të këtij kolektivi të motorizuar, komunistët do të ndesheshin të parët me atë masiv të pa-fundshëm bore përmes shqotës e stuhisë...



Çështja u shtrua në kolektiv.

Shkundja e madhe filloi. Komunistët me komandan-



tin e njësisë në krye muarën gjendjen në duar. Në dy turne, nga agimi gjer në mesnatë, rrafshnalta e bardhë gjëmonte papushim. Buldozerët, si gjigantë prehistorikë rrëmbenin sa mundnin nga masivi i bardhë dhe e nxirrnin në sinoret tej. Pas tyre, rrëgëtima traktorësh buçisnin pa ndërprerje, duke pluguar. Dhe toka e ngrirë, në atë përleshje vigane, dukej sikur ushtonte nga thellësitë. Deda me dy komunistët e tjerë ishin vazhdimisht në krye në të dy turnet. Po me ta, edhe komandanti i njësisë, me Gjergj Martinin e Gjetë Sokolin. Kur ndokush mbetej, ai i pari u derdhej në ndihmë.

— Shoku komandant! — i tha një mesnatë Deda — Shkoni të pushoni pak. Kini ditë që s'preheni asnjë çast!

Ai buzëqeshi e i ra krahëve brigadierit.

— Harrove zotimin që muarëm në organizatë? Ne duhet të jemi që të gjithë në vijë të parë. Ky është dyluftim, Dedë!

Tjetri heshti.

«Njeri i hekurt» — tha me vete.

Dhe beteja vazhdoi.

## V D E K J A E F I L L R O J T E S I T

— Alo! Alo! Reparti 6001 Novosej? Alo! Alo! Alo, Novosej? Novosej? Alo! Epo përgjigju more shok! Përgjigju, të shkretën!

Ai rrotulloi dhe disa herë dorezën e telefonit dhe priti me nervozizëm. Po prapë s'u përgjegj njeri.

— S'del — tha i zyrtë toger Gjetë Sokoli. — Ec e mos e fut në arrest po deshe! — Dhe provoi të merrte centralin e lokalitetit. Po edhe nga Shishtaveci asnjë rrëgëtimë telefonike nuk i erdhi në vesh.

— E mori dreqi, e mori! Do të jetë këputur linja! — thirri atëhere me zemërim duke përplasur mbi tavolinë receptorin.

Jashtë natyra shfrynte me egërsi. Bora përplasej mbi xhamat e dritareve plot ngulmim, sikur donte të shtrohej këmbë kryq edhe mbi ato. Po sado ngulmonte, flokët e saj të shpeshtë e të mëdhenj prapë rrëshqisnin e binin tatëpjetë. I përhumbur, toger Gjetë Sokoli hodhi sytë andej dhe ju afrua njerës prej dritareve.

— Çfarë skene! — tha me vete. — Kësaj i thonë çmëndje e natyrës! — Ju duk sikur pylli përballë po shkulej i tëri nga themelet. Në krye të tij, një lis shekullor po hepohej si ndonjë fidan plepi. Lisi ish disi i veçuar nga të tjerët.

— Çudi! — tha.

Po, pa e mbaruar këtë fjalë, trangu vigan, duke u hepuar, u këput në mes me një kujë tronditëse. Pastaj,



i mbështjellë me borë, u rrokullis si ndonjë ortek mbi shtresën e bardhë që prirej tatëpjetë.

— Jo — tha Gjetë Sokoli me shqetësim. — Në këtë egërsim të natyrës është e pamundur të gjendet vendi ku do të jetë këputur filli telefonik. Duhet pritur gjersa të qetësohet disi moti.

Në mesditë, era e pakësoi shpejtësinë e, dalëngadalë, pothuaj u ndal krejt. E po ashtu, edhe bora. Po qielli ende ishte i veshur me re të murme e të shpeshta.

— Duhet përfituar nga rasti — mendoi oficeri. — Bora e tufani përsëri mund të fillojnë. Kurse, pa ndërlydhje, s'ka komandim, dhe pa komandim, s'ka rezultate, fitore....! — dhe menjëherë thirri ndërlydhësin telefonik dhe dy nga korierët e komandës së nënrepartit.

— Shokë! — ju drejtua korierëve. — Do të niseni sëbashku, se rruga është e vështirë. Këtë letër do t'ja çoni kryetarit të lokalitetit në Shishtavec. Na ka premtuar të na huajë një sasi karburanti. Thua jini edhe me gojë: Jemi ngushtë. Sasia që patëm po na mbarohet, kurse rruga për në Kolosjan ku mund të furnizoheshim është zënë qysh dje nga bora. Gjithashtu, do të bëni çmos, që karburanti i premtuar të na mbërrijë sonte, ose të shumtën, nesër në mëngjes shpejt. Transportin do ta bëjnë ata vetë me kafshët e tyre: E qartë?

— Si urdhëron, shoku Gjetë! — tha përgjegjësi i korierëve.

— Tani, edhe një porosi tjetër. Meqë kushtet janë të vështira, do të merrni me vete edhe ushtar Çelon dhe do të ndiqni linjën telefonike. Kur të gjendet vendi ku është këputur filli, do ta ndihmoni, deri në rivendosjen e plotë të linjës. Pastaj, rrugët tuaja do të ndahen. Ju do të vazhdoni për në Shishtavec, kurse Çelua do të kthehet menjëherë në repat, mbasi edhe linjën Turaj-Kolosjan nuk e kemi në rregull. Por, me një kusht, ama: Çelua të kthehet, nëse linja e këputur s'do të jetë larg prej këndeje. Përndryshe, do të shkoni e do të ktheheni së bashku. Udhëtimi vetëm, në kushte të tilla anormale, mund të sjellë fatkeqësi e rreziqe. Më kuptoni besoj?

— Si urdhëron, toger Gjeta.

— Mirë. Tani nisuni, pa humbur kohë. Kini gjithë gjithë pesë orë ditë në dispozicion, kurse vajtje-ardhje ju presin rreth gjashtëmbëdhjetë kilometro rrugë. Edhe një herë ju porosis: pa humbur asnjë minutë. E qartë? Nisuni! — dhe, duke rudhur ballin, hodhi vështrimin mbi akrepat e orës që nga të ftohtit, dukej sikur rëgëtitinte me përtësë.

Të tre ushtarët, duke marrë drejtqëndrim, nderuan dhe dolën.

\* \* \*

— Çelo! Çelo! Epo hë de, hë, se na zuri çërma, more shok! — u dëgjua një zë ankonjës nga rruga.

— Vërtet u vonova! — mendoj fillrojtësi me vete dhe që brenda kabinës së centralit telefonik, thirri me sa fuqi që pati: «Erdha shokë, erdha!» Pas pak i ngarkuar rëndë me mjetet që do t'i nevojiteshin për rregullimin e linjës, u duk tek po shpejtonte drejt tyre.

Shokët e pritën të ngrysur. Ai e ndjeu atë ftohtësi e zemërim të tyre. Megjithatë si njeri dhe tjetri, s'munguan t'ja hiqnin nga duart e nga shpina një pjesë të asaj barre.

Njeri nga korierët, ai më i riu, Zenun Tarabullaku, që para një muaji sapo kish dalë nga karantina, mbeti i habitur, kur pa edhe kazmë e lopatë midis veglave e aparateve që mbarte fillrojtësi në krahë.

— More! — tha — Mirë që s'paskë ngritur tërë magazinën a i shkretë! Edhe kazmë e lopatë, ke marrë me vete? Bre, Bre! E ç'lidhje ka lopata me telefonin?

Fillrojtësi, e përmbajti disi gazin, kurse përgjegjësi i korierëve që kish qëndruar i ngrysur gjer në atë çast, ja plasi një të qeshuri me të madhe dhe, duke u gajasur, thosh herë pas here: «Hajde Zeno Tarabullaku, hajde! Vërtet je gjenial!»

Zenuni i hutuar, e humbi toruan për një çast. Pastaj, i fyer, tha: «Ç'më zbardh dhëmbët, si guak?... Mua s'ma hedh dot! Kazmat e lopatat s'mund të kenë kurrë lidhje



me telefonat. Ato asnjëri s'i fut dot në një familje... Sepse familja,... familja,... siç na e ka shpjeguar një herë një i deleguar që erdhi në fshat...

Përgjegjësi i korierëve, që akoma gajasej së qeshuri, ja mori fjalën nga goja.

— More, në këtë rast — tha ai me gjysma fjalësh — hyjnë që ç'ke me të!

— Hyjnë? Në këtë birë hyjnë! — dhe tregoi brylin.

— Ma vërteto, po munde, ky hyjnë?

— Ta vërtet... Ta verte... verte... to... to... toj unë — ja bënte përgjegjësi, po të qeshurit me lotë në sy, s'e linte ta shpinte atë frazë gjer në fund.

— Avdall! Ditke vetëm të zbardhësh dhëmbët! — ja plasi tërë inat ai i karantinës. — Po mua, ja ku ta them edhe një herë, nuk ma hedh dot! Lopata me telefonin as ka patur e as do të ketë ndonjëherë ndonjë lidhje a afrim, Për këtë pyesim edhe shokun Gjetë, po të kesh qef...

Përgjegjësi, duke mbajtur ijet me dorë, akoma gajasej së qeshuri.

Tjetri shikonte vëngër dhe turfollonte. Ai ish njeri babaxhan, i pazhvilluar e tepër naiv, që s'dinte t'i binte në qafë njeriu, po edhe që fyhej shpejt, kur kujtonte se ndokush mundahej ta vinte në lojë.

Duke menduar këto, përgjegjësi i korierëve nduku buzët fort, fshiu sytë që i qenë përlotur nga ajo e qeshur e papërmbajtur. shtrëngoi dhëmbët dhe, duke rrudhur ballin me zor, u mundua t'i jepte fytyrës seriozitet. Po në çipat e buzëve, akoma i shquhej ai gaz spontan, që priste vetëm një shtytje sado pak të vogël, për të shpërthyer përsëri e ndofta më me forcë se më parë.

— Komedi pa të keq! — mendoi me vete fillrojtësi.

Pastaj, një heshtje e shkurtër ra midis të treve. Ecën kokë ulur.

— Më fal, Zenun! — i tha përgjegjësi dhe i hodhi kra-hun mbi sup.

Tjetri ja largoi.

— Ndofta e teprua me atë të qeshur — vijoi i pari me pendim. — Po ne jemi shokë. Ti e di: qeshim pa të keq me njëri tjetrin. Veçse, dhe gazin, ma shtoi këmbë-

ngulja jote, kur thoshe se lopatat s'kanë asnjë lidhje e s'mund të futen në një familje me telefonat e aparatet telefonike.

— Ashtu thashë dhe ashtu them! S'kanë pasur e as do të kenë ndonjëherë! Dhe ta dish: mua nuk ma hedh dot.

— Kanë — tha fillrojtësi. — Do ta shohësh në vend e do të bindesh. Shpesh, pa këtë kazëm e këtë lopatë, gjithë këto aparate do të ishin kot.

Zenuni s'foli, po me vete prapë dyshoi: «Si? Tallet, apo e ka me gjithë mënd?»

Pastaj, të heshtur, përmes borës, të tre duke ndjekur shtyllat e linjës telefonike, vazhduan në kërkim të fillit të këputur.

\* \* \*

Nja tre kilometra larg qendrës së repartit ushtarak, një shtyllë ishte thyer që në rrëzë. Me kokë poshtë, ajo varej në tatëpjetën grykë një përroji, që kalonte përmes një pylli të vogël, të mbuluar me drurë mështekne të bardhë. Prej asaj shëmbjeje, edhe teli ishte këputur e ndarë në mes.

— Sa keq qënka përmbysur! — tha Zenuni.

Fillrojtësi nuk foli. E as përgjegjësi i korierëve.

— Duhet rivendosur! — tha pas pak fillrojtësi.

— Ku? — pyeti korieri.

— Afërsisht në vendin që ka patur. — Kuptohet, diku këtu pranë. Megjithatë, ende s'mund të thuhet ekzaktesisht se ku. Ç'është e vërteta, në këtë borë gjurmët s'gjënden dot kollaj...

— Ashtu, ashtu — ja bëri edhe përgjegjësi.

Fillrojtësi me hamendje, përcaktoi vendin.

— Ja, këtu ma merr mëndja, se duhet kërkuar! — dhe pa e zgjatur, rrëmbeu lopatën e filloi nga puna. Edhe përgjegjësi me Zenunin zunë të largonin me duar borën rreth e përçark vendit, ku mendohej të kish qënë shtylla telefonike.



— E mori dreqi, e mori! — tha fillrojtësi. — Edhe era që kish pushuar, me sa duket po fillon të tërbohohet përsëri.

— Era dhe bora! — tha përgjegjësi. — Këto fluturza që po shpeshohen kaq shpejt, nuk më pëlqejnë.

— Sidoqoftë, janë ende të vogla e të pakta — tha fillrojtësi, pa e vënë re shpeshimin e tyre.

— Të vogla, e të pakta, pa shihe një herë pelerinën e bustinën, si t'i kanë bërë! T'i kanë thinjur krejt, Çelo Labi...

— Ashtu, ashtu! Ç'të thinjur, se! — tha Zenuni, dhe duke u fryrë duarve të bëra akull, që dukej sikur do t'i kullonin gjak, u ankua: «Më ngrinë, Çelo! Më ngrinë, të flamosurat».

— Mos u fryj! — e qortoi fillrojtësi. — E ngrohta i dëmton edhe më keq.

— E di, e di, kështu thonë, po s'po i duroj dot, të mallkuarat.

Megjithatë, nuk u tërhoq. Duke i hukatur herë pas here, vazhdoi pranë shokut që kish përkrah, gjersa një zë u dëgjua:

— Ja! Ja vendi ku është thyer shtylla!

Në atë copë vend të zbuluar, dheu i lagur, në kontrast me dëborën e bardhë përqark, ju duk Zenunit, si ndonjë vatër zjarri e shuar. Pastaj pa fjalë, duke rrokur kazmën, përgjegjësi nisi i pari gërmimin e dheut. Toka e lagët dhe e ngjeshur nga lagështira, hapej me të vështirë.

— Mjaft! — tha më në fund fillrojtësi. — Prit një herë, sa të heq dheun e grumbulluar!

Përgjegjësi u zbraps.

— E? — i tha Zenunit — e kupton tani, se ç'lidhje kanë kazmat e lopatat me linjat e aparatet telefonikë? dhe pse, ndonjëherë, mund të hyjnë edhe në një familje? E shikon se pa këto s'do kishim si ta hapnim këtë gropë? E pa këtë gropë, e pa këtë shtyllë, s'do kishim si ta rivedosnim liniën. E kuptove tani pse...?

Tjetri u skuq e uli kryet.

— S'e kisha menduar kështu, Çelo! — dhe duke ja rrëmbyer kazmën nga duart, e çoi deri në fund hapjen e

gropës. Pastaj të tre ushtarët ngritën shtyllën dhe e rivendosën, duke e mbushur gropën dhe duke e ngjeshur dhe-un lopatë pas lopate.

— I erdhi radha fillit të këputur — tha fillrojtësi dhe u derdh drejt shtyllës tjetër, për t'i bashkuar fijet midis të dy krahëve. Në fillim s'po e gjente vendin ku ishte këputur, po dhe kur e gjeti, prapë nisi të shfrynte e të ankohej me zemërim.

— More, s'vunë mënd këta njerëz xhanëm? Po të gjejnë tel përtokë, do ta këpusin se do ta këpusin ndonjë copë për ta çuar në shtëpi. Po pse, xhanëm, tel për të varur leckat është ky a?

E megjithëse telin e kish këputur e përklarë tufani, fillrojtësit, që njëherë i kish takuar të shikonte një malësor të këpuste një copë teli, i bëhej sikur edhe tani gjithë fajin e kish ndonjë nga vendësit. Dhe ashtu duke shfryrë ju afrua shtyllës së porsa ngritur. Pastaj me anë të pincave universale, preu disa metra nga teli rezervë që kishte marrë me vete, e lidhi me pjesën tjetër e duke e tërhequr zvarrë fillin, e afroi drejt shtyllës.

— Po tani? — pyeti Zenuni, të cilit i qe bërë flakë maja e hundës e që kish filluar ta ndjente të ftohtit në palcë.

— Tani u erdhi radha këmbalecëve! — dhe duke i futur në këmbë, i shtrëngoi fort rripat e tyre. Ata kishin formën e një drapëri me dhëmbë të mëdhenj e të hekurt brenda.

— Po këta dhëmbë? — pyeti përsëri Zenuni.

— Kafshojnë dhe ndihmojnë që t'u ngjitesh në majë shtyllave — qeshi fillrojtësi, që tani si ndonjë millona, zbardhte i tëri.

Tjetri nuk foli. Ishte hera e parë, që i shihte së afërmi ata këmbaleca hekuri.

— Ç'ka shpikur mëndja e njeriut! — tha pastaj, me gjysëm zëri. — Po kjo është të lësh mendjen, ama!

Përgjegjësi, sa nuk ja dha të qeshurit përsëri, kurse këtë herë fillrojtësi nuk u përmbajt. Ai qeshi me gjithë zemër e pastaj e përqafoi.

— Eh, more Zenun Tarabullaku! — tha. —



— Mos vdeksh kurrë... Ti vërtet je një numër që s'gjëndesh lehtë.

— More, thuaj si të duash, ti, po vërtet, është një çudi e madhe kjo! Ku i ka vajtur mëndja, xhanëm, ta shpikte këtë drapër të hekurt me dhëmbë, për t'ju ngjitur shtyllave në majë?!

— Vërtet është një farë çudie — tha fillrojtësi. — Po më e madhe si shpikje, thonë se he për he është ajo e vajtjes në hënë.

— Ashtu thonë. E kam dëgjuar dhe unë — tha edhe përgjegjësi, që akoma gajasej. — Veçse për këtë duhet pyetur një herë se ç'thotë edhe shoku Gjetë...

— More atë s'ma hidhni dot mua, se po qe puna për më e madhe, është ajo e vajtjes në hënë! — tha Zenuni duke i dhënë fjalës siguri e ton të prerë. — E, po s'besuat, pyesim edhe shokun Gjetë, që rri tërë ditën me gazetë në dorë.

— Ky të këput! — tha rishtas përgjegjësi. — Ky vërtet të këput në brinjë! — dhe, ashtu siç ish, ra mbi borë, duke u gajasur i tëri.

Po këtë herë, nga gazi i të dy shokëve, pa e marrë për ters, qeshi edhe Zenuni. E, bile, më fort se dy të tjerët.

Mbas pak, gazi u meh disi. Fillrojtësi mori rripin e sigurimit dhe, duke e ngjeshur për mezi, e vërtiti edhe rreth shtyllës telefonike. Pastaj mbërtheu tokenë dhe, duke mbajtur në njëren dorë fillin, që do të lidhte në krye të shtyllës, filloi të ngjitej përpjetë.

— Të pengon gjë? — pyeti përgjegjësi i korierëve, kur fillrojtësi arriti në majë.

— Jo. Veçse duart, nga ky drej thëllimi, më kanë ngrirë krejt.

Megjithatë, nuk i hukati. Hapi shpejt e shpejt litarët e makarasë. afroi kokat e telit të të dy anëve, i futi në makara, i tërhoqi, për t'i shtrirë e për t'i afruar me njëra tjetrën, pastaj, me anë të pincave universale, bëri lidhjen.

— Tani, makaratë e kryen punën e tyre — tha ai, dhe i largoi nga duart.

— Domethënë linja u lidh! — tha përgjegjësi.

— Jo. Akoma mbetet edhe diçka për t'u verifikuar — tha fillrojtësi dhe, në çast, rrëmbeu aparatën e kontrollit e i ra ziles.

— Alo! Alo, Kel!

— Ore! — U habit Zenuni — Kujt ore, kujt po i flet ti, nga maja e atij druri? Po mua s'ma hedh dot, ama! Që aty, s'ka asnjë mundësi, që të flasësh me të tjerët... Oj, oj, na futka dhe emrin e Kelit brenda, sa për të na ngatërruar mëndjen!

— Do të më rrëzosh — tha fillrojtësi, duke e ndjerë gazin, që po i shpërthente në buzë.

Përgjegjësi s'u mbajt. «Ky është vërtet tarabullaku», tha me vete, dhe ja plasi sërish të qeshurit.

— Alo! — vijoi njeriu i lidhur me rripin e sigurimit përmezi — Alo! Centrali i repartit? Jam fillrojtësi, Kel!

— Të lumtë! — dëgjoi një zë të trashë — Kaq shpejt, Çelo?

— Po, Kel. Mbarova shpejt. Linja ishte këputur këtu pranë. S'ndodhem as tre kilometra larg. Po kthehem menjëherë, për të rregulluar edhe linjën Turaj-Kolosjan. Veçse, kjo dreq erë e dëbore, që filloi, sikur ma prish disi terezinë. Nejse... do t'ja dal në një farë mënyre... Më dëgjon? Tani, po munde, më jep pak komandën. Shokun Gjetë, dua.

Zilja ra. Ai u gëzua. Linja ish rregulluar plotësisht. Po ushtari që i doli në telefon, i tha se toger Gjeta, i thirrur nga kapiten Gjergj Martini, kish shpejtuar drejt parcelave, ku disa makina gjigande po përlesheshin me togjet e panumurta të masivit të bardhë, nën kuotën 2026.

Pas një rahjeje të shkurtër mendimi, por të nxehtë e këmbëngulëse nga të dy palët, Çelo Labi i bindi të dy shokët, për t'u kthyer i vetëm, e sa më parë në komandë. Ai u vuri si arësye linjën jo në rregull Turaj-Kolosjan, se dhe që prej aty as tre kilometra s'e ndanin gjithë, gjithë nga komanda. Pas kësaj, pa humbur kohë, të dy korrierët shpejtuan tatëpjetë drejt Novosejt e Shishtavecit, kurse Çelo Labi, i vetëm, në drejtim të kundërt me ta, ju vu së përpjetës drejt Turajt e kuotës 2026 metro.



— Erë e fantaksur! Erë e çmëndur! — tha me vete, duke e parë pisk, në atë ngjitje të vështirë. Megjithatë, sado i ngarkuar rëndë e në kushte të këqia terreni, u mundua ta shpejtonte hapin nëpër shtigjet nga kishin ardhur. Po gjurmët nuk shquheshin më. Bora që kishte rënë, i kishte mbuluar tej e tej.

— Këtu kuptohet, se sa shumë bije! — tha ai, dhe ktheu kryet për të parë nëse dukeshin, gjatë tatëpjetës, dy shokët e tij, që po i afroheshin Novosejt. Po asnjë prej tyre nuk shqoi.

— Sidoqoftë, në tatëpjetë e kanë disi më lehtë — tha prapë, duke e ndjerë peshën e asaj ere të ndërkryer, që po i merrte frymën — Duhet qëndruar pak! — mendoi. Dhe priti. — Ç'erë e mallkuar! Po më zë frymën fare! — dhe shikoi rrotull. Asnjëri s'dukej përçark. — Mos ndofta bëra keq që u shkëputa prej tyre? Shoku Gjetë më tha...

Era lebetitej. Një stuhi tjetër shfryu dhe ai e ndjeu nën këmbët tokën që uturinte, sikur do të çahet e do të përpinte çdo gjë rreth e rrotull.

— Male ka edhe te ne! — tha me ankim. — Po tufane të tillë andej kurrë s'pata njohur ndonjëherë!

E shkëputi nga këto mendime një krismë që u dëgjua si nja treqind metro mbrapa tij. Atë ças një pishë e madhe, që po hepoej, u thye e ra mbi linjën telefonike, e duke u rrëkëllyer teposhtë, shkoi e u ndal mbi një faqe të sheshtë të pllajës. Fillrojtësi e pa e ju duk si ndonjë dekor i gjelbër, si ndonjë qenie e gjallë, e cila, mbas asaj ndeshjeje mbinjerëzore në atë hapësirë të shqetësuar të masivit të bardhë, po shkonte për të pushuar sado pak. I erdhi keq për pishën. Po një mendim tjetër e stepi në çast:

— Mos vallë pisha kish këputur përsëri linjën? dhe ashtu prej së largu, u mundua ta shquante fillin telefonik.

Po largësia dhe moti i mjegulluar nga bora, s'e lanë.

— Duhet afruar — tha, dhe duke devijuar rrugën, nxitoi e u hodh matanë, andej nga kalonte vargu i shty-

llave telefonike. Po kur u qas, i theri në zemër. Teli i këputur varej tatëpjetë.

I heshtur e i vetëm, ju vu punës.

— Duhet shpejtuar! Bora që bie dhe mjegulla që po fillon të ngrihet, s'janë shenjë e mirë! — dhe prapë i përdori majë shtyllës pincat universale e makaranë, këmbalecat e aparatit telefonik të kontrollit. E përsëri, i lidhur për mezi me atë rripin e sigurimit... Sa përpjekje e mundim ju desh në atë mot të keq! Punë me rrezik jete! Mund të përmbysej nga çasti në çast. E, megjithatë, tani po e shihte se e gjithë ajo punë i kishte shkuar kot. Teli ish lidhur, po aparatit të tij të kontrollit, nga maja e shtyllës, nuk po i përgjigjej njeri.

— Centrali i repartit! Centrali i repartit! Alo, Kel! Kel! Alo! Po pse hesht, more shok, pse?

Zë në shkretëtirë! Askush s'po e dëgjonte, askush s'po i përgjigjej! Në atë rrebesh, linja telefonike, edhe diku tjetër ish këputur. E, ndofta, këputur, e përmbysur më keq se më parë. Atë këputje, Çelo Labi e ndjeu thellë në zemër. Si në mjegull i shfaqej tani përpara syve fytyra e mvrejtur e oficer Gjetë Sokolit.

— Çudi! — tha i prishur në fytyrë. — Kurrë s'e kisha menduar kështu dhe kurrë s'më ka ngjarë në këtë mënyrë... Kurrë! Sidoqoftë linja e këputur do të jetë në drejtim të repartit. Akoma ka dhe një copë ditë... Unë do ta gjej e do ta lidh. Pastaj, do të lidhem me Kelin, me toger Gjetën, me kapiten Gjergjin... Veç më vjen keq që komandantit të njësisë s'ja mbajta dot fjalën... I pata premtuar se linjën do ta kish në rregull për të na marrë nga çfarëdo largësie që të ndodhej... Por tani... tani, as ky krah dhe as i Kolosjanit nuk janë në rregull...

Dhe ashtu i ngarkuar rëndë, përmes borës e mjegullës, i ngrirë, i lodhur e i pangrënë gjatë gjithë asaj dite, në shtigje të parrahura, me, hamëndje, ai vazhdoi rrugën drejt repartit. atje ku e prisnin Keli e toger Gjeta, kapiten Gjergji e kolektivi.

E gjeti më në fund vendin ku ish këputur filli dhe e lidhi. Përsëri po me ato këmbaleca, po me ato pinca universale, po me atë aparata kontrolli...



— Kel, a më dëgjon?

— Të dëgjoj, Çelo, të dëgjoj... Ti je një hero, shok! Veç ta kam frikën, nata afro! A do të dish ta gjesh rrugën?

— Do të mundohem, Kel! Veçse fuqitë më janë sorsur... Ky dreq tufani edhe frymën po ma merr... E megjithatë s'jam i qetë për komandantin e njësisë, Kel! Linja Turaj-Kolosjan...

— Shpejto, Çelo, shpejto! Nata...

Dhe ai u nis. Po që në hapat e para, e ndjeu më shumë erën që po i merrte frymën, gjunjët që po i pritëshin, sytë që po i visheshin.

— Po sikur të mbetem këtu? — Dhe ashtu siç ish, eci dhe eci gjersa gjunjët s'e mbajtën dot më. I marramëndur u ul mbi borë. Pastaj, me dorën që i dridhej, nxorri bllokun dhe shkroi:

«Shoku Gjetë,

Po ju drejtohem si ushtar e si komunist. Të më falni për sa ngjau. Është hera e parë dhe ndofta e fundit, që nuk e mbajta fjalën. Fjalën dhe urdhërin. Juve do t'ju vijë keq. E di? Di gjithashtu, që do t'ju qortojë në emër të komandës komandanti i njësisë e do t'ju qortojnë gjithashtu si komunist edhe në organizatë. Po fajin e pata unë vetë. Veprova ndryshe krejt ndryshe nga porosia që më dhatë, si dhe nga këmbëngulja e dy shokëve që kisha me vete. Sidoqoftë, e bëra pa të keq. Përsa u takon të hollave të kuotës së partisë, për muajin janar ato i kam hequr mënjanë. Do t'i gjeni në xhepin e sipërm të xhakëtës, që kam në trup. Edhe një porosi: jam i martuar. T'i thoni sime shoqeje të mos e mbyllë jetën me kujtimin tim. E di në bazë të zakoneve, qoftë nga familja ime, qoftë nga e saja do t'i bëjnë presion. Por ajo është e re. E ka jetën përpara. Ndaj duhet të martohet patjetër. Ndihmoheni në emrin tim, ju lutem, të mos thyhet para ndonjë presioni a zakoni të prapësht të së kaluarës, që akoma nxjerr krye në anët tona. Këto kisha. E, megjithatë vdekjes s'i jam dorëzuar. Unë do të luftoj deri në fund kundër saj, duke vazhduar rrugën për tek ju, rrugën për në re-part».

Dhe duke u ngritur, u mundua të mos linte asgjë nga materiali që kishte në ngarkesë.

— Sa barrë e rëndë! — u ankua me vete. — Po rruga ku është?

I dërmuar filloi të përçapej përsëri mbi masivin e bardhë. Po shtigje e gjurmë asgjëkund nuk pa. Ato i kish-te mbuluar bora qëkur. Kurse rruga ndodhej nja dy-tre-qind metra larg tij.

Dhe ai eci. Eci me hamendje, me sytë gjysmë të mbyllur nga lodhja e cfilitja. Edhe goja i qe tharë.

— Ah, të kisha pak ujë!

Shtriu dorën dhe e mbushi me dëborë. E përtypi.

— Ndryshe është uji! — tha.

Dhe eci. Përçapej me zor.

— Si dreqit s'pipëtin asnjëri në këtë krah? U err, pothua... Sidoqoftë, duhet të vazhdoj. Unë i shkrova shokut Gjetë, se s'do të ndalem gjer në fund!

Dhe prapë, duke u hepuar, bëri përpara. As ai vetë s'dinte më se ku shkelte. Binte e ngrihej buzë një humnere. Dhe ashtu, duke ecur, ra e s'u ngrit më. Ra, duke i shtrënguar fort në duar aparatet e veglat që kishte me vete. Ato i kish në ngarkim, e duhej t'ja kthente të gjitha repartit. E ashtu, me to, shkoi përmes borës, në atë grykë lugine, ndonjëzet metro të thellë...

— Ç'ngjau? — tha si nëpër gjumë. Dhe pa ditur se ku ishte, u mundua prapë të ngrihej.

— Jo, nuk mund të ndalem këtu! Toger Gjeta më pret. Po edhe kapiten Gjergji... Oh, sa keq! Kolosjani e Kukësi mbetën pa i lidhur... Kush'e di ç'do të thotë komandanti i njësisë! Ku jam? Oh, sa ngrohtë! Po si tha, si tha? «Midis kazmës e telefonave, s'ka asnjë lidhje?» Alo! Alo! Kel! Po lidhëm, lidhëm, more shok, me shokun Gjetë! Alo! Alo, Kel! Alo...

Dhe ashtu fjeti në fund të asaj lugine, i mbuluar nga ai masiv i bardhë.

Pastaj, bora e qetë, që vazhdoi të bjerë gjatë gjithë asaj nate, fshehu çdo gjurmë të shtegëtimit të tij në atë rrafshnaltë.



Në mbrëmje, karburanti i pritur nga Shishtaveci erdhi, po Çelo Labi nuk u duk në repart me të dy shokët e tjerë. Toger Gjeta, i tronditur, i qortoi rëndë të dy korrierët, që e kishin lejuar shkëputjen e kthimin e tij vetëm. Pastaj mendimet e supozimet rreth fillrojtësit qenë të shumta, gjatë asaj nate. Po ngado që vërtiteshin ato mendime, hija e vdekjes, gjithnjë nxirrte krye midis tyre. Më atë ankth në zemër, Gjetë Sokoli e Gjergj Martini s'fjetën, duke e pritur me padurim mëngjezin e ditës që do të gdhinte. Natë e gjatë! Orë të vështira! Flisnin e pastaj prapë një heshtje e rëndë e pushtonte dhomën e të dy oficerëve. Zjarri shpesh fashitej, pa u vënë re prej tyre, gjer në rrëgëtimën e fundit të ndonjë ure, Pastaj, të ftohtët i kujtonte, i sillte në vete... Dhe Gjeta, i heshtur, duke marrë ndonjë krah drush, kërrusej mbi vatër. Zjarri gjallërohej përsëri. Kështu kaloi ajo natë. Në mëngjez, me të zbardhur, të dy oficerët u ngritën menjëherë.

— Shoku komandant! — tha nënoficeri i shërbimit, duke u ndalur para Gjergj Martinin. — Sipas thirrjes suaj të mbrëmshme, kryetari i këshillit, me disa fshatarë vendës, ka ardhur e po pret.

— Silli! — tha Gjergj Martini.

Ata hynë. Ai u dha dorën, pastaj, hijerëndë, i vuri në dijeni për fatkeqësinë që mund të kish ngjarë.

— Sidoqoftë — tha — ne besojmë, se do të na ndihmoni për të kërkuar trupin e tij.

Dikush nga të ardhurit psherëtiu e tha se prej shtëpisë kishte parë një ushtar, që kish shpejtuar drejt rrjetit telefonik, ku qe përmbysur një pishë. « pashë kur vrapoi — tha ai. — Po e pashë edhe kur u ngjit majë një shtylle. Mendova: me siguri, pisha do ta ketë këputur fillin telefonik». — Pastaj, ballin rrudhur në atë ditë të ftohtë, po disi më të qetë se ajo e djeshmja, ata dhe një skuadër ushtarësh, u vunë në kërkim, duke zbritur së pari tek vendi i pishës. Për fat, gjatë gjithë asaj dite nuk shquan asnjë shenjë, asnjë gjurmë, mbi atë det të

bardhë që shtrihej nën kuotën 2026. Dhe kërkimi vazhdoi edhe të nesërmen, po trupi i ushtarit të humbur në borë nuk u gjet.

\* \* \*

Ish e qartë. Çelo Labi diku kish mbaruar. Vendësit thanë se, para shkrirjeve të pranverës, do të ish e vështirë gjetja e trupit të tij, të mbuluar nga bora.

Me anë të radios, komanda e nënrepartit vuri në dijeni komandën e njësisë për ushtarin trim, që kish rënë në krye të detyrës. Komanda, me një letër ngushëllimi, dërgoi një delegacion shokësh në familjen e ushtarit komunist fillrojtësit Çelo Labi.

Po ky lajm u muarr vesh edhe në qytetin, ku kish qendrën komanda e njësisë, si dhe në fshatrat, që përfshinte ai rreth. E atë e mësoi edhe i riu Merkur Metani, të cilin ushtar Çelo Labi, përmes valëve të lumit, e kishte rrëmbyer nga thonjtë e një vdekjeje të sigurtë.

Të nesërmen i vëllai i ushtarit të rënë, Sazan Labi, u paraqit para komandantit të njësisë.

— Jam i vëllai i ushtar Çelo Labit — tha — Kam ardhur për të mbushur vendin që ai ka lënë hapët, shoku komandant. Ju lutem të më pranoni. Kjo është edhe porosia e nënës dhe e babait: në vendin tonë s'duhet të ketë vend të zbrazët e pozicion pa ushtar...

Po atë ditë edhe Merkur Metani shprehu po atë dëshirë.

— Çelua më shpëtoi jetën. Kur e pyeti nëna, se si quhej, ai i dredhoi asaj pyetjeje, po unë e mësova emrin e këtij ushtari të vërtetë, ashtu siç mësova tani me hidhërim edhe rënien e tij. Prandaj erdha që ta zëvendësoj, shoku komandant.

— Këto kërkesa do t'ja shprehni kolektivit ushtarak, ku bënte pjesë komunisti e ushtari shëmbëllor, Çelo Labi! — u tha komandanti i prekur nga ato fjalë.

Pas pak ai u nis nga ai qyteti malor për në Shishtavec ku punimet po shkonin drejt fundit. Të dy djemtë



duke përfiturar nga rasti, udhëtuan bashkë me të gjer në vend.

Të nesërmen në kujtim të ushtar Çelo Labit, u zhvillua një ceremoni e thjeshtë në rrafshnaltë. Të dy vullnetarët, të emocionuar folën shkurt para ushtarakëve. Pastaj një minutë heshtje zije u mbajt në repart e një skuadër pushkatarësh, me një breshëri zjarri, përshëndeti për herë të fundit kujtimin e paharruar të ushtarit të rënë.

Pas ceremonisë sulmi filloi përsëri me ritmin e tij të zakonshëm.

Sado që kish qenë larg në ato katër ditët e fundit, komandanti i njësisë ishte në dijeni për gjithshka. Beteja për rrafshnaltën po shkonte drejt mbarimit të plotë. Ditën e nëntëmbëdhjetë, një ditë para zotimit, qilizma e kish përshtuar pllajën tej e tej. Objektivi i parashikuar ishte arritur. Po ajo pllajë ish vetëm një pjesë e vogël e rrafshnaltës. Sidoqoftë, ajo ishte një sihariq gazmor. Toka e hapur në pranverën e ardhshme, do të mbarsej me farë. Do të mbarsej me jetë.

I çelur, komandanti i njësisë i shtrëngoi dorën gjithë kolektivit, që kish marrë pjesë në atë betejë.

— Ju falemnderit, shokë! Ju u treguat luftarakë dhe ushtarë të vërtetë. Bij të denjë të Partisë dhe të popullit tonë.

Ata, gazmorë, i buzëqeshnin, e përqaфонin dhe prapë i shprehnin vullnetin për aksione të tjera, sado të vështira që të ishin ato.

Beteja kishte marrë fund e kurorëzuar me fitore të plotë.

Të nesërmen, ushtarë e traktoristë, nisën rrugën e kthimit për në bazë. Burra e gra të Turajt, pleq e fëmijë kishin dalë për t'i përcjellë.

— Mirë u pafshim, shokë!

— Udhë të mbarë e kthefshi me shëndet! Mos harroni: ju presim prapë në pranverë!

## NË FAMILJE

«Martë! Kjo është letra e katërt dhe ndofta e fundit që po të shkruaj që këtej. Javën tjetër, besoj do të jem aty. Më ka marrë malli shumë për ty dhe për Dritanin e vogël. Kushedi sa fjalë të reja ka mësuar. E përfytyroj shpesh. Sidoqoftë, javën e ardhme do të jem midis jush. Pute nga unë. Të përqafoj. Yti: Gjergji».

Ajo e lexoi letrën disa herë. Dhe priti. Por kaloi java e parë, po kalonte edhe e dyta, dhe ai ende s'po dukej. Mos vallë ajo e kishte kuptuar gabim kohën që ai i premntonte se do të kthehej? Lexoi përsëri letrën e fundit. Jo, jo, nuk e kishte kuptuar gabim. Po pse s'po kthehej? Dhe, si për t'u çmallur, filloi të lexonte letrat që i kishte shkruar Gjergji më parë me përshtypjet e tij nga rrafshnalta:

«Këtu, Martë, është si në polin e Veriut! — i thosh në njerën nga këto letra — Mbrëmë temperatura arriti në 26 gradë nën zero. Roja jashtë na ngriu. Erdhi në vete mbas disa orësh, duke i qëndruar mjeku mbi krye. Por, megjithëkëtë, asnjëri s'ankohet. Vetëm një nga traktoristët na u thye një ditë shpirtërisht. E trëmbi stuhia e tërbuar, që dukej sikur do ta përpinte rrafshnaltën nga themeli. Sa kam për të të treguar! Po ç'mund të thuash në një letër të vetme, nga gjith këto që kam parë e jetuar, gjatë kësaj kohe? Sidoqoftë, së afërmi, rreth tryezës so-



në të thjeshtë, unë do të të flas me hollësi, për të gjitha këto që po të shkruaj...»

Gjergji kish kënaqësi të bisedonte e të ndronte mendim me të shoqen. Jo me fjalë e për t'u dukur, por me qëndrimin konkret ndaj saj. Ai e çmonte dhe e trajtonte atë si bashkëshorte e bashkëlufëtare në jetë. Dhe ajo e kish ndjerë me kohë këtë trajtim e konsideratë të tij. Bile kjo ish edhe arësyeja që mungesa e të shoqit i krijonte një boshllëk të ndjeshëm në shpirt.

— Kur s'është ai — u thoshte shoqeve — s'di pse shtëpia më duket si bosh!

Dhe ashtu, priti edhe atë javë.

— Sa të gjata, këto ditët e pritjes!

Por një mbrëmje, një trokitje dëgjoi në portën e jashtme të shtëpisë. E njohu menjëherë.

— Ai — tha, dhe fluturoi shkallëve tatëpjetë.

Mbas saj, edhe Dritani i vockël.

— Babai, babai, — thërriste ai.

— Mos bijesh! — i thirri ajo, po nga gëzimi për të shoqin. s'e ndali vrullin që kish marrë. Pastaj, me të hyrë në oborr, ju hodh në qafë.

— Gjergj!

— Martë!

Ai e përqafoi dhe e puthi me mall.

Me atë nuhatje, që shpesh i shquan gratë, ajo e ndjeu mallin e madh që kish pushtuar edhe të shoqin, për të. Ndërkohë, rrotull tyre, i vogli vërtitej nëpër këmbë, duke pushtuar fort të atin.

— Baba! Baba!

Buzagas, ai e mori në krahë, dhe e puthi disa herë. Vogëlushi fluturoi nga gëzimi.

— Do të çuditësh, baba! — thosh — Do të çuditësh!

Në Shkodër erdhi plaku i vitit të ri! Erdhi te kopshti jonë... E pashë unë... E pashë...

— Çudi! — tha Gjergji. — Po si ishte veshur? Dhe pse erdhi?

— Ishte veshur me rrobe të reja dhe kish mjekër të bardhë! Erdhi, se e kish dërguar partia...

— Partia?

— Po. Kështu na thanë zonjush Pina e zonjush Lajdja. Erdhi, që të na sillte peshqeshe ne fëmijëve.

I entuziazmuar nga saktësia e atyre shprehjeve, ai përsëri e puthi fort të voglin.

— Po ty — pyeti pastaj — a të solli gjë?

— Po! — dhe shpejtoi me kutinë e dhuratave në duar.

— Vërtet të bukura — e përgëzoi i ati. — Shumë të bukura.

— Ja, shiko, baba, shiko çfarë treni e ç'maqinë më ka sjellë. Ja dhe një dhëlpër, një gjel, e një ari...

— Lere babin! — tha e ëma. — Dhuratat tregoja nesër, kur të jetë çlodhur.

— Jo babin, po babanë — tha i vogli, si për t'u hakmarur. — Babai vetë të ka thënë: «Shqip s'thuhet ashtu!»

Gjergjit s'ju mbajt të qeshurit e pastaj, edhe Marta qeshi me lot.

\* \* \*

Kishin ngrënë. Edhe Dritani i vogël kishte fjetur. E zuri gjumi në karriken afër t'et. Marta pranë sobës, po rropatej me drutë.

— Janë të trasha, të mallkuarat — tha me ankim.

— Po pse s'më flet mua? — tha ai me keqardhje dhe menjëherë rrëmbeu një krahë nga varica.

— Jo — tha ajo, — Ti je i lodhur, Gjergj. I çaj unë — dhe zgjati duart për të ndalur të shoqin.

— Lemë — tha ai, me një ton lutës. — Ti e di... Unë dy minuta i kam këto! — dhe i buzëqeshi.

Ajo u tërhoq, duke i hapur rrugë. Pastaj, zjarri u nder për bukuri dhe ata të dy, pranë e pranë, u ulën në tavolinë, duke pastruar së bashku orizin dhe patatet që do të gatuantë ajo për të nesërmen.

— Gjergj! — i tha, pas një heshtjeje disi të gjatë, — S'di pse këtë herë, m'u duk kaq e gjatë kjo pritje... Të të them të drejtën, më kish marrë malli si asnjëherë! — dhe duke e lëvizur karriken, ju afrua dhe ju mbështet mbi sup.



Ai e ndjeu atë zemër gruaje që rrihte. Pastaj, duke e marrë në krahë, e shtrëngoi fort, duke i lëmuar flokët, ata flokë dredha-dredha, që ja kish qejf e që i derdheshin aq bukur mbi supet e saj të hijshëm.

— Të dua! — tha ajo. — Të dua shumë Gjergj! Unë tani e kuptoj se ti je jeta ime e vërtetë...

— Ne jemi jeta e njeri-tjetrit — tha ai. — Të pandarë, që nga vegjëlia jonë.

— Ashtu, vërtet — tha ajo.

— Megjithatë, ti s'mund ta marrësh me mend, se ç'botë kujtimesh e ndjenjash më zgjonte ajo rrafshnaltë me fushat dhe humnerat e saj! Shpesh nga ato maja më dukej sikur e shihnja veten edhe një herë mbi Leqet e Hotit, edhe një herë mbi Vermoshin tonë!

Pastaj, Gjergj Martini, siç e kish zakon, i tregoi së shoqës gjer në hollësira, përshtypjet e tij, ato përshtypje të cilat ja kish premtuar edhe në letrat e dërguara që andej.

Ajo, e gëzuar, e dëgjoi, duke i qëndruar pranë. Vetëm vdekja e fillrojtësit e trishtoi gruan.

— Gjergj! — tha pas një heshtjeje të gjatë. — Po për punën e gradave, a flitej andej?

— Si s'flitej! Kjo çështje zien në të gjithë ushtrinë. I vumë kur na u deshën dhe po i heqim tani, që nuk na nevojiten më, tani që, në kushtet e reja të vendit, mund të na bëhen pengesë. Kjo është arsyeja. Kështu e spjegon partia dhe kështu është në të vërtetë. Ne e dimë se Luftën nacionalçlirimtare tanët e bënë pa grada, po mungesa e tyre s'i pengoi komandantët dhe komisarët partizanë, që të fitonin mbi oficerët dhe gjeneralët me akademë e grada. Bile, të zbathur, të zhveshur e të uritur, përballë një armiku të armatosur, të veshur e të ushqyer më së miri. Apo s'është kështu, Martë?

— Po — tha ajo. — Tamam kështu është. Po Gjeta, ç'thotë? Si i ka pritur ai këto ndryshime?

— Me disa rezerva. Sidomos, e ka shqetësuar heqja e dënimeve në ushtri. Ai s'e përfytyron dot se si mund të bëhet pa masa disiplinore, se si mund të bëhet duke u mbështetur vetëm në disiplinën e vetëdijshme të ushtarit.

Kjo vjen nga natyra e tij e mbyllur dhe pak e rëndë me të tjerët. Më vjen keq për të, se si njeri është i mirë, i pastër e i drejtë. Po durimi me njerëzit i mungon. Ai nuk i shkon gjer në fund çështjes, për t'i gjetur rrënjët burimit të së keqes në punë, dhe t'i shkuli ato rrënjë nga themeli i tyre, po e kërkon zgjidhjen me anë urdhërash të prerë e masash disiplinore, ndaj ushtarëve e diplomatëve vartës të tij. Dhe me këtë, ai kujton se puna bëhet dhe eprori ruan respektin dhe autoritetin në kolektivin ushtarak. Kurse shoku Enver na mëson të kundërtën: «Jo kur i dënojmë ushtarët, jo kur sillemi në mënyrë arrogante me ta, ka disiplinë dhe dashuri për njeri tjetrin...» po «vetëm kur sillemi drejt me ushtarin, në rrugë partie, atëhere ka disiplinë të vërtetë në ushtri...» Gjeta harron edhe një mësim tjetër: Shoku Enver e quan të shënjtë e me shumë përgjegjësi partie rolin e oficerit në ushtri. Ai, duke na u drëjtuar neve, thotë: «Ju jeni si mësuesi dhe profesorët e shkollave.... Po ju jeni të ndryshëm nga ata, pse mësuesi dhe profesori i shkollave civile i edukon dhe i pajis nxënësit me dituri, bën edhe seleksionimin e tyre kur u ve notë... kurse ju, jo vetëm nuk bëni seleksionimin e tyre në të mirë dhe në më pak të mirë, por vini tërë forcat e shpirtit dhe të mendjes suaj, që të gjithë të bëhen të mirë dhe ju i çoni vetë ata në aksione, në aksionin më të madh, në luftën për të mbrojtur dhe kur e do nevoja, vriteni tok me ta... në fushën e nderit».

— Sa bukur e ka përcaktuar ndryshimin midis ne mësuesve dhe ju oficerëve! — tha ajo. — Megjithatë, Gjergj, të të them ashtu si e ndjej, më vjen keq për Gjetën. S'di pse më duket si i shkretë... Po pse s'martohet xhanëm? Ndofta martesë, disi do ta ndryshonte jetën e tij.

— Unë mendoj se edhe këtu, barrikadë i është bërë natyra e tij, Martë! Natyra e tij e mbyllur. Gjithashtu, edhe hija pak e rëndë, prej malësori kryelartë, megjithëse thellë-thellë në shpirt ai nuk është i tillë. Po megjithatë, kokën s'e ka fort të kthjellët. Ligjet e kanunit



shpesh ja turbullojnë mendjen. Një çfaqje e tyre është edhe dëshira për gradat, apo tendenca për të dhënë urdhëra e pastaj dënime, kur s'i dëgjohet fjala deri në fund. Të paktën kështu e kuptoj unë.

— Sidoqoftë duhet ndihmuar — tha ajo.

— Ti e di sa e dua unë atë!

Ajo psherëtiu.

— Po mirë xhanëm, asnjëherë s'të ka folur për martesë?

— Edhe kur jam përpjekur të dal në atë shteg, ai ma ka prerë menjëherë.

— E çuditshme! — tha ajo me dëshpërim.

— Megjithatë kohët e fundit me dikë takohet. E kam parë nja dy herë. «E quajnë Katrinë — më tha një ditë. Është kelmendase, po që prej çlirimit familja e saj banon këtu në qytet».

Asaj i ndritën sytë nga gëzimi.

Atij i erdhi mirë që ajo gëzohej e intersohej për të.

— E pyeta — tha — po atij i vjen zor të flasë për çështje të tilla për vete. I skuqur u mundua t'i ikte pyetjes që i bëra. Sidoqoftë, mbrëmjeve kur të vijë këtu, hapja këtë bisedë po të mundesh.

— Do t'ja hap — tha ajo e çelur në fytyrë:

Ai i buzëqeshi. Pastaj i lodhur siç ish, i hodhi kra-hun së shoqes e të dy bashkë bënë tutje drejt dhomës së gjumit.

## LETRA E HAPUR

4 Mars.

Njerëzit, të grumbulluar rreth librarive, shtyheshin për të marrë «Zërin e popullit», o ndonjë prej gazetave të përditshme a periodike, që kishin dalë atë ditë. Ata që arrinin të merrnin, largoheshin për ta lexuar sa më parë.

— E çuditshme! — tha Gjetë Sokoli me shqetësim, kur e mbaroi së lexuari — E çuditshme!

Dhe, megjithëse në tërësi Letra e hapur e partisë ngrinte probleme kyçe, të cilat ju dukën plotësisht të drejta, prapë se prapë heqja e gradave dhe e dënimeve në ushtri nuk ju dukën me vend. Ai, edhe gjatë periudhës kur partia i kish shtruar këto çështje për diskutim nëpër reparte, kish mbajtur qëndrim të ngurtë e të prerë: «Pa grada, nuk mund të ketë hierarki ushtarake, e pa dënime disiplinore, nuk mund të ketë rregull ushtarak».

Po tani, ja edhe një çështje tjetër, me shumë rëndësi: ngushtimi i diferencave midis pagave!

Mos ndoshta ky ngushtim do ta prekte edhe atë? Pastaj, vargu i pikëpyetjeve e hutoi.

— S'di ç'mendon Gjergji! — tha më në fund me vete — po edhe atë do ta ketë shqetësuar sadopak çështja e pagës... Në këto ndryshime s'ka si mos t'i shkurtohet rroga edhe atij. E veç kësaj, sivjet prisnim edhe gradim që të dy!

Dhe, ashtu i ngrysur, doli nga zyra dhe shkoi në klubin e repartit.



— Një dopio konjak! — i tha kamerieres.

Ajo ja solli e ai e ktheu eks. Pastaj:

— Edhe një tjetër — i tha.

E po ashtu e ktheu edhe gotën e dytë.

— Ç'kini, toger Gjeta? — i tha ajo me habi.

— Asgjë. Është parë kapiten Gjergji këtej?

— Jo. Sot, jo.

Ai uli kryet.

— Edhe një gotë tjetër, Rozë!

Ajo ja solli dhe priti mos po e kthente eks.

Ai vërtet e ktheu. Dhe porositi të katërtën. Po këtë herë s'mundi ta kthente menjëherë. Dora ju drodh dhe fytyra ju rruadh nga neveria.

— Toger Gjeta! — ja bëri ajo, e shqetësuar. — Ju s'jeni mirë! Gjer ku do të shkoni kështu?

Ai i buzëqeshi me zor.

— Rozë — tha — Edhe një tjetër, e do të ngrihem.

— Jo — tha ajo, me keqardhje. — Unë s'mund t'ju shërbej më. Ju, me siguri, diçka keni, po sidoqë të jetë, s'është mirë që atë dëshpërim ta derdhni në këto gota konjaku! — dhe e heshtur vuri re se sytë e tij kishin filluar të mbylleshin përgjysëm, duke e humbur pamjen e tyre të zakonshme.

Ai ngulmoi:

— Sillëm! Sillëm, po të them! Të thashë edhe një, e do të ngrihem! — dhe bëri të ngrihej, për t'i dhënë gotën, po këmbët ju muarën e, pa e kuptuar, ra mbi karrike.

— Jo! — kundërshtoi ajo me vendosmëri. — Mbas asaj gote, ju s'do të jeni më në gjendje të largoheni me këmbët tuaja që këtej...

— Do të largohem! — tha ai, duke e shikuar rëndë në sy. — Po mos më detyro të shkoj e ta marr vetë në banak!

Ajo u mendua një çast.

— Mirë — tha — Do t'j'ua sjell... Po një gotë të zakonshme, ama!

Ai s'foli.

E piu, pagoi dhe u ngrit.

Këmbët përsëri ju muarën. U mbajt pas tavolinës dhe ashtu qëndroi për disa çaste, pa lëvizur.

— Gjetë! — i foli një nga shokët dhe i futi krahun.

— Jo — tha ai. — Unë mund të eci vetë.

Dhe i vetëm, e bëri atë rrugë gjer në zyrë. Pastaj, me t'u tendosur në karrike, ju duk sikur ajo dhomë dhe gjithë ajo ndërtesë u lëkundën nga një tërmet i rëndë e tepër i gjatë.

Dhe ashtu, në atë gjendje, e gjeti mbas dy orësh, edhe Gjergj Martini.

— Martë! — i tha në telefon së shoqes. — Na shto ndonjë send për drekë. Po vijmë bashkë me Gjetën.

\* \* \*

Tryeza që shtruar. Marta doli e i priti. Ajo gëzohej sa herë që Gjetë Sokoli vinte në ta. Miqësia e fëminisë, si dhe lidhja e vazhdueshme me Gjergjin, e kish bërë atë si njeriun më të afërt të tyre.

— Gëzohem, Gjetë. — Ke ditë që s'na je dukur!

Ai buzëqeshi.

— Ke të drejtë... Vërtet i kam disa ditë.

— Ulu! Ulu! — tha Gjergji i çelur, që tanimë pija i kish dalë.

— E doni rrushit, apo kumbulle? Të dyja janë të zgjedhura, — tha ajo buzagaz.

— Jo — tha Gjeta — Unë sot nuk mund të pi më.

— Sot? — ja bëri ajo me habi.

Gjergji s'foli.

— Po — shtoi Gjeta. — Diku piva, Martë. Piva rëndë...

— Çudi! — tha ajo. — Ti pa raste s'pi kurrë! Po cili që shkaku?

Ai u vrenjt.

— S'e di — tha — Mund ta kem gabim. Po disa probleme të ushtrisë në këtë Letër të hapur më duket se nuk janë shtruar drejt. Dhe këtë mendim, lidhur me këto çështje, unë s'e kam fshehur as gjatë diskutimeve paraprake në repart.



— Cilin mendim? E për cilat çështje? — tha ajo.

— Për punën e heqjes së gradave dhe të heqjes së dënimeve në ushtri — tha ai. — Të dyja do të krijonin një konfuzion e shthurje të atillë, saqë ushtria jonë, për së shpejti, kish për ta humbur krejt fizionominë e një ushtrie të vërtetë. Po në Letër, veç këtyre, u ngritkan edhe çështje të tjera, për të cilat s'është bërë fjalë më parë.

— Për shembull? — tha ajo me hutim, duke e vënë re shqetësimin e tij të ndjeshëm.

— Për shembull... ndryshimi i pagave. Këto s'janë çështje të zakonshme, Martë! Rroga e Gjergjit, si kapiten e komandant batalioni s'ka si të mos preket, në këtë rast. Po edhe imja, dhe e shumë të tjerëve si ne, besoj! A nuk sjellin të gjitha këto sëbashku tronditje e pakënaqësi në masë?

— Gjetë! — tha Gjergji. — Le ta kthejmë nga një gotë sa për urim, e, pastaj, duke ngrënë, bisedojmë për këto çështje që me të vërtetë kanë një rëndësi jetike për të ardhmen dhe socializmin në vendin tonë! — dhe, duke ju kthyer së shoqes:

— Martë! — tha. — Cila është prej rrushi?

Ajo shpejtoi dhe mbushi gotat.

— Për partinë! — tha Gjergji. — Për shokun Enver!

Pinë që të tre. Pastaj dreka u shtrua e me të edhe biseda rreth atyre problemeve sa të rëndësishme aq edhe të vështira.

Në atë rrahje mendimesh, Gjetë Sokoli u bind në një farë shkalle për një varg problemesh, duke përfshirë edhe heqjen e gradave, po s'pranoi kurrsesi heqjen e plotë të dënimeve dhe masave disiplinore në ushtri, si dhe ndryshimin e pagave.

— Heqja e dënimeve — tha ai më në fund e sidomos heqja e plotë do të krijonte në ushtrinë tonë një babiloni, kurse çështja e pagave do të sillte një det pakënaqësish.

Kishin mbaruar së ngrëni.

— Gjetë! — i tha Gjergji. — Kam një pyetje në vazhdim të kësaj bisede. Ç'do të kishim qënë ti dhe unë, pa këtë parti e pa këtë pushtet?

Tjetri s'foli për një çast. Pastaj:

— Pse ma bën këtë pyetje? — tha me një shprehje habie në fytyrë.

— Do ta marrësh vesh gjatë bisedës, po përgjigju një herë pyetjes që të bëra!

— Ajo dihet, Gjergj... Pa partinë...

— Dihet dhe s'dihet — tha i zoti i shtëpisë, i prerë.

— Po duhet ditur shumë e shumë më mirë nga sa dihet e sa vlerësohet nga ne të gjithë. Pa atë, njerëzit e kategorisë sonë, feudoborgjezët s'do t'i merrnin as për t'u kashaisur kuajt. Kurse sot, ti dhe unë, jemi oficerë. Sot, bijtë e atyre që s'i kish njeri në hesap, kanë frerët e shtetit në dorë. Frerët e ekonomisë, shkencës, kulturës, arteve. As më thua, kush i bëri të gjitha këto? E di. Ti do të më përgjigjesh: «Ajo». Dhe ashtu është: Partia i bëri. Po, megjithatë, ajo s'është një qenie abstrakte, e papërfytyrueshme, e pakapshme. Përkundrazi: Ajo përbehet prej njerëzish, duke nisur që nga ai që e themeloj, e që, përmes vështirësish e rreziqesh të panumurta, e udhëhoqi nga fitorja në fitore. Dhe besoj s'mund të mohohet se nga ato fitore kemi përfituar edhe unë, edhe ti. Familjet tona u bënë me tokë, kurse ne të dyve, si mijëra të tjerëve, shteti na dha bursë, na dha shkollë, na dha përgjegjësi në radhët e ushtrisë, na dha nder. A janë të vërteta të gjitha këto që të thashë? Ndofta të duket e tepërt një përgjigje e tillë, po unë këtë herë e pres këtë përgjigje. Gjetë!

— E kush mund ta mohojë këtë, Gjergj?

— Ashtu është... Askush s'mund ta mohojë... As edhe armiqtë! Po të kthejë kokën prapa cilido, do të shikojë menjëherë se ku kemi qenë. Dhe ngjitja vazhdon në të gjitha drejtimet. Më thuaj, ku është vepruar më serjozisht se tek ne për zhdukjen e pronës private



mbi mjetet e prodhimit? Ku më shumë se tek ne është luftuar dhe luftohet për emancipimin e plotë të gruas? Ku, në cilin shtet e vend të botës, punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, u janë hequr të gjitha taksat nga shpina, sikurse këtu? Ku, në ç'vend tjetër, të gjitha shërbimet sanitare, mund të merren nga i gjithë populli punonjës falas, si tek ne? Asgjëkund, Gjetë. Asgjëkund. Dhe, veç kësaj le të mos harrojmë se disa nga këto janë elementë të komunizmit ku punohet sipas mundësisë e merret sipas nevojës. A s'janë fitore të mëdha që të gjitha këto sëbashku? E, po kështu, çështja e fesë.

... Po a mund të bëheshin këto pa një përpunim të kujdesshëm e të fortë të ndërgjegjes e të botëkuptimit socialist të njerëzit tonë? M'u përgjegji, Gjetë!

— Jo — tha ai, i menduar. — Kjo, me të vërtetë, është një çudi, që të le gojëhapur.

— Çudia kryesore — tha Marta — Partia, me largpamje, përpunoi më parë kokat e pastaj tokat. Tani, me këtë çelës në duar, ajo mund të hapi cilëndo derë. Ja, pse, në fitoret, unë do të thosha se kjo është fitorja e saj më e madhe, që ka arritur gjer më sot, pas fitores së revolucionit.

Gjergjit i erdhi mirë që e shoqja filloi të merrte pjesë në bisedë. Ajo kish mbaruar dyvjeçarin e lartë për histori-gjuhësi dhe kish pasion për çështjet teorike. Si kuadër me kulturë, shpesh shkëmbente mendim me të shoqin, rreth këtyre problemeve, sa të rëndësishme, aq edhe të ditës.

— Ashtu është — tha edhe Gjergji, i menduar. — Në vargun e gjatë të fitoreve të saj, kjo padyshim, është më e shënuara.

— Unë do ta quaja fitore historike — tha Marta. — Dhe të gjitha këto sëbashku tregojnë se Partia ka vepruar drejt. Për të mirën e vendit. Për të mirën e popullit. Pra, edhe për të mirën tënde, Gjetë, edhe për të mirën time e të Gjergjit...

Gjetë Sokoli, kryeulur, psherëtiu.

Gruaja përballë e shikoi në sy me keqardhje. Ai lexonte fort rrallë letërsi artistike e literaturë marksiste.

Të vetmet libra që mbante në duar, ishin rregulloret ushtarake. Ato me të vërtetë i studjonte e i dinte përmendësh.

— Pra, kështu — tha Gjergj Martini, duke marrë fjalën. — Ti u binde gjer në një farë shkalle, se grada në ditët e sotme, për kushtet që ka vendi ynë, jo vetëm që s'janë më të nevojshme, po edhe mund të na pengojnë për t'i dhënë ushtrisë sonë një karakter sa më popullor. Ti pohove se thirrja për të qënë edhe ushtar edhe bujq, është me vend. Dhe këtë bindje, siç the vetë, ta krijoi beteja për Shishtavecën. Gjithashtu, gjatë bisedës, ti u shfaqe pro rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri. Të gjitha këto janë pozitive. Gjetë. Por, nga ana tjetër, ti ngule këmbë e the se je kundër heqjes së plotë të masave dhe dënimeve në ushtri. Gjithashtu ti u shfaqe kundër afrimit të diferencave midis pagave të ulëta me ato të lartat, duke menduar se preka e tyre do të krijonte pakënaqësi që mund të sillnin konsekuenca të rënda, sidomos në radhët e ushtrisë. Lidhur me çështjet e para, ne shkëmbyem mendim një për një. Kurse për pagat, jo. Do të bisedojmë edhe për këtë. Po, le t'u hedhim më parë një sy të shpejtë çështjeve që ngre në tërësi Letra e hapur e partisë. Partia i ngre këto probleme jo për të bërë zhurmë, po për konsolidimin e fitoreve që përmendëm më lart, si dhe për t'i çuar ato më tej. Por këto s'bëhen vetiu. Për t'ja arritur këtij qëllimi, duhet thellimi i luftës së klasave. Jo rastësisht partia e ngre sot me kaq forcë çështjen e burokratizmit dhe të burokratëve si armiq të popullit e të pushtetit të tij popullor. Dhe të mos harrojmë se kjo luftë kundër tyre, përderisa të kemi luftë klasash, do të jetë e vazhdueshme.

— E vazhdueshme? — tha ai me habi. — Po përse? Për çrrënjosjen e burokratizmit, do të mjaftonin vetëm disa masa teknike, dhe problemi do të merrte fund menjëherë.

— Çfarë masash? — tha Marta, duke e shikuar drejt në sy.



— Por ja, për shembull, a flasim për organika të fryra? Të shkurtohen. Të mbahen vetëm ata që me të vërtetë i duhen punës në pushtet, në parti, në ushtri etj. Të zhduken gjithashtu hallkat e tepërta e të panevojshme në organikat e organeve shtetërore, sidhe në ato të aparateve të partisë ose të ushtrisë. Dhe po kështu, të krasiten në maksimum letrat, shkresat e qarkoret zinxhir, që nuk sjellin asnjë dobi, përveç hamullisë dhe shpenzimit të kotë të letrës. Ja, kjo është e gjitha. Po t'ju pritëshin këto burime, burokratët miopë e tekaytë, sidhe burokracia si sëmundje e tyre, do të ngordhnin si peshku në zall.

— Ky është një spjegim tepër naiv e simplist — tha Marta, e nxehur nga fjalët e tij të fundit. — Kurse ne dimë se: masat në botë edukohen dhe drejtohen në dy mënyra. Aty ku ka fituar revolucioni: në mënyrë revolucionare, kurse atje ku sundon kapitali: në mënyrë burokratike... Pra, ekzistojnë dy koncepte për të drejtuar: koncepti burokratik antipopullor dhe koncepti revolucionar popullor. Njeri lufton tjetrin, për jetë ose për vdekje. Atje ku fiton revolucioni, burokracia e ka humbur betejën e parë, por armët ajo nuk i ka hedhur dhe lufton në forma të tjera, që e kanë burimin në traditat e regjimeve të kaluara, gjunahet e vjetra të të cilëve i paguajmë ne akoma edhe sot. Dhe, veç kësaj, Gjetë, kjo kategori njerëzish nuk janë aspak miopë e tekaytë, si i quajte ti pak më parë. Ata shikojnë para e mbrapa, majtas e djathtas. Dhe gjithnjë me një sy dinak, duke i bërë llogaritë sipas rastit dhe njeriut që kanë përballë. Pra, ata janë armiq të masave! Ata janë një e keqe shoqërore, që duhet shkukur me rrënjë. Përndryshe ata i nxjerrin rrënjët revolucionit... dhe atëhere pema që u mboll, u rrit e u vadit me aq gjak, thahet. Kujto fjalët e shokut Enver për burokratët....

Gjetë Sokoli, u trondit nga ato fjalë. — Unë, kam kujtuar për burokratë vetëm atë kategori nëpunësash të vjetër që merren me shkresa të stërgjatura, e që u fut nga ndonjë thumb «Hosteni» — tha ai — kurse, nga ky stigmatizim, s'di pse po më duket sikur i shoh me sy këta nje-

rëz, që nga administrata jonë e njësisë e gjer tek ato të hallkave më të larta të pushtetit.

— Kështu është, Gjetë, dhe kjo është edhe arësyeja, që partia kërkon të fryjë era e revolucionit dhe të rrjedhin ujërat e tij. Kënetat që flenë, bijen erë... Edhe diçka tjetër: Burokracia është si koni. Në majë duket si ndonjë pikë që mezi ta zë syri, po duke zbritur poshtë, zgjerohet e merr formën e një rrethi, pështa e të cilit ngandonjëherë u merr frymën masave popullore. Ja pse partia i jep rëndësi qarkullimit të kuadrít, pra, lëvizjes së gurëve që mund ta formojnë bazën e këtij koni. Dhe jo vetëm kaq, por në këtë letër, komunistë e kuadro pa parti, i fton t'i kthejnë sytë nga prodhimi. Puna në prodhim theksohet në Letër, të filtron, të shëndosh, të pastron. Atje më shumë se kudo, mund ta ndjesh veten njeri të dobishëm për shoqërinë.

— E drejtë — tha Marta. — Njerëzit e prodhimit me të vërtetë janë të pastër si ajri i maleve. Thuamë, Gjetë: a s'janë të thjeshtë këta njerëz? A nuk është kënaqësi të rrosh me ta, të mësosh prej tyre, t'u ngjash atyre?

— Ke të drejtë — pohoi me krye tjetri.

— Pra, kështu, — tha Gjergji. — Ky është dhe qëllimi që kuadro të rëndësishme të shtetit dhe të partisë po zbresin direkt në prodhim. Partia kërkon që secili ta ndjejë veten shërbëtor të popullit. Partia kërkon demokratizimin e pushtetit nga hallkat me të ulëta deri tek ato më të lartat, duke i treguar gjithkujt se s'ka karrike të përjetshme. Karrikja e përjetshme i takon vetëm popullit. E qartë?

— Ke të drejtë — tha tjetri, duke e shikuar në sy.

— E po ashtu, ajo lufton edhe kundër diferencave të theksuara në pagat. A dëshiron tani të ndalemi tek kjo pikë?

— Po. Unë ta thashë, Gjergji. Për mua kjo është pika më delikate, ose më mirë të them, çështja që mund të sjelli një varg të madh pakënaqësish.

Gjergji heshti një copë herë. Me brryllat në tryezë, mbështeti fytyrën mbi të dy duart e mbledhura grusht.



Gjetë Sokoli i vuri re tri vizat që ju thelluan mbi ballë e pastaj, edhe sytë gjysmë të mbyllur e të përhumbur të tij ju dukën sikur tani po shikonin diku larg, por jo në një pikë të përcaktuar mirë.

«Mendohet — tha e shoqja me vete. — Si duket, ende s'e ka të kthjellët se nga do t'ja nisë...»

Dhe vërtet, ai s'fliste pa i menduar gjërat gjer në fund.

Këtë veçori të karakterit të tij e njihte mirë edhe Gjetë Sokoli.

— Po përpiqem të ta shpjegoj. — tha më në fund Gjergji. — Le të vimë te problemi. Po marr Bashkimin Sovjetik. Atje e keqja erdhi nga sipër. Nga kasta e re, që u krijua pak nga pak. Dhe këtë kastë kryesisht e krijoi diferenca e pagave, privilegjet ekonomike...

— Diferenca e pagave? Po kjo diferencë mbështetet te parimi socialist i shpërblimit të njerëzve sipas punës. Dhe ky është parim leninist — tha ai, duke e shikuar me habi Gjergj Martinin.

— Parimi pranon diferenca, po ato duhet të jenë të përafërta — tha Marta.

— Lejimi i ndryshimeve të mëdha — thtoi Gjergji — kthehet në shkelje të vetë këtij parimi, Gjetë.

— Gjergj! — tha tjetri. — S'po të kuptoj! Po si është e mundur që i njëjti parim u ktheka kundër vetvetes?!

— E thjeshtë — tha Marta. — Fare e thjeshtë. Shkelja krijon në një formë tjetër po atë plagë shoqërore, që ekzistonte edhe para fitores së revolucionit.

— E the bukur — tha i shoqi — Marksi, duke e paraparë rrezikun e madh të këtij fenomeni, e ngriti këtë çështje, qysh në ditët e para të fitores së Komunës së Parisit. Dhe ky parashikim i tij, ja ku u vërtetua në Bashkimin Sovjetik, afro një shekull më vonë. Njerëzit e kastës së re, të joshur e të ëmbëlsuar nga diferencat kolosale të pagave, sidhe nga një varg privilegjesh të tjera shtetërore, e harruan origjinën nga vinin, e harruan 17-tën dhe luftën e madhe patriotike, e harruan gjakun e miliona bolshevikëve, e harruan popullin.

— E drejtë — tha gruaja. — Dhe këtë rol, në radhë të parë, e luajti rubla. Ajo i bëri t'i harronin.

— Tamam ashtu — tha i shoqi. Pastaj, duke ju kthyer mysafirrit, shtoi — Mendo, Gjetë, për një çast, një punëtor apo teknik, që merr gjashtëqind deri në tetëqind rubla në muaj dhe drejtorin apo inxhinjerin e ndërmarjes së tij, që merr gjashtëmijë... Përfytyroje këtë kontrast, sikur të ndodhte midis njerëzve tanë që bëjnë afërsisht të njëjtën punë, për shembull oficerëve e nënoficerëve. Le pastaj kategoritë e tjera të larta të aparatit shtetëror dhe të ushtrisë që atje marrin deri në njëzet fishin e rrogës së njerëzve të thjeshtë. Po a ka proporcione, këtu, Gjetë? A mund të flitet këtu për drejtësi shoqërore, për socializëm e shtet socialist, pa le pastaj për marrëdhënie vëllazërore midis klasave, punëtorëve e fshatarëve?

— Aspak — tha ai, me vëmendje të përqëndruar.

Këtu njerëzit fillojnë e bëhen ujk për njëri tjetrin.

— Ja, pra, kjo është e tëra. Thellimi i këtij hendeku i ndau këto dy botë. Kështu, ndërsa njëra palë me gjashtëqind ose tetëqind rubla, në xhep mendohet se si do ta nxjerrë muajin, pala tjetër, me mijrat e rublave nëpër duar, vret mëndjen për një botë lluksi e qejfesh të çfrenuara. Pra, për vilat jashtë Moskës e Odesës, Leningradit, Vlnës, Bakusë, Kievit..., për veturat e fjalës së fundit të teknikës perëndimore, për verimet dhe shetitjet turistike nëpër botë, sidhe për orgjitë, dancinget e kabaretë gjatë netëve. E tani më thuaj, ç'gjë të përbashkët ka midis këtyre dy botëve, Gjetë?

— Kjo kategori, Gjergj, s'janë as më shumë, as më pak, po një skotë fundërinash e tradhëtarësh të socializmit.

— Sigurisht, s'ka renegatë të ndershëm — tha tjetri, duke rudhur ballin i menduar. — Por puna është, se kjo kategori nuk përbëhet nga disa elementë të kufizuar, por nga një kastë e tërë njerëzish, që duke qënë në fuqi, mbështetin njëri tjetrin për t'u pasuruar e për t'i shtuar privilegjet që kanë filluar të hedhin në dorë. Pra, këtu kemi të bëjmë me lindjen e një shtrese të re



borgjeze brenda shtetit socialist, që ka hyrë në rrugën e shturjes së plotë.

— Dhe ashtu, duke ngrënë vjen oreksi — tha Marta, e qetë.

Gjetë Sokoli e shikoi me mëdyshje.

— Cili oreks? — tha pastaj me kureshtje.

— Oreksi për t'i ndryshuar edhe elementët e tjerë bazë, që rregullojnë marrëdhëniet midis njerëzve në një shtet socialist.

— Pikërisht ashtu — tha Gjergj Martini. — Mbushja e xhepave i bën të kërkojnë që edhe politikën e pagave dhe shpërndarjen e të mirave materiale të mos e bëjë më shteti, po disa grupe njerëzish a persona të veçantë, duke krijuar kështu kushte për privilegje e përfitime sa më të mëdha në rrugë të errëta e të tërthorta. E ky interes i çon pastaj edhe te kërkesa tjetër: copëtimi i pronës socialiste.

— Kujto me këtë rast deçentralizimin e planifikimit të ekonomisë nga shteti në Bashkimin Sovjetik të sotëm — tha Marta.

— E the mirë, — tha i shoqi.

— Dhe ky stan — tha gruaja — dihet, se çfarë bulmeti do të japë...

— Pastaj, i dashur Gjetë, vijnë ato që erdhën atje, e që ti i di mirë — tha Gjergj Martini, i menduar.

Gjetë Sokoli uli kryet, i vrarë në shpirt, e i rudhur në fytyrë.

— E kuptoj, — tha pas një heshtjeje të shkurtër. — E kuptoj. — dhe psherëtiu thellë.

— Pra, kështu. Kjo është rruga e tyre. Pastaj evolucioni fillon ta degjenerojë çdo qelizë të socializmit në atë vend. Si rrjedhim, i hapet rruga rivendosjes së kapitalizmit. U hapet rruga për të ardhur edhe një herë në fuqi dom Pjetrove e Gjon Marka Gjonëve, që vranë tim at e mijëra të tjerë, si ai. E nëse dje shtinë mbi prindërit tanë, këtë herë do të shtijen mbi mua dhe mbi ty. Ja, ky është epilogu i gjithë kësaj rruge. Tani më thuaj: Bën a s'bën mirë Partia që i pret kokën kësaj të keqeje,

pavarësisht se Gjergj Martinin apo Gjetë Sokolit do t'u vinte hidhur nëse do t'u cenohej sado pak paga e tyre? Gjetë Sokoli, qe bërë dhé në fytyrë.

— Dhe unë s'e kuptoj, Gjergj, si e ngrita këtë çështje — tha i pikëlluar. — Tani më vjen zor nga vetja! po kurrë s'më kish shkuar mendja gjer në këtë shkallë. Sidoqoftë u falemnderit të dyve për këtë ndihmë shokësh. Megjithatë nëse për të tjerat u binda plotësisht, çështja e heqjes së dënimeve dhe e masave disiplinore në ushtri më trondit thellë. T'jua them hapët nuk e kuptoj dot, se si pa ato një oficer mund t'i kryejë detyrat e tij të ngarkuara nga komanda.

Dhe këto bindje e mendime ai s'nguroi t'i shprehte hapët edhe gjatë diskutimit të Letrës në mbledhjet e organizatës së partisë, repartit apo komandës..

...Por Martës pas largimit të tii i erdhi keq që në atë bisedë nuk gjeti rast t'i fliste edhe për atë vajzën e uzinës së telave, Katrinën.



## N J Ë D I T Ë E P A H A R R U A R

Në jetë ka ngjarje, orë dhe ditë, që vijnë vetëm një herë, por që mbeten të paharruara, përgjithmonë. Të tillë qenë për oficerët Gjergj Martini e Gjetë Sokoli, çastet e një dite prilli të vitit 1966, kur shoku Enver zbriti për të vizituar repartin e tyre. Çaste emocionesh të forta! A do të delnin mirë gjatë asaj vizite? A do të ishin në gjendje të provonin para tij atë që mund të bënin zakonisht dhe atë që mundej dhe që bënte në të vërtetë çdo repart i ushtrisë sonë? Po sikur ushtarët, të impresionuar nga prezenca e tij, të hutohen?

Dhe ky varg pikëpyetjesh, të mbetura pa përgjigje, i mundon.

Ndërkohë, turma fillon të brohorasë. Shoku Enver hyn midis ushtarëve. Akulli shkrin, Buzagazi i tij u jep krahe që të gjithëve. Ai i përshëndet, i përqafton, u flet, sikur të jetë parë qindra herë me secilin prej tyre. Ish komandanti i njësisë, gjeneral Bari Progonati, përkrah komandantit suprem, s'është parë kurrë kaq i çelur e i gëzuar sa sot. Ai tani nuk është më komandanti i kësaj njësie. Para disa javësh, që me daljen e Letrës së hapur, me vendim të Komitetit Qendror të Partisë, është transferuar në një post të rëndësishëm pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Ka ardhur vetëm e vetëm për të shoqëruar shokun Enver, sidhe për të marrë pjesë si i deleguar i Drejtorisë Politike në punimet e konferencës për zgjedhjen e Komitetit të partisë të repartit 8001. Po në këtë nënrepart, për mirë a për

keq, si në gjithë nënrepartet e kësaj njsie, ka dorë të ndjeshme edhe puna e tij shumëvjeçare, si komandant. Dhe ai ka besim. Ka besim të plotë se ata do të dalin me sukses. Sa herë ai vetë i pat vënë përpara provash të tilla të vështira? Dhe sa herë pastaj, pas suksesit të plotë, po ai vetë u kishte shtrënguar duart e i kish përçafuar si bashkëlloftëtarë, si shokë të një pune e të një llogoreje të përbashkët! Dhe ata e donin dhe linin kokën për të. I njih- te me emër, jo vetëm kuadrot, por edhe ushtarët, pothuaj, që të tërë.

— Gjergj! — i thërret Gjergj Martinit — Gjergj!

— Gjergj Martini? — pyet shoku Enver, duke hedhur vështrimin andej.

— Po.

Tjetri i emocionuar afrohet.

Shoku Enver i shtrëngon dorën me të dy duart dhe e përçafon.

— Gëzohem shumë, Gjergj! Gëzohem shumë. Kam dëgjuar mjaft për sukseset e tua. Edhe diskutimi yt në konferencën e partisë më pëlqeu fort. Konkret, pa fraza të fryra. Dhe bëre mirë që fole pa letër. Mua ashtu më pëlqen të diskutojnë shokët tanë. Hapët dhe duke e kapur zinxhirin nga hallka kryesore, nga koka. Vetëm ashtu unazat që e përbëjnë atë, do të mund t'i tërheqësh e t'i gosh atje ku do ti. Apo jo?

— Siurdhëron — i thotë Gjergj Martini, që akoma s'e ka mbledhur veten.

— Konferenca në tërësi më la mbresa të mira — vazhdon shoku Enver — Niveli i saj ideologjik, politik, e profesional që i lartë. Diskutimet parimore të shokëve e pohuan qartë këtë të vërtetë. Ato s'qenë diskutime sa për të kaluar radhën, po rrahje mendimesh e ngritje çështjesh të rëndësishme, që dëshmuuan si për sukseset e arritura, ashtu edhe për problemet që presin zgjidhje e që preokupojnë jo vetëm repartin 8001, por që aty-këtu, ku më pak e ku më shumë, nxjerrin krye në gjithë ushtrinë tonë. Përshlypjet që përmenda, sidhe këto që do të kem nga ky nënrepart, si i deleguar, unë do t'ja bëj të njohura, një për



një, edhe Komitetit Qëndror të Partisë. Tani, edhe diçka tjetër: ti ke qënë një nga shokët e afërt të Nik Pjetër Dedës, apo gabohem? S'di pse më ka mbetur në kujtesë, po më duket sikur edhe një herë tjetër kemi biseduar bashkë rreth tij.

— Po. Disa vjet të shkuara, kur iu erdhët për të vizituar shkollën tonë. Atëhere, unë dhe Gjetë Sokoli ishim skënderbegas.

Shoku Enver rrudh ballin.

— Ashtu ka qënë. Më kujtohet. Po ku ndodhet ai, Gjeta tani?

— Këtu. Këtu, Ja, ai atje tej, midis ushtarëve, — tregon me dorë Gjergj Martini.

Shoku Enver hedh vështrimin në atë krah.

— Sa mirë! Domethënë përsëri qënkeni bashkë. — Thirre, thirre! — dhe me t'u afruar Gjeta, buzagas i shtrëngon dorën.

— Po pse rri larg, more Gjetë? Kaq shpejt i harroke ti miqtë e vjetër?

Gjetë Sokoli bëhet flakë në fytyrë, ndërsa Gjergji pa të keq vë buzën në gaz, sikur do të thotë: «Ashtu e ka ai, shoku Enver».

Po kjo gjendje nuk zgjat. Përzemërsia e udhëheqësit e shkrin akullin që rrethon oficer Gjetën.

— Si shkon? — i thotë ai duke i futur krahun.

— Disi, shoku Enver.

— Pse disi? Apo ndofta kjo kthesë e madhe...

— Po. Unë kthesat gjithnjë i marr me zor. Shokët e dinë këtë...

— Po ç'gjë të duket e vështirë në këtë kthesë?

— T'ju them, siç e mendoj, heqja e çdo dënimi, sikur ma ka prishur pak terezinë në repart. Edhe gradat në vetvete që do të hiqen së afërmi. Jo se kam ndonjë mall për to, për hija e tyre sikur më iente tjetër krah në zgjidhjen e problemeve që shtronte komanda. Kurse tani? Tani mbetet çështja vetëm te ndërgjegjja e vetëdija. Po këtyre, po s'u vure dhe një çikëz fre, të lënë në baltë.

— E kuptoj, — përgjigjet shoku Enver — i menduar.

— Megjithatë, edhe për këtë do të bisedojmë, Gjetë. Do të bisedojmë — dhe tok me ish-komandantin e njësisë, me komisarën e komandantit të ri, shefin e shtabit dhe shefin e aparatit politik, si dhe Gjetë Sokolin e Gjergj Martinin, bën përpara, duke përshëndetur me dorë ushtarë e kuadro që qëndrojnë në të dy anët, në pritje të tij.

— Strehim i nëndheshëm i nënrepartit! — thotë komandanti i ri i njësisë, duke treguar shkallët.

Udhëheqësi i partisë zbret i pari.

— Nga salla e fjetjes, efektivit i mbrojtur, duke kaluar nën tokë mund të dalë në pozicionin tek topi, — thotë Gjergj Martini.

Shoku Enver tund kryet i kënaqur.

— Po ky sistem mbrojtjeje është i plotë në gjithë këtë territor, — shton komandanti i njësisë.

— Punë e bukur — thekson shoku Enver. Dhe duke i kaluar përbri ushtarit që qëndron tek topi:

— Si je? — i thotë.

— Ju urojmë shëndet, shoku komandant, — përgjigjet tjetri pa luajtur nga qëndrimi «gatitu» që ka marrë. Shoku Enver i buzëqesh duke vazhduar ecjen.

Ndërkohë, dy fusha minash të drejtuara i dalin përpara.

Pak më tej edhe dy tipe gurëdhësash me eksploziv. Fitalat e tyre i kanë bërë gati për t'u vënë flakën.

— Zjarr! — urdhëron komandanti i nënrepartit.

Shoku Enver vë buzën në gaz, duke theksuar se dhe armë të tilla në luftëra të karakterit popullor e në terrene malore si yni, mund të përdoren me efekt.

Ndërsa ai flet zhurma e gurëve që rrokullisen me poterë, akoma vazhdon grykës me buçimë, duke pushtuar një sipërfaqe të madhe të territorit të nënrepartit. Të duket sikur ndonjë ortek që ka shpërthyer që lart. Tani edhe Gjergj Martini e Gjetë Sokoli ndihen më të qetë. Sytë e tyre shndrijnë nga një gëzim i thellë. Megjithatë, fytyra e bardhë e Gjergj Martinit skuq. Vala e emocioneve ende s'i ka kaluar plotësisht. Ushtarët do



të ekspozojnë para shokut Enver aftësitë e tyre në pre-  
gatitjen luftarake. Në ato aftësi do të duket edhe pu-  
na e kuadrit oficer, e, mbi të gjitha, ajo e organizatës së  
partisë, ku ai, Gjergji, para disa javësh. është emëruar ko-  
misar i atij nënrepartit.

Ndërkohë një grup ushtarësh që kanë përqafuar lë-  
vizjen e përdorimit të teknikës e të armatimit në kushtet  
e errësirës së plotë, qëndrojnë në gadishmëri.

Shoku Enver u afrohet e i përshëndet. Por ata, me-  
gjithëse ditë, s'e shohin. Sytë e tyre janë të lidhur me nga  
një shami të bardhë.

— Filloni! — jepet urdhëri.

Dhe ata fillojnë zberthimin e pushkëve, automatikëve,  
mitrolozave. Gishtat e duart e tyre lëvizin si ato të pianis-  
tëve mbi tasierë. Shoku Enver, me vëmëndje të përqën-  
druar, i ndjek me kujdes. Veprimi kryhet në kohë rekord.

«Po në mbërthim, si do të dalin?» mendojnë me ve-  
te Gjergj Martini e Gjetë Sokoli me shqetësim.

Dhe urdhri jepet. Fillon mbërthimi i armëve të zber-  
thyera. Dikush ngatërrohet. Gjergj Martini zbehet në fy-  
tyrë. Po ushtari shpejt e kalon atë vështirësi të çastit. Du-  
ket sikur të gjithë ata njerëz me sy të lidhur janë në garë  
me njëri tjetrin. Duart, si vegla makinash automatike, ve-  
projnë me shpejtësi rekord. Ndërkohë, dikush, me orë në  
dorë ndjek akrepin e kronometrit. Veprimi merr fund.  
Ushtarët heqin shamitë.

Gazmor, shoku Enver u afrohet e i përqafton.

— Shkëlqyeshëm! Shkëlqyeshëm, shokë! Përgjithësi-  
mi i kësaj lëvizjeje ka rëndësi të posaçme për ne, pasi në  
kushtet e vendit tonë, ushtarit mund t'i takojë të luftojë  
sa ditën, aq edhe natën.

Gjergj Martini, disi i lehtësuar, merr frymë thellë.  
Fjala e shokut Enver është çmimi më i lartë për të dhe  
për nënrepartin e tij. Po, megjithatë zemrën s'e ndjen të  
qetë. Edhe një barrikadë duhet kaluar. E, ndofta, më e vë-  
shtira.

Ish komandanti i njësisë, Bari Progonati e vë re.  
Fytyra e tij ka një pamje të shqetësuar. Tani zvarritë-

sat do të provojnë para Komandantit suprem afrimin e paktuar.

— Shoku Enver! — i thotë Bari Progonati. — Rreth jush ka ushtarë që po afrohen, duke u zvarritur. — A mund t'i dalloni se ku janë?

Shoku Enver, vë buzën në gaz:

— Si, ore, si? — dhe duke ju kthyer atyre që kanë ardhur me të nga Tirana, shton — E shikoni? Shokët e ushtrisë paskan vendosur të më marrin në provim!

— Ja edhe ndihma — shton gazmor ish komandanti i njësisë, duke i ofruar një palë dylbi shokut Enver.

Ai i merr dhe, duke i graduar sipas syrit, fillon të vrojttojë në një distancë dyqind metrash largësi.

— Jo. Besoj t'i keni më afër — thotë Bari Progonati. — Apo jo, Gjergj?

— Po, shoku komandant. Ndonjëqind metro, mendoj.

— Shoku Enver vazhdon të vrojttojë më në afërsi.

— Diktoni gjë? — pyet mbas një copë here ish komandanti i njësisë.

— Asgjë gjer tani, Bari — përgjegjet shoku Enver.

Të gjithë shikojnë andej. Vështrimi i secilit mbërthehet mbi fushën e blertë. Po fusha është e qetë. Asgjë s'pipëtin, asgjë s'dallohet në të.

— Më afër, më afër, shoku Enver! — shton gjeneral Bariu — Ju po vrojtoni në më se 50 metro largësi, kurse ata tani mund t'ju jenë afruar mjaft. Apo jo, Gjergj! Si thua?

— Po. Tani me siguri do të jenë afruar mjaft — përgjigjet oficeri. Ata kanë urdhër të zvarriten vazhdimisht, shoku komandant.

I menduar, shoku Enver, s'ndihet për një çast. Vështrimi i tij hetues akoma vozit mbi fushën e blertë. Po prapë asgjë nuk dallon të pipëtijë.

— E pamundur — thotë më në fund — kaq afër, do t'i diktoja, gjithësesi. Atëhere, le të çohen, në se janë!

— Jep udhëzimin, Gjergj! Shoku Enver urdhëron të çohen — ndërhyt ishkomandanti i njësisë.



— Çohuni! — dëgjoet thirrja e prerë e Gjergj Martinit.

Një njeri i maskuar me një veshje në ngjyrën e dheut të blertë, sikur të mbinte nga thellësia, si ndonjë copë e shkukur nga ajo tokë, çohet para këmbëve të Komandantit Suprem. Vetëm zgavrat ku duken dy bebëza syri, e shquan që është njeri.

Komandanti Suprem, i emocionuar e përqafohet.

— Si quhesh?

— Gazmend Sheti, shoku komandant.

— Shoku Enver mendohet: — Kam dëgjuar për ty...

Ndërkohë edhe dy të tjerë ngrihen mbas tij në afërsi.

— Ju lumtë! — i përgëzon shoku Enver, duke u shtrënguar duart. Kjo është një punë shumë e mirë. Një afrim i tillë siguron befasi mbi armiqtë, dhe befasia është tmerr për ta. Ajo lehtëson fitoren dhe pakëson gjakun për ne. Veçse puna është që kështu si ju të aftësohen sa më shumë e, po qe e mundur që të gjithë. — Dhe prapë i kthehet ushtarit të parë: — Të thashë, kam dëgjuar për ty. Je ndër qitësit më të shquar. Po si e arrite këtë objektiv të lartë?

— Me durim, shoku Enver, duke e shikuar problemin ideologjikisht e politikisht.

— Ashtu duhet shikuar. Një objektiv i pagoditur duhet marrë si një armik i paasgjësuar. Dhe po s'e vrave, do të thotë t'i lësh kohë të të vrasë ai. Kështu pozicioni yt, bëhet pozicioni i tij dhe në trupin e Atdheut hapet një plagë, prej së cilës mund të rrjedhë shumë gjak. Apo jo?

— Po. Ashtu është.

— Veçse për t'u bërë qitës i mirë, rolin kryesor nuk e luajnë sasia dhe seria e qitjeve, por serioziteti e shkollëshënjimi në to. S'mund të kesh rezultate pa e marrë punën me shumë përgjegjësi. S'arrihen majat pa djersë. Pra, edhe në qitje, po nuk e shfrytëzove çdo fishek me seriozitet e përgjegjësi, mos u çudit, kur plumbat e tu të shkojnë për hava. E qartë?

— Po, — thotë Gjergj Martini. — Shëmbulli i Gazmend Shetit na ka shërbyer mjaft edhe në këtë drejtim.

Ai, megjithëse e shfrytëzon në maksimum kohën e stërvitjes prapë se prapë e ka bërë zakon t'i japë vetes për çdo ditë një mbingarkesë, prej një ose dy orësh mbi programin.

— Ç'është e vërteta, kurrë s'e vëren orarin e pushimit — shton njëri nga ushtarët zvarritës. Largohet vetëm atëherë kur e ndjen se sot është më i përgatitur se sa dje.

— Jeni bashkë? — pyet shoku Enver.

— Po. E kemi komandant të skuadrës. Qëndrimi i tij na detyron të ecim me çdo kusht përpara.

— Ka ndonjë gradë? Për shëmbull: tetar, reshter...

— Jo. Po ne gjithnjë e kemi respektuar jo më pak se ata që akoma janë të mbuluar me grada e nishane.

Shoku Enver buzëqesh.

— Po pse ky respekt për të?

— Sepse ai është shok dhe komandant i mirë. Në stërvitje komandant që kërkon e na mëson me durim, kurse pas stërvitjes, shok që mundohet të na njohë çdo nevojë që kemi. Për t'i zgjidhur ato, shkon drejt tek eproret, ndërsa për të metat nuk na çon kurrë tek ata.

— Mos ndofta pajtohet me ato të meta?

— Jo! Punon vetë me durim derisa na bind e na bën t'i flakim tej ato të meta.

— Po —shton edhe Gjergj Martini. — Ai, edhe në këtë drejtim, ashtu sikurse edhe ndër zvarritësit, është një nga më të mirët midis tanëve.

— Një nga më të shkëlqyerit — thotë shoku Enver — dhe këtë e provoi edhe sot para jush e para meje.

Ushtar Gazmendi skuqet.

— Shokë! — vijon pastaj udhëheqësi i partisë — Ja ç'do të thotë ndërgjegje ushtari, ndërgjegje kuadri. Se në të vërtetë, Gazmend Sheti me punën që bën është edhe ushtar edhe kuadër. Shëmbulli i tij provon më së miri drejtësinë e vendimeve të partisë në Letrën e Hapur. Jo gradat që me aprovimin e gjithë ushtarakëve tanë do të hiqen, po dashuria dhe respekti i vërtetë për oficerin, për kuadrin e bëjnë ushtarin të jetë i disiplinuar e të kryejë sa



më mirë detyat që i ngarkon eprori. Jo disiplina e imponuar, jo masat ndëshkimore, po ndërgjegjja proletare është ajo që i bën ushtarët tanë t'u përgjigjen me përpikmëri urdhërave të komandantëve të tyre, të komisarëve të tyre, të partisë së tyre. Gazmend Sheti nuk ka patur ndonjëherë gradën. Po as komandantët e komisarët tanë të luftës nuk kishin gradë. Megjithatë urdhëri i tyre për partizanët ishte ligj i prerë. Ajo lidhje buronte nga qëllimi i shenjtë, që i bashkonte në revolucion, sidhe nga respekti e dashuria e vërtetë për shoku-shokun, si luftëtarë. Nga ajo dashuri, që për njëri-tjetrin shpesh derdhnin edhe gjakun, fjalën edhe jetën. Edhe sot, ç'kuptim të lartë marrin këto reforma të partisë, kur sheh se në ushtrinë tonë aktualisht nuk gjen asnjë ushtar në arrest. A nuk është për t'u mburrur, kur shikon oficerin, të tërheqi tok me ushtarët e vet topin, të pastrojë mitrolozin, apo të punojë tok me ushtarin me bel ose me kazëm? Këto, shokë, janë rezultatet e mëdha të vijës së drejtë të partisë.

Gjeneral Bari Progonati si dhe të tjerët, me vëmendje të përqëndruar, e shikojnë në sy shokun Enver.

— Tani, edhe dy fjalë me shokun Gjetë. Afrohu, Gjetë, afrohu!

Gjetë Sokoli shpejton e i afrohet duke marrë drejt-qëndrim.

— Jo — thotë shoku Enver — Jo, Gjetë! — dhe i hedh krahun me përzemërsi. — Ne do të bisedojmë si shokë, si në shtëpi, si në familje. Të lirë e pa drojtje, se mund të gabojmë. Po, para largimit tim, desha të sqaroja një mendim, që ma shfaqe pak më parë. E them që në fillim, ti ke një biografi të shkëlqyer, Gjetë. Dhe unë të përgëzoj për këtë. Ti je njeri i klasës dhe bir besnik i partisë. Dhe unë prapë të përgëzoj, edhe për këtë. Por këto merita, s'duhën ngatërruar me ndonjë mbeturinë pikpamjesh që mundon kokat tona. Ja, për shëmbull, ti më the pak më parë se heqja e dënimeve ta ka shturur punën në repart... Se hija e gradave të ndihmonte për t'i zgjidhur detyrat e ngarkuara nga komanda. Kurse tani, sipas teje, puna ka mbetur tek ndërgjegjja e ushtarit, që pa fre, të lë në

baltë... Një mendim i tillë, padyshim, s'është i drejtë aspak. Mua më kanë raportuar, siç thashë pak më parë, se asnjë ushtar nuk ka tash në arrest, se dënimet e ndryshme janë ulur shumë... Dhe kjo tregon se frymëzimi i madh revolucionar i partisë ka përshkuar gjithë ushtrinë tonë. A ka gjë më të bukur, Gjetë? Pra jo kur i dënojmë ushtarët, jo kur sillemi në mënyrë arrogante me ta ka disiplinë dhe dashuri për njëri-tjetrin..., por vetëm kur sillemi drejt me ushtarin, në rrugë partie, atëhere ka disiplinë të vërtetë në ushtri.

Spjegoja politikisht efektivit ç'do të thotë disiplinë e një ushtari të revolucionit, dhe do të shikosh çfarë discipline të çeliktë dhe të vetëdijshme do të ketë në ushtri.

I qëndro afër ushtarit, duaje atë me gjithë shpirt, kujdesu për të, mos ji kryelartë dhe do të shikosh, sa do të të dojë ai, sa me kujdes do ta dëgjojë fjalën tënde, sa me etje do ta përvetësojë mësimin tënd.

Edukoje politikisht ushtarin dhe kur i mëson teknikën e thjeshtë të armës... E mëso atë politikisht, se çështja e ushtrisë është një çështje serioze, nga më seriozet dhe se në këtë familje, të madhe, nuk kanë vend shthurja e familjariteti i sëmurë. Mos ki frik se të bie nderi të flesh, të hash, të dëfresh, të bësh shaka me vëllanë tënd, ushtarin. Përkundrazi, ai do të të nderojë, do të të respektojë, do të të dojë, me gjithë zemër dhe jo për formë a për spaletat e ngrira mbi supe.

Gjetë Sokoli, i zbetë, me ballin rudhur dëgjon në heshtje.

— Pra — vijon shoku Enver — pa ngritjen ideologjike e politike të ushtarëve e të oficerëve, as përvetësimi i armës, i teknikës, i shkencës ushtarake, as zbatimi i urdhërave dhe i vendimeve nuk mund të bëhen si duhet. Arma, teknika, shkenca ushtarake kanë filosofinë, politikën dhe ideologjinë e vet. Ndryshe është kio në ushtritë borgjeze, ndryshe është në ushtrinë tonë. pavarësisht se armët dhe armatimet mund të jenë të njëllajt. Prandaj, në ushtrinë tonë nuk mund të ketë komandant dhe specialist ushtarak, pa qënë njëkohësisht edhe politik, ashtu sikurse nuk



mund të ketë komisar politik, ose punëtor partie, pa qënë njëkohësisht edhe specialist në çështjet ushtarake. Apo jo, Gjetë?

Gjetë Sokolit i zihet fjala në grykë.

— Sidoqoftë, unë kam bindje, se ti do të reflektosh më thellë rreth këtyre problemeve të mëdha që shtron Letra e Hapur dhe atëhere do t'i kuptosh edhe më mirë të gjitha këto që biseduam sëbashku. Të thashë: Unë kam besim të plotë për këtë.

Gjetë Sokoli, i zbetë, uli kryet.

— Do të bëj çmos — thotë më në fund. — Do t'i kem parasysh të gjitha këto që më thatë ju. Veçse, t'ju them të drejtën, shoku Enver, s'di pse më bëhet sikur një lëmsh më qëndron akoma në kokë.

Ai i thotë këto me një frymë dhe përnjëherësh një ngjyrë e kuqërreme ja pushton fytyrën.

Po shoku Enver, pa e lëshuar Gjetë Sokolin, vazhdoi me të përkrahu, duke kaluar përmes ushtarëve. Përkrah tyre, edhe ish komandanti i njësisë, gjeneral Bari Progonati, me shoqëruesit e tjerë.

Dita kishte filluar të thyhej. Dielli po prirej drejt përdimit.

— Si thoni? — thotë shoku Enver — Të nisemi? Detyra të tjera partie na presin — dhe filloi t'u japë dorën e t'i përqafojë që të gjithë ata që e rrethonin, duke nisur që nga Gjergj Martini e Gjetë Sokoli.

I mallëngjyer, duke çarë midis të tjerëve, Gazmend Sheti ju derdh ndër krahë.

— Unë s'do ta harroj kurrë këtë ditë, shoku Enver!

— As unë, Gazmend, s'do të të harroj kurrë ty!

Dhe shtrëngimi i duarve vazhdoi gjersa më në fund, një varg i gjatë makinash nisën rrugën drejt qytetit të ndjekura nga një thirrje e vetme dhe e fuqishme, që dukej sikur dilte nga thellësia e maleve:

— Enver Hoxha! Enver Hoxha!

## P E R S È R I M A J A V E

Jehona e Letrës së Hapur ndihej kudo. Ajo kish pushuar tërë jetën e vendit, që nga bangat e shkollave e deri në galeritë më të thella të minierave, që nga fushat e mbuluara me grurë e deri atje ku forcat e mbrojtjes stërviteshin me kujdes për ta qëlluar armikun në zemër që me predhën e parë. Dhe ashtu në atë zjarr, ato ditë të pranverës së 66-ës, ditë të një revolucioni të mprehtë ideologjik, revolucion që kishte vënë në shenjë konceptet e mbeturinat e një bote të vjetër, të huaj për socializmin që po ndërtonim, Gjetë Sokolit ju dukën sikur kaluan sa hap e mbyll sytë, sikur u endën tepër, tepër shpejt. Por lufta për revolucionarizimin e mëtejshëm nuk kishte mbaruar. Ajo ishte në hapat e para të saj, duke ju ngjitur vazhdimisht të përpjetave, E ato të përpjeta, në krahët e këtij revolucioni ideologjik, po i ngjiste tani edhe oficer Gjergj Martini me nënrepartin e tij. Po këtë herë pa spaletat e kapitenit, ashtu si dhe Gjetë Sokoli, pa ato të togerit. Bile dhe detyrat e tyre s'ishin më ato të parat. Gjergji ishte emëruar komisar i atij nënreparti, kurse Gjeta nga shef shtabi ishte graduar komandant. Kjo ishte gjendja e re. Dhe ja ata, ku po i ngjiteshin edhe një herë rrafshnaltës, për t'i mbjellë tokat e hapura në ditët e vështira të dhjetort e janarit të kaluar.

— Gjetë! — i tha Gjergji — Të kujtohet? Tek ndonjëri nga tanët në atë periudhë pati edhe mendime të lëkundshme. Thuhej: «Ç'na duhet Shishtaveci? E pse në këtë



kohë kur bora ngrihet me metra? A do të mundim t'ja dalim në krye, apo mos ndofta...?» Po tani gjithshka është e kthjellët dhe e qartë për secilin nga ne. Ajo thirrje, megjithëse na u bë disa muaj më parë, paska qenë pjesë përbërëse e asaj Letre të madhe, për t'ju ngjitur në të gjitha drejtimet majave.

— Po — tha tjetri — Po pse thua tek ndonjeri nga tanët pati edhe mendime të lëkundshme? Ti e di mirë... Unë vetë jam një nga ata. Dhe ta them hapët, në atë kohë m'u duk krejt e pamundshme ajo punë...

Të ulur pranë e pranë në «gazin» që i printe auto-kolonës, ku ndodhej edhe komisari i njësisë, ata vazhduan bisedën, gjersa arritën në Turraj, atje ku sipas fjalës së dhënë, po i priste faza e dytë dhe vendimtare e betejës, që kish nisur disa muaj më parë.

\* \* \*

4 Maj. Qe e bukur ajo ditë! Ushtarët e rinj, sado të lodhur, pasi zunë vendet nëpër fjetoret, dolën për t'u njohur me natyrën përrallore të rrafshnaltës. Vende-vende, bora kish shkrirë, po toka ende s'e kish hedhur pelerinën e gjelbër të stinës.

— Këtu bleron vonë — tha dikush.

Një tjetër, që ishte nga vise të buta të vendit, duke e ndjerë thëllimin e asaj mbrëmjeje, ngriti jakën e kapotës.

— Si thua, sa metro borë mund të ketë atje? — dhe drejtoi dorën andej.

— Ku ta dish! Ata që qenë në dhjetor e në janar tregojnë se vende-vende këtu bora i kalonte të katër metrot.

— Po në grykat? — tha një tjetër, dhe hodhi vështrimin mbi rrafshnaltën.

— Në grykat? Me siguri shumë më tepër...

Ushtari që pyeti s'e dëgjoji atë përgjigje. Vështrimi i tij ishte nderë mbi linjën telefonike, që prirej tatëpjetë rrafshnaltës. Po vargu i shtyllave, mbasi zbriste gjer në një farë vendi në drejtim të Novosejt, nuk dukej më.

— Kushedi! — tha me vete — kushedi ku ka rënë! Me siguri në ndonjë grykë të ngarkuar me dëborë...

Dhe pa folur fillrojtësi i ri, që e kishte mësuar atë profesion vetëm e vetëm për të zënë vëndin e të vëllait, u hoq mënjanë.

Të nesërmen pas ndarjes së sektorëve, puna filloi menjëherë.

— Shokë! — tha komisari i njësisë. — Koha s'na pret. Kemi ardhur me vonesë. Para mbjelljeve të cilat duhet të fillojnë pa tjetër në fund të këtij muaji, tokës i duhen bërë të paktën dy punime pregatitore.

Pastaj të ndarë në sektorë, grupe traktoristësh e pendarësh me qe filluan plugimin në stil të gjërë. Rrafshnalta filloi të buçiste përsëri, si disa muaj më parë.

— Me kujdes, shokë, me kujdes! — u thosh komisari duke kontrolluar cilësinë e punimeve.

Ai ndalej e bisedonte me secilin, duke e këshilluar për gjithshka me të qetë. Fjala e tij ish e urtë dhe e përzemërt edhe kur u hiqte vërejtjen për ndonjë veprim të gabuar, apo të ngutur.

— Ky është vërtet njeri! — tha një nga ushtarët, duke e ndjekur me sy miratues, tek endej nëpër fushë.

Dhe ashtu ai vazhdonte gjatë gjithë ditës. Në mbrëmje, pas ndarjes së detyrave të nesërme, shkrihej midis kolektivit si ushtar i thjeshtë. Gjeta çelej tek vinte re ushtarët që e shikonin në sy e i gëzoheshin atij njeriu aq të mirë e aq babaxhan.

— Fjala e tij ngjit! — i tha atë mbrëmje Gjergjit. — Mua më vjen keq që s'jam i zoti të komunikoj si ai me ushtarët dhe as si ti. Ja edhe sot, u nxeha dhe i shfreva keq Gazmendit, megjithëse faji s'ish i tij, po i dikuj tjetër nga skuadrë.

— Po pas asaj shfryrje ti i hodhe krahun e i kërkove ndjesë — tha Gjergj Martini. — Dhe bërë mirë, Gjetë. Bërë atë që nuk e ke bërë herë tjetër. Unë këtë e quaj një prëmtim serioz, për një kthesë sa më të ndjeshme në marrëdhëniet e tua me ushtarët. Ti ke filluar të reflektosh, dhe kjo, të ta them hapët, më gëzon shumë, shumë.

Gjetë Sokoli psherëtiu.

— S'di — tha — Po kam natyrë shumë të prapësht, Gjergj. Më duhet të luftoj shumë me të.



— Jo të prapësht, po të rrëmbyer — tha tjetri. Shpesh, nga kjo lloj natyre, fjalën e fundit e thua të parën. Ja, siç të ndodhi edhe sot, për shembull. Po kthesa që bëre, duke i kërkuar ndjesë, e përloti ushtarin. Ai ta harroi atë shfryrje. Nesër, kur ta urdhërosh për dishka tjetër, do të shikosh se sa i afërt e i gatshëm do të jetë ai për ta shpurë në vend menjëherë çdo porosi tënden. Pra, ti ke të meta temperamenti, Gjetë, që shpesh, edhe për gjëra të vogla, të bëjnë ta humbasësh ekuilibrin. Dhe në këtë dizekuilibër, ti kërkoje t'i zgjidhje çështjet me arresta e masa ndëshkimore ndaj ushtarëve. Kjo, sigurisht, ishte keq. Ti harroje se humbisje zemrat, me atë qëndrim të egër ndaj tyre. Bile, edhe i vetmi fërkim i ynë, për një çështje të tillë ka qënë. S'di në të kujtohet...

— Si s'më kujtohet! Dhe të jap të drejtë. Unë kam filluar të luftoj me veten, por ende jam larg asaj që duhet e kërkohet...

Dhe, duke rrahur ato mendime, i zuri gjumi, ashtu siç i zinte dikur në shkollën «Skënderbej», kur, të futur në shtrate pranë e pranë njëri tjetrit, me zë të lehtë, duke ju ruajtur syrit të oficerit të shërbimit, këmbenin ndonjë fjalë, gjersa lodhja e dremitja u mbyllte sytë pak nga pak.

\* \* \*

Mas ndonjë jave, si u vunë në vijë punimet, komisari i njësisë u largua nga rrafshnalta, po sulmi për kryerjen e dy plugimeve të tokës, vazhdoi në të gjithë frontet gjër më 25 të atij muaji.

— Toka e pluguar — tha agronomi i repartit — para diskimit, duhet të qëndrojë dy ditë për të marrë faqe ugari. Kjo lloj terjeje e lehtëson shumë punën e diskut në thërrmimin e plisave sidhe në nivelimin sa më mirë të tokës.

Gjergj Martini, sipas porosive që i kishte lënë komisarri i njësisë, i qëndronte në krye fushatës, për t'u zbatuar me përpikmëri çdo udhëzim i agronomit.

— Ai është komisarri i kësaj pune! — u thoshte ushtarëve e kuadrove.

Pastaj, në ditët e para të qershorit, beteja kaloi në fazën e plotë të mbjelljeve. U hapën brazda me qe, gro-pa me shat. U shti pleh organik e kimik në to, u bë për-zierja e tyre me dhe e, mandej, në secilën nga këto gropa u hodh nga pesëdhjetë gram patateje, ose «bubers», siç i quante agronomi i repartit.

Të gëzuar, Gjergj Martini e Gjetë Sokoli, duke ka-luar për kontroll e ndihmë nga njëra parcelë te tjetra, merrnin pjesë edhe vetë në punimet e atyre ditëve të zjarrrta.

Tani edhe rrafshnalta kishte filluar të ndronte fyty-rë. Me përjashtim të gropave në pllaja dhe malit të Gjalli-cës, që ngrihej madhështor mbas tyre, faqet e tjera, të çliruara nga ai masiv i bardhë, kishin filluar të vishnin petkun e stinës. Flora e pasur e rrafshnaltës për ditë e më shumë shfaqej para syve të ushtarëve, me një bukuri të rrallë.

— Sa e përafërt me atë të Vermoshin tonë! — i tha Gjeta Gjergj Martinin.

— E përafërt. Po prapë ka diçka të veçantë midis të dy majave. Ja, për shembull, disa lule që s'mi ka zënë syri atje, i kam parë këtu! E, veç kësaj, edhe një bukuri tjetër, Gjetë, a e ke vënë re?

— Bukuri tjetër? — tha me mëdyshje Gjeta.

— Po. Mështekna. Ç'pyll i mahnitshëm! Më parë kurrë s'e kisha shkuar ndër mend se ky lloj druri mund të rritej edhe tek ne!

— Ke të drejtë. Vërtet pyll i mrekullueshëm. Të habit ajo cipë e bardhë si fill letre. Mbi të mund të shkruash, Gjergj! Mund të shkruash...

— Po. Veçse s'bën ta prekim. Ajo është një pasuri. Gjetë, dhe duhet ruajtur. Unë për këtë u kam folur edhe ushtarëve.

— E di — tha tjetri.

Pastaj, të dy shokët, pranë njëri tjetrit hynë midis një grumbulli ushtarësh.



## N J Ë T R U P U G J E T M B I B O R Ë

Java e dytë e qershorit.

— Shoku Gjergj! Një fshatar vendas ka ardhur e ju kërkon.

— Erdha, i thuaj — tha Gjergj Martini, që diçka po i fliste një ushtari. Pastaj, i qetë, përshkoi oborrin e komandës dhe duke ju afruar, i shtriu dorën të ardhurit.

— Shoku komisar, — tha malësori i zbetë dhe uli kryet.

Gjergj Martini e shikoi drejt.

— Fol! Ç'ka ngjarë, shok?

— Në grykën ndërmjet Turrajt e Novosejt, në dëborën që ende s'ka shkrirë plotësisht shquhet një trup ushtari.

— Trup ushtari?! — Gjergji u drodh. Një ngjyrë e zbehtë i pushtoi përnjëherësh ballin, fytyrën. — E pe mirë?

— Po. E pashë me këta sy. E pashë dhe e njoha.... Ish ai që hipte mbi shtyllat e telefonave...

Oficeri heshtëte me vështrimin mbërthyer në një vend. Rrudhat e ballit sa vinin e i shtoheshin.

— E preke me dorë? — pyeti pas pak.

— Jo. Po e pashë mirë. Ai qëndronte më brinjë me kokën mbështetur në borë. Dhe dukej sikur flinte, shoku komisar, sikur flinte. Ah, ç'djalë, ç'djalë!

I prekur, oficer Gjergji psherëtiu

— E kuptoj, shok. Të falem nderit. Po a do të mund të vije me ne, të na tregojë vendin?

— Pa tjetër, pa tjetër. As që kish nevojë të më pyetnit, bile.

Gjergj Martini i shtrëngoi dorën. Pastaj, me një skuadër, ai dhe Gjetë Sokoli zbritën te gryka e pllajës, ku fillrojtësi komunist, Çelo Labi, pas kryerjes së detyrës me përpikmëri e heroizëm, flinte i qetë gjumin e përjetshëm. Në xhepin e brendshëm akoma qëndronte blloknoti i tij, i futur në një qeskë nailoni. E atje, edhe ajo letra, që i drejtonte oficer Gjet Sokolit. Kurse në xhepin e sipërm të xhaketës, qëndronin të palosura të hollat e hequra mënjanë, për kuotën e partisë.

— Merri, Gjetë! — tha komisari. — Është kuota e ushtarit komunist Çelo Labi. Përsa i takon letrës, ajo të lexohet para repartit!

Të nesërmen, dy tufa lulesh, nga ato që gjenden vetëm majave më të larta, i mblodhën të dy korrierët e ja vunë mbi krye, kurse nga kolektivi, një kurorë, Edhe ajo, e përbërë prej lulesh të njoma. Pastaj, Gjergj Martini mbajti fjalën e lamtumirës.

— Çelo! — i tha, duke ju drejtuar për të fundit herë. — Re, ashtu si mund të bijen vetëm trimat. Tani ti hesht, po ajo heshtje ne të gjithëve na flet. E ne e ndjejmë atë zë. Është zëri yt, që na bën thirrje, për t'ju ngjitur majave gjithnjë. Dhe, ne, të japim fjalën, se, nuk do të ndalemi në asnjë rrethanë, sado e vështirë që të jetë ajo...

Dhe hijerëndë, Gjergj Martini u zmbrops. Pas tij e mori fjalën i vëllai i ushtarit të rënë.

— Jam Sazani, Çelo! Erdha, që vendi yt të mos mbejtoj bosh. Kjo ish edhe dëshira e nënës dhe e babait. Tani, si ti dikur, me ato aparate në duar, edhe unë rend pas linjave, edhe unë u ngjitem këtyre shtyllave telefonike. Dhe të siguroj se me këto aparate e këto vegla që t'u gjetën pranë, do t'u ngjitem gjithnjë, në emër të ushtar Çelo Labit, që sot, me kaq dhëmbje, po e përcjell i gjithë ky repart ushtarak.

Dhe heshti.



— Kam edhe unë dy fjalë për të thënë, shoku komisar — kërkoi leje si me të drojtur një djalosh tjetër nga radhët e skuadrës.

— Dil! — i bëri shënjë me kokë komisari.

— Çelo! — tha djaloshi duke ju marrë zëri. Jam ai që më shpëtove nga një vdekje e sigurtë... Ai, që më nxorre nga gjiratorja dhe nga valët e lumit. Erdha me Sazanin. Erdha se më takonte, Çelo! Unë jetën e kam nga ti dhe këtë kurrë s'do ta harroj.

Pastaj një breshëri zjarri nderoi kujtimin e ushtarit, që sado të rënë prej disa muajsh, akoma dukej sikur flinte i shkujdesur e i qetë pas kryerjes së asaj detyre të vështirë.

## K T H I M I

Pranvera e vonshme e alpeve kishte shpërthyer mbi rrafshnaltën me tërë vrullin e saj. Bimët e lulet, kullotat alpine e pyjet e mështeknës së bardhë, përditë e më shumë u shfaqeshin ushtarëve me një bukuri të mahnitshme.

— Fantastike, shokë! — ja bënte i entuziazmuar agronomi i repartit — Fantastike!

Dhe vërtet, ajo bukuri magjepsëse, kishte dishka të veçantë.

— Më shëmbëllen me Vermoshin — i tha Gjergji Gjetës, po prap, ka diçka që atje nuk e gjen. Edhe nga rrafshnaltat mbi bjeshkët e Tropojës, kjo e këtushmja ka diçka krejt të sajën. Kam parasysh Sulbicajn e rrafshnaltën e lumit të Gashit. Gjetë, që njeriu lë mendtë kur i shikon!

— E kuptoj — tha Gjetë Sokoli, i rënë në mendim. — Po e kam të vështirë t'i krahasoj. Që të dyja kanë edhe të veçantën, edhe të përbashkëtën. Diçka që i bashkon e diçka që i ndan. Ja, për shembull, kjo e këtushmja, më duket një bukuri më e butë se ajo e rrafshnaltës së Tropojës. Ndofta këtë hir ja japin njerëzit, nga që është e tëra e banuar. Kurse përsa u takon kullotave alpine, ato më duken si qilima fantastikë, të shtruar në natyrë, Aq të bukura sa druhem e më vjen keq të shkel mbi to. Bar i çuditshëm, Gjergji! Bar që shndrit e që të duket sikur ndron ngjyrë gjatë orëve të ndryshme të ditës, sipas po-



zicioneve të diellit. Të të them të drejtën, bar të tillë s'kam parë në asnjë vënd të republikës. Ndrin sikur është i derdhur në fosfor. Kurse në këtë pamje mahnitëse të të dy anëve, pylli i mështeknës së bardhë qëndron si një stoli e rallë mbi rafshnaltën e Shishtavecit, ndërsa liqejt e vegjël të Sulbicajt si një çfaqje tjetër mahnitëse, si pasqyra kristali të shtruara mbi rrafshnaltën e Tropojës.

— Më pëlqen shumë ky krahasim, Gjetë. Dhe siç e di edhe atje, ashtu sikurse dhe në Qerem e Cukal, ushtarët e njësisë sonë po veprojnë për hapjen e këtyre rrafshnaltave.

— E di — tha tjetri — Me të vërtetë punë e madhe,

— Ja, shikoi parcelat që mbollëm tri javë më parë! Filizi i patates ka shpërthyer më çdo anë...

Dhe ashtu përkrah ushtarëve, që nga 10 qershori e deri më 20 korrik të dy oficerët bashkë me agronomin e nënrepartit, morën pjesë në shërbimet kulturale që ju bënë bimës. Mbi tokë mbetej edhe një veprim, për t'u bërë akoma: vjelja. Po ajo, për vet kushtet e terrenit, klimës dhe të kohës që u mbollën tuberët e patates, do të bëhej vonë: nga fundi i shtatorit, ose fillimi i muajit tetor. Gjatë kësaj periudhe, qëndrimi i të gjitha forcave aty, u quajt i pafrutshëm nga komanda. Punimet xhenjere prisnin në krahët e tjerë të territorit, ku shtrihe-shin forcat e kësaj njësie. Kështu, me vendim të komandës së njësisë, duke lënë atje pak forca me agronomin në krye, nënreparti i komanduar nga komisar Gjergj Martini dhe komandant Gjetë Sokoli, mori urdhër të paraqitej menjëherë në qytetin ku kishte qëndrën komanda e repartit 8001.

— Shoku agronom — i tha komandant Gjeta, duke e hequr mënjë. — Më ka ardhur vështirë t'ju pyes, po gjer tani s'e kam patur të qartë arësyen e ngjitjes sonë këtu në muajt më të vështirë të dimërit, dhjetor e janar. A s'mund të bëhej ajo punë edhe në pranverë? Ja, për shembull, siç e bëmë për së mbari tani...

— Jo, shoku Gjetë. Bile ajo u nis me shumë vonesë. Djerrina duhej të ishte çarë mjaft muaj më parë. Sa më

shpejt të ish bërë ajo punë, aq më mirë do të qe, pse vetëm ashtu mikroflora e tokës do të kish mundësi të aktivizohej gjerësisht, për të krijuar në shtresën e punueshme, një strukturë sa më të përshtatshme për t'u mbjellë. Ja, për shembull, puna që po bën tani brigada e traktorëve për çarjen e tokave të pahapura, do të jetë shumë më e frytëshme për vitin që po vjen.

— Kjo çështje më qëndronte si pikëpyetje në kokë. Po një sedër e çuditshme më kish penguar gjer më sot, t'ju pyesnja.

— Ju s'jeni më ai Gjeta i mbyllur e hijerëndë, shoku Gjetë. Ushtarët tani flasin ndryshe për ju. Ata ju duan e ju nderojnë që të gjithë. Dhe unë, t'jua them me zemër, gëzohem fort për këtë.

Gjetë Sokoli psherëtiu.

— E di, shoku agronom. Edhe juve ju kam shfryrë.... Edhe Dedes e shokëve të tij.

— Kjo i përket së kaluarës — tha tjetri buzagaz.

— Gjetë! — U ndje zëri i Gjergj Martinit që tej.

— Ja, Gjergj, ja! — Gjegji ai, dhe, me agronomin bashkë bëri drejt komisarit të nënrepartit. Mbas pak, edhe Dedë Maranaj me shokët e vërtetë mbërriti aty.

— Erdhëm t'ju përcjellim, shoku Gjergj.

— Ne do të kthehemi prapë — tha tërë gaz komisari. Bile sa më shpejt, Dedë. Me këto duar do ta mblehim mundin e asaj fare, që e hodhëm pas aq peripecish e sakrificash.

— E di — tha brigadieri i traktoristëve. — Vitin e ardhshëm do të hedhim edhe më shumë farë. Kur të vini, këto parcela do t'i gjeni të hapura tej e tej.

Gjergj Martini e përqafoi dhe e puthi. Për të, traktoristi e brigadieri Dedë Maranaj, ishte një luftëtar hero. Shpesh, duke përfytyruar tabllotë epike të dhjetorit e të janarit të shkuar, atij i shfaqej madhështore këto figurë e thjeshtë njeriu të klasës punëtore.

Pastaj Dedë Maranaj u përqafoi edhe me Gjetë Sokolin e grumbullin e ushtarëve.

— Na shkruaj, Dedë! — i tha Gjeta. — Ne po shkoj-



më, po me një pjesë të mendjes e të zemrës, prapë do të jemi këtu.

Tjetri buzëqeshi.

— Do t'ju shkruaj, shoku Gjetë.

Ndërkohë, ushtarë e traktoristë po përcilleshin me njëri tjetrin. Shtrëngonin duart, përqafoheshin ndahe-shin.

Pastaj një zë u dëgjua:

— Shokë! Të gjithë në maqina!

Dhe autokolona, midis thirrjeve, duarve që ngrinshin lart e shamive që fluturonin në erë, u nis.

## P E R S H O K U N, J E T E N

23 gusht. Ditë vere. Natyra ishte në shpërthimin e saj më të plotë. Lart, në atë varg kodrinor, një pjesë e ushtarëve të nënrepartit, posa ishin rrjeshtuar. Komisar Gjergj Martini u hodhi një vështrim të kujdesshëm dhe filloi t'u ndajë frontet e punës.

— Në objekte — tha — do të punojnë njëzet e katër vetë. Nga tre në secilin objekt të nëndheshëm. Çdo treshe do të ketë edhe përgjegjës in e saj — dhe, një për një, përmendi emërat e atyre që do të drejtonin punime t.

— Shokë! — e ndrroi pastaj tonin. — Për çdo të papritur, ju përgjigjeni të parët. Barra bie tërësisht mbi përgjegjës at! — dhe ngadalë e plot seriozitet, ua bëri të ditura edhe një herë masat e sigurimit që duhej të merrnin gjatë kryerjes së atij procesi të vështirë.

— E qartë? — tha më në fund. — Lajthitja apo pakujdesia më e vogël, shpesh në këto lloj punësh kërkojnë kokë njeriu...

— Mos druani, shoku komisar! — tha një nga përgjegjës at e tresheve, duke marrë drejtqëndrim. — S'është hera e parë që punojmë në këtë front.

I heshtur, komisar Gjergji, e shikoi me vëmendje nënoficerin që foli.

— Po — tha. — Veç e keqja bëhet lehtë. Ndaj s'besoj se i mbetet qefi ndokuj nëse i dalim përpara ndonjë të papriture...

Tjetri buzëqeshi dhe uli kryet.

— Ashtu është! — tha edhe komandant Gjeta.



— Pra, a është e nevojshme, shokë. t'jua shpjegoj edhe një herë masat e sigurimit, sidhe kujdesin që duhet të tregojë secili gjatë kryerjes së këtij procesi delikat? — shtoi komisari dhe priti.

Askush s'u ndie.

— Pse heshtni? — pyeti ai. — Apo kjo heshtje do të thotë se i dini?

— Po — tha dikush.

— Mirë! — tha komisari. — Për siguri, përsëriti një herë para shokëve.

Ushtar Gazmend Sheti, si zakonisht, i qetë, i përsëriti me imtësi.

Gjergj Martini e dëgjoi me vërejtje.

— Unë gëzohem — tha — që ju në teori i njihni kaq saktë. Po kujdesi, prapë s'duhet t'ju mungojë! — dhe, në çast, urdhëroi që të tetë grupet t'u drejtoheshin objekteve përkatëse.

Të prirë nga përgjegjësat e, në garë me njëri tjetrin, ata u turrën e zunë vendet me ngut.

— Diva! — tha me vete komisari.

Dhe, në të vërtetë, ashtu ishin. Në punimet e dyjavëshit të kaluar, ata kishin zënë vendin e parë në gjithë atë njësi të madhe ushtarake. Komisarit i erdh mirë. Ai rezultat ish arritur edhe për meritë të tij e të Gjetë Sokolit. Dhe, duke e përfytyruar edhe një herë atë fitore e ata njerëz, bëri përpara drejt njerit prej objekteve. Pastaj, objekt më objekt, u ndal për kontroll e ndihmë.

Sa shpejt kaluan ato çaste! Më se tri orë midis tyre, po atij në atë betejë i qenë dukur si minuta ato orë të vrullshme. Kur doli, shtangu për një çast. Dielli, që e kish lënë disa hostenë mbi mal, po i afrohej mezit të shtegtimt të tij të asaj dite gushti.

— Sa paska shpejtuar! — tha me habi.

Nxori listën e u ul mbi një rasë guri, që qe bërë prush nga rrezet e atij dielli përvëltonjës.

— Saharë! — tha me vete, dhe menjëherë ndrroi vend.

Por, befas, në luginën që shtrihej rrëzë atij vargu kodrinor, një grup fëmijësh të kopshtoreve i zunë sytë.

Ata po loznin gazmorë nëpër fushë. Me ta, edhe dy edukatoret. Oficer Gjergj Martini, i pa dhe i njohu.

— Po Dritani, ku është? — tha më në fund me vete duke kërkuar me sy të birin. Megjithatë, nuk arriti ta dallonte. Të veshur me përparëset e bardha, që nga larg, të gjithë ju dukën njëlloj. Harmonia e ngjyrave, blerimi i fushës, gjelbërimi i kories, fluturimi dhe cicërimi i zogjve sidhe endja e atyre fluturave të panumërta mbi ato lule shumëngjyrëshe, e kishte zgjuar e magjepsur botën e tyre fëminore. Të pushtuar nga gëzimi dhe habia, ata rendnin nga njeri krah në tjetrin. O burra, kush të pregatiste një buqetë para shokëve, për t'ja çuar edukatoreve, pa le pastaj; kush të kapte një flutur shumëngjyrëshe! Kapja e saj kthehej në një gëzim të përgjithshëm të gjithë atij grupi vogëlushësh. E, në atë gëzim, përkrah tyre, merrnin pjesë edhe të dy edukatoret.

Gjergj Martini i kundroi edhe një herë që nga lart. Dikush, posa kish kapur një flutur.

— E kapa! E kapa! — thërriste vogëlushi, duke harbuar nëpër fushë.

Të tjerët, në pikë të vrapit, ju derdhën kureshtarë. Pastaj, zëra u dëgjuan:

— Zojush Ladi! Zojush Pina! Dritan Martini zuri një flutur! Dritan Martini zuri një flutur.

Atë emër e dëgjoi edhe oficer Gjergj Martini.

Po vogëlushët, duke harbuar mbas tij, akoma thërrisnin:

— O, çfarë fluturë! Çfarë fluturë, zonjushe!

I çelur nga ato brohoritje gazmore, Gjergj Martini u çua më këmbë. Po vogëlushin, për çudi, ende s'po mundej ta shquante.

— Dritan! Dritan! — i thirrën edukatoret — të lumtë! Eja, eja këtu!

Edhe oficer Gjergji e pa që nga lart të birin.

— Eh! — tha i emocionuar. — Ti s'e di, Dritan, po dhe këto objekte edhe këto transhe hapen për të mbrojtur lumturinë tënde lumturinë e shokëve të tu! — dhe, u mundua të krahasonte vogjëlinë e tij me të tyren e, pastaj, të përfytyronte edhe të ardhmen, kur jeta për të



birin dhe moshatarët e tij do të ish ndofta edhe më e bukur nga ajo ditë vere plot lule e gjelbërim, plot ngjyra e dritë të pafundme.

— Po — mendoi me vete — Patjetër, ashtu do të jetë! — dhe, në mbrojtje të asaj të ardhmeje, solli edhe një herë ndër mend detyrën që i qe ngarkuar:

— Duhet shpejtuar! — tha — Djersa në paqë... kursen gjakun në luftë! — Nxori fletoren për të shkruar ushtarët rezervistë të turnit të dytë. Ata do të vazhdonin punën e të parëve, që mbas dy ditësh do të largoheshin. Duke mbushur listën, i dualën para sysh kryetari i lokalitetit, katundet e largëta të asaj zone me terren të thyer kodrinor e, në fund, edhe ushtarët rezervistë të atij turni të ri, që do të zëvendësonin të parët.

— Sidoqoftë — tha — duhet të shkoj edhe vetë për të biseduar. Sigurimi i turnit duhet bërë në kohën e duhur. Minuta e humbur është e pafalshme. Disiplina është ligj për ushtarin. Nga disiplina tek heroizmi, distanca është pothuaj e padukur.

Dhe, duke arësytuar kështu, ktheu sytë nga lugina. Vogëlushët nuk po lodronin si më parë rrëzë kodrës. Të vënë në rrjesht për dy, me hap të lirë, me edukatoret në krye, po i drejtoheshin qytetit.

Po, në këtë çast, diçka tjetër e largoi vëmëndjen e tij nga të vegjëlit. Befas, objekti i parë i nëndheshëm gjëmoi. Pas tij, edhe tre të tjerët që i përkisnin krahut nga ish Gjetë Sokoli.

— Ja kaluan togës së dytë! — mendoi Gjergj Martini, duke i ndjekur me kujdes ato shpërthime. Nga jehona e buçitjeve, shpesh çelej në fytyrë, po ngandonjëherë edhe vrenjtej. Ai e kuptonte më së miri atë gjuhë. Pra edhe efektin e atyre plasjeve... Gjuha e shpërthimeve ish bërë gjuha e tij e ditës.

— Ju lumtë! — tha më në fund. Pastaj u çua dhe bëri përpara në drejtim të objekteve të togës së dytë.

Hyri dhe u ndal objekt më objekt. Kontrollloi dhe ndihmoi.

— Kujdes! Kujdes! — u thosh.

Po edhe fjalën «Shpejtoni» s'e hoqi nga goja.

Minatorët buzëqeshnin dhe pandërprerje shpejtonin. Vrulli i garës midis të dy palëve kish arritur kulmin. Po cila nga të dy togat do të fitonte? Ende s'dihej.... Në fund, një zë buçiti nga thellësia:

— Shokë! Gati për zjarr!

Objekti i nëndheshëm u boshatis.

Me ta doli edhe komisar Gjergji. Pastaj, një varg i gjatë shpërthimesh filloi.

I heshtur, komisari përsëri i ndoqi me kujdes e një për një ato shpërthime, sikur do të përcaktonte vlerën e secilit prej tyre me radhë.

— Ja! — tha — Këtyre u thonë plasje! — dhe, u ul bri një shkëmbi, për t'i hedhur edhe një herë një sy të shpejtë listës së ushtarëve rezervistë të turnit të ardhshëm, që ende s'e kish plotësuar.

— Mos ndofta kam harruar ndonjë prej tyre? — tha me vete, duke i sjellë para syve një nga një.

Ndërkohë, në objektin Nr. 2 të togës së parë, dy shpërthime minash buçitën në thellësi. Ky objekt posa kish filluar serinë e dytë të shpërthimeve të tij. Por, mina e fundit nuk u ndje të buçiste. Treshja e drejtuar nga Gazmend Sheti mbeti në ankth. Por ende asnjë shenjë... asnjë zhurmë.

— Shokë! Po hyj unë! — tha më i riu i të treve, një djalosh me sy të kaltër.

Përgjegjësi u vrejt menjëherë.

— Mos ke luajtur mëndsh? — i tha. — Në asnjë mënyrë nuk të lejoj! Rregulli teknik duhet zbatuar me përpikmëri gjer në fund. Apo s'e dëgjove komisarin se ç'na tha?

Tjetri u step. Mbi ballin e pluhurosur, djersët e turbullta kishin filluar t'i rridhnin rrëke.

Pastaj, heshtja i mbuloi. Heshtje e ankth.

— Pse nuk ndihen? — tha komandant Gjeta që larg.

— Dreqi ta hajë! Kam frikë se do ta humbin këtë garë!  
— dhe i shqetësuar vrapoi drejt objektit të dytë.

— Ç'prisni? Po afron fundi i turnit!

— Një minë, shoku komandant... Një minë ende s'na ka plasur — tha Gazmend Sheti i zbetë në fytyrë.



Gjeta u hodhi një sy të treve. Fytyrat e tyre të zymta dukeshin si të ngurrosura krejt.

«Ankthi i pritjes!» mendoi ai i heshtur. Pastaj:—  
Po shkoj unë ta çmnoj — tha pa u menduar gjatë.

I tronditur, përgjegjësi i treshes i preu rrugën.

— Në asnjë mënyrë, shoku komandant! Në asnjë mënyrë! Një veprim i tillë do t'ju rrezikonte jetën! — Dhe duke i qëndruar përballë, hapi krahët për ta ndaluar.

— Zmbrapsu! — tha oficeri. — Nuk është hera e parë që unë zbërthej mina të paplasura. Zmbrapsu, po të them!

— Po ju po shkelni urdhrat që kini dhënë vetë si komandë, shoku Gjetë... Komisar Gjergji urdhëroi...

Po nuk arriti ta soste atë mendim. Duart e fuqishme të oficerit e spostuan. Pastaj, rruga u hap, dhe Gjetë Sokoli, treti nëpër errësirën e atij objekti të nëndheshëm.

— Ç'bëri! — tha me pezmatim përgjegjësi i treshes dhe duke i ndukur buzët nga nervozizmi, i përgjaku. Pastaj, pa humbur sekondën, ju vu pas duke i thirrur.

— Ç'janë këto thirrje? — tha me habi komisar, duke i dëgjuar së largu. Pastaj: — Shokë! — briti — Ç'po ndodh aty tek ju? Kujt i thirri ashtu ushtar Gazmendi?

— Një minë, shoku komisar... Një minë nuk na ka plasur! Shoku Gjetë vendosi ta çmnojë. Komandanti ynë i skuadrës, ushtar Gazmendi, sipas urdhërit tuaj, u mundua të mos e lejonte, po ai, duke e zmbrapsur me duar e urdhëroi t'i hapte rrugë. Pastaj...

— Si? Gjeta?! — ja bëri tjetri, duke u dredhur nga ai ankth mbytës — Po hyri, apo...?

— Hyri, shoku komisar! Hyri! Pas tij, për ta ndaluar, edhe ushtar Gazmendi... S'dimë si e bëri këtë punë komandant Gjeta. Po tani jeta e të dyve është në rrezik...

Gjergj Martini i maramëndur u drodh me tmerr. Lapsi i ra nga duart e, po ashtu, ajo lista e ushtarëve rezervistë.

Kaq. Pastaj, sikur toka t'i qe ndezur nën këmbë, duke i lënë aty bluzën e kapelen ushtarake, në kanatjerë, ashtu siç ish, u sul drejt objektit ku ish futur Gjetë Sokoli. Vraponte, dihaste e thërriste me ankth:

— Gjetë! Gjetë!

Po edhe një zë tjetër ndjeu në thellësi të objektit, që i thërriste atij: «Shoku Gjetë, kthehu, ktheu, të lutem!

E, në ato hapa tmerri, si në një ekran filmi, Gjergj Martinit ju duk sikur ajo gryka e errët që po i afrohej po merrte flakë. E ai, duke harbuar, do të ecte midis atyre flakëve për t'i thënë: «Ndal!» Vdekjes që po vraponte nga krahu tjetër. Po kush nga të dy palët do të arrinte më parë në atë cak? Ai apo vdekja? E kur të arrinin, në atë ndeshje aq të vështirë, kush do ta nënshtronte shokun në errë-sirën e atij objekti të nëndheshëm? Ai vrapon pa u ndërprerë. Të tjerët, me zemër në dorë, kanë mbetur të ngri-rë... Diçka të tmerrshme presin që të ngjasë. Dhe Gjergj Martini duke ju afruar grykës së objektit, harbon. Buzët i shkumëzojnë, sytë i shkrepëtinë. Dhe ai bredh, duke i thirrur herë Gjetës, herë Gazmend Shetit. Po asnjëri s'i përgjigjet. Bile tani as ushtari s'po dëgjohet më si më parë.

— A do ta arrij? — thotë me vete — Po sikur... — dhe ja befas, i ngjan sikur mina merr flakë. Galeria ushton... E pastaj, Gjetë Sokoli e Gazmend Sheti copë copë të shpërndarë shkëmbenjve të asaj gryke të thellë.

Më në fund hyn. Hyn e thërret:

— Gjetë! Gjetë! Dil! Dil, po të them!

Po hapin s'e ndal. Veshët i mban bigë. Po përgjigje nuk merr!

— Gjetë! A dëgjon? Dil, po të them! Dil! Kjo është shkelje e urdhërit ushtarak, more shok!

Kështu i thërret. Dhe zëri gjëmon. Dhe ai sërish vrapon e vrapon me sa mund, duke i thirrur vazhdimisht. Po në atë thirrje ka diçka që të rrënoqeth, që të trondit.

Dhe galeria pa ndërprerje ushton. Dhe pastaj, një përgjigje nga thellësitë e dheut:

— Ja, ja! Sa ta çminoj, Gjergj!

— Çfarë? More, dëgjon? Dil, dil, po të them! — dhe si i çmëndur, akoma shpejton.

Tani dhe Gazmend Sheti posa ka arritur në vend.

— Oh, ç'bëni, ç'bëni ashtu, shoku Gjetë? Po kjo është shkelje e urdhërit ushtarak... Në është puna për ta zbërthyer, ju lutem më lini ta zbërthej unë! — dhe me ankth



mundohet ta zëvendësojë. Tani në kokë ai ka vetëm një mendim: jeta e komandantit është më e çmuar se jeta e tij si ushtar i thjeshtë. Po ndërkohë zëri i Gjetë Sokolit kumbon i rëndë e qortues:

— Gazmend! Ikë, ikë të thashë!

— Jo, kjo s'është e drejtë, shoku Gjetë.

Po tjetri nuk i kthen më përgjigje. Gjendje e nderë. Ndërkohë Gjergj Martini akoma vrapon.

I kërrusur duke e kundërshtuar ushtarin, Gjeta e ka mëndjen tek zbërthimi i asaj mine, që nuk ndoqi rrugën e dy shoqeve të saja të para. E ajo duhet çminuar. Ndaj ai po lufton. Po ja, dy forca krejt të kundërta posa kanë aritur mbi kokë të tij. Në një krah vdekja e në tjetrin oficer Gjergj Martini që i thërret:

— Gjetë! Mos u çmënde? Largohu! Largohu, po të them!

Po s'arrin të vazhdojë. Çasti i fundit ja beh. Një xixë jep shenjë buzë fërnellës.

— Mbarim i sigurt! — mendon komisari i maramëndur. — Megjithatë duhet vepruar.

Dhe ai vepron. Duke e rrëmbyer për shpatullash Gjetë Sokolin, e hedh mbas krahëve të tij. Po tani? Tani asgjë s'e ndan prej vdekjes. Asgjë. Kurrë s'e ka patur kaq afër. Gjergj Martini bën të zbrapset. Instinktivisht, hedh hapin e parë, të dytë, të tretë.... Po prapë është pranë.

Dhe rrufeja nga shkëmbi i nëndheshëm shkrep. Objekti në thellësi ndizet si krater. Nëntoka gjëmon. Nga presioni, Gjetë Sokoli fluturon e shëmbet katër metro tej.. Bije bri një rase, i dërmuar e i mbytur në gjak. Për një moment as dëgjon, as flet. Jeton? Ku ta dish? E po ashtu edhe Gazmend Sheti që është goditur disa më lehtë. Të dy ndodhen në një krah, kurse në krahun tjetër, gjashtë metro larg kraterit që shpërtheu, ka mbetur i shtrirë Gjergj Martini. Edhe ai i hutuar, e i përgjakur keq. Po vetëdijen s'e ka humbur. Veçse plagët ende nuk i ndjen. Veshët i uturijnë plot tallaz. E, për çudi, prapë i ngjan sikur e sheh atë flakën që shpërtheu. U ndez për të rrëmbyer Gjetë Sokolin! Dhe ai, për Gjetën erdhi të ndeshej me të! Po ku është Gjeta tani? Përse nuk ndihet? Përse nuk i thërret? Për-

se nuk jep shenjë jete? Po ushtar Gazmend Sheti? Ku vajti ai?

Dhe komisari shtang për një moment. Pastaj:

— Gjetë! Gjetë! Gazmend! — u thërret me rënkim.

Po Gjetë Sokoli e Gazmend Sheti nuk i përgjigjen.

Dhe ai prapë u thërret. Po, rishmë, përgjigje nuk merr.

— Të kenë dalë? E pamundur. Unë i njoh... Ata kurrë nuk i lenë shokët vetëm... Sidomos në çaste të vështira.

Dhe, befas, në këtë pritje, i kujtohen të gjitha me radhë. I duket sikur akoma po e dëgjon zërin e Gazmend Shetit nëpër objekt, e pastaj, ai vetë, Gjergji, duke rendur e duke i thirrur: «Gjetë! Dil! Dil, po të them!» E, sado që bredh, i duket sikur ajo distancë s'ka e s'ka të mbarruar kurrë... Pastaj, ja edhe gryka e objektit të errët dhe ai që vrapon të shpëtojë shokun... Dhe ndeshja u bë...

Tani, ai i përfytyron të gjitha me radhë! Të gjitha. Dhe objekti i nëndheshëm hesht. Po Gjetë Sokoli ku është? Vallë, a munda të shpëtojë? Po, tek e fundit, cili që qëllimi i tij? Apo mos ndofta...? Si?

Ngjethet.

— Jo! Nuk dua ta besoj... Ai ishte mbas meje. Larg, shumë më larg shpërthimit të saj! Edhe Gazmendi po ashtu.

Dhe, i shqetësuar, prapë u thërret:

— Gjetë! Gazmend! Po përgjigjuni, more shokë!

Heshtja thyhet.

Dikush rënkon....

Ai çelet në fytyrë.

— Shenjë jete! — thotë. Dhe prapë u thërret...

— Më duket se jam plagosur, Gjergj! Po ti, a munde të shpëtosh? Të mora më qafë, shok... Ty dhe Gazmendin.

Fjalët i dalin të shkëputura, të përgjysmuara, me zor...

— Qënka rëndë! — mendon Gjergj Martini dhe zvarritet në drejtimin nga erdhi ai zë në të shuar.

Po me sy asgjë s'dallon.

— S'të shikoj, Gjetë! Ku je... ?

— Këtu! Këtu, Gjergj. Pranë Gazmendit...

Ushtari përmendet... po goditja në kokë e ka tru-



llosur rëndë. Provon të ngrihet, por mëntë i merren dhe bie.

— Gazmend, si ndihesh? — i thotë me tronditje Gjetë Sokoli

— S'më mbakan këmbët, shoku Gjetë. Siç duket do ta kem nga trulllosja. — Po ju a kini pësuar gjësend?

— S'e di... Po dishka do të kem pësuar, Gazmend. Komisari i dëgjon ato fjalë dhe prapë mundohet të zvarritet. Po edhe kur duart i ndeshin në trupin e Gjetë Sokolit, Gjetën nuk arrin ta shikojë.

— Gjergj, edhe unë e paskam të vështirë të ngrihem!

— S'ka gjë. Të marr unë, Gjetë. Në fillim ty, e pastaj edhe Gazmendin.

— Jo. Unë mund të dalë vetë, shoku komisar... Po sa të mbledh pak veten!

— Sidoqoftë! — dhe pafjalë, Gjergj Martini hedh mbi supe Gjetë Sokolin dhe fillon të ecë, duke lënë pas në errësirë dy vazhda të forta gjaku.

— Gjergj! Kthe drejtim! Këtej s'mund të kalohet... Është faqja e objektit, është mur...

Gjergj Martini kthen drejtim. Po prapë, pak më tej, i shkon me krye asaj faqeje muri.

Gjetë Sokoli tmerrohet.

-- Gjergj! Po ti s'shikon, more shok!

— S'e di, Gjetë. Ndofta ma ka hutuar dritën e syve shkrepëtima verbuese e minës që shpërtheu. E pata fort pranë dreqin!

Dhe prapë vazhdon të ecë.

Tani, edhe të dy ushtarët që kanë mbetur jashtë, pas atij shpërthimi, me një elektrik dore, ja behin në vend.

— Hapa! — thotë Gjergj Martini. Pastaj:

— Shokë! — u thurret. — Shokë!

Ushtarët çelen. Ata e njohin atë zë. Po befas, trupi i oficer Gjetës mbi krahët e komisarit i shtang.

— Qënka vrarë! — mendojnë dhe gjunjët u priten.

— Mos u shqetësoni! — Jemi gjallë.. Po ushtar Gazmendi na ka mbetur te vendi i minave... Ndhimjojeni që të dalë.

Të dy ushtarët vrapojnë në thellësi.

Mbas pak, Gjergj Martini e Gjetë Sokoli dalin. E pas tyre, edhe Gazmend Sheti, që është goditur lehtë. Rrezet e diellit ua lëmojnë lëkurën dhe ata menjëherë e ndjejnë atë ngrohtësi.

— Gjergj! — i thotë Gjeta, duke hapur sytë me të vështirë — Të faleminderit! S'do ta harroj kurrë këtë që bëre për mua. Veç falëm, shok!

— Asgjë. Edhe ti do ta bëje për cilindo nga shokët. Po si ndjehesh tani?

— Siç më sheh...

— Unë s'të shoh, Gjetë! Flaka goditëse e minës, me sa duket, ma ka hutuar hë për hë të parit.

— Si? Ti nuk më sheh as mua?!

— Jo. As diellin...

Gjetë Sokoli zbehet e me pëllëmbën e dorës fshin gjakun që i rrjedh mbi fytyrë.

— Shok! — i thotë pastaj njerit prej ushtarëve. Më ndihmo të ngrihem pak!

Ushtari i tronditur, e ndihmon. Ai mbështet bërrylat për tokë e ngrihet përgjysëm. Dhe e sheh... Po sytë e komisarit s'janë më si më parë... Ata e kanë humbur shkëlqimin, e kanë humbur ëmbëlsinë, e kanë humbur dritën... Ata kanë dukje të verbëri.

Dhe Gjetë Sokoli, i tmerruar, këtë e vuri re mirë. Gjuha ju lidh e dielli ju err nga dhimbja e thellë.



## FJALA E SHKENCËS

Ngjarja e objektit Nr. 2 e alarmoi udhëheqjen e komandës. Të dy të plagosurit u çuan menjëherë në spitalin e qytetit. Gjeta duke u përplasur shkëmbenjve, kishte pësuar një frakturë në ballë, kurse Gjergji, i prekur nga vala goditëse e minës, kishte humbur dritën e syve. Ndërsa për të parin gjendja s'paraqitej e rëndë, për të dytin çdo fill shprese dukej pothuaj i prerë.

Dhe vërtet, Gjetë Sokoli, shpejt u çua në këmbë. Pas një ndërhyrjeje kirurgjikale, fraktura në ballë u vu në udhën e shërimit të plotë. Po ndryshe ishte puna me Gjergj Martinin.

I tronditur, okulisti i krahinës, bëri përçapjet e para.

— E? Si duket? — i tha me shqetësim komisarari i njësisë, që po i qëndronte qiri mbi krye.

— Rëndë, shoku komisar, rëndë...

Ai u vrenjt në fillim e pastaj fytyra e kuqerremtë dalëngadalë ju zbeh e, po ashtu, vështrimi i atyre syve aq të zjarrtë e lëvizës ju err.

— Po Tirana — tha më në fund me vete, pa e fshehur dot atë shqetësim të thellë. — Pse s'po na përgjigjet akoma? — Dhe ashtu i nxehur, ai prapë vazhdoi të mendonte me vete: «Po mirë, xhanëm, mirë, po çfarë quajnë ndihmë ata? Të vinë kur gjithshka të ketë mbaruar? Kur ndihma të mos ketë më mundësi të jipet? Kur dhënia e saj të mos ketë më asnjë vlerë? Kur... kur nieri të ketë...» — dhe në atë valë ankthi e shqetësimi, shkoi orën.

Kishin kaluar vetëm dyzet minuta, që nga ajo telefonatë, kur ai me duar të dridhura e kish ngritur dhe e kish ulur atë receptor telefoni.

Dyzet minuta! Kurse Tirana ishte më se njëqind e tridhjetë kilometro larg.

— Mos ndofta ora ime ka mbetur? — tha me habi dhe, i heshtur, plot nervozizëm, e vuri në vesh sahatin: punonte. Dhe ai e ndjeu atë «tik-tak» aq të njohur për të. Po përse i ish dukur sikur kish orë të tëra që kish telefonuar?

— Sidoqoftë — tha më në fund me vete — duhet marrë edhe një herë Tirana — dhe në çast, shpejtoi në zyrën e drejtorit të spitalit.

— Alo! Jam komisar i repartit 8001. Drejtori i spitalit ushtarak në Tiranë?

— Po, shoku komisar.

— A u nis okulisti që kërkuam për ndihmë?

— Po, shoku komisar. Në këto çaste duhet të jetë në mbrrijtje e sipër. Po si paraqitet gjendja e të dëmtuarit? Rëndë?

— Rëndë! Tepër, tepër rëndë...

— Shoku komisar...

Po ai s'i dëgjoi fjalët e fundit. Befas receptori i ngriu në duar. Një zhurmë buçitëse u dëgjua mbi qytet. Zhurme që sa vinte e afrohej.

— Helikopteri?! — tha i përqëndruar tek ajo zhurma që vinte që lart. Pastaj, duke e lëshuar receptorin mbi tavolinë, vrapoi në dritaren më të afërt dhe nxori kryet jashtë.

Njeriu që pritej, tanimë nuk ishte larg. Ai ishte nisur me urgjencë, me urdhër të udhëheqjes së Ministrisë. Mbas pak, doktor Sinah Imeri hyri në sallë.

\* \* \*

Për tri orë me radhë, Gjergj Martini qëndroi i shtritur në atë shtrat operacioni, duke u kuruar prej të dy mjekëve. Me durim, ata bënë përpunimin fillestar të plagës. Gjendja aktuale s'lejonte për ndërhyrje të mëtejsh-



me. Kështu, të nesërmen, mjeku i ardhur nga qëndra, u largua. Po ditët e ardhme treguan se gjendja e oficerit të plagosur ish e rëndë. Dhe jo vetëm atë, po për ditë e më shumë vinte duke u keqësuar. Në ato kushte, me kujdesin e vet komisarit të njësisë, u vendos që Gjergj Martini të sillej në spitalin ushtarak të Tiranës. Dhe ashtu u bë. Ai erdhi katërbëdhjetë ditë mbas asaj ngjarjeje të hidhur. Sytë akoma i kishte të zënë me një fasho të bardhë. Po, megjithatë, njeriun që e priti, e njohu menjëherë në zë.

— Jeni ju, doktor Sinahu?

I emocionuar, mjeku e përqafoi.

— Po, Gjergj. Unë jam.

Pastaj, pacienti u shtrua në një dhomë të veçantë. Duke e mjekuar, doktori u zbeh në fytyrë. Me të vërtetë gjendja ish serioze. Syri i djathtë kish pësuar një goditje dërrmonjëse. Vala goditëse e minës e kish prekur tepër rëndë, duke i shkaktuar në brendësi emoragji të shumtë. Gjithashtu, retina e tij ish mbuluar me vatra gjaku anembanë.

— Keq! — tha me vete doktor Sinah Imeri.

Po e keqja ish edhe më e thellë. Veç atyre vatrave, ai shqoi edhe një «retinit eksudativ» në këtë sy të oficerit të plagosur. Pra, retina ish në gjendje qelbëzimi të plotë.

— Gjergj! — i tha mjeku mbas disa ditësh — Më thuaj, çfarë arrin të dallosh me syrin e djathtë?

— Vetëm dritën nga errësira. Po dhe atë krejt të turbullt, doktor...

Mjeku s'foli për një çast. Syri i djathtë i Gjergj Martinit s'arrinte të kapte pamje të formuar, s'arrinte të shquante asnjë nga objektet që e rrethonin, sado afër që të ishin. Dhe ky ish syri i dëmtuar më pak. Tjetri dukej i shuar krejtësisht. Nga radiografitë e bëra në spital, delte se tri copa mine kishin depërtuar në thellësi të tij. Nga kjo goditje, ai ish i skuqur dhe i acaruar keq. Dhe, veç kësaj, edhe një perde ish formuar sipër tij. Pra katarti i ish veshur. Pamja i mungonte tërësisht.

I heshtur, doktor Sinahu mendohej me shqetësim. Ai vuri në përdorim gjithë terapinë e mundshme, për ta për-

mirësuar sado pak gjendjen e të djathtit, dhe, nga ana tjetër, për ta qetësuar disi të majtin.

Gjatë këtij procesi, mjeku vazhdonte të ishte në ankth.

A do të kishte rezultat?

Fjala i mbetej kohës. Dhe mbas një lufte të gjatë në këtë drejtim, i plagosuri arriti të ndjente një farë përmirësimi në syrin e djathtë.

— Doktor! — i tha një ditë i çelur në fytyrë — S'di ç'po ndodh... Por sot, drita më duket më e kthjellët!

Mjeku u drodh nga gëzimi.

— Ti do të përmirësohesh, Gjergj!

— Unë s'e kam humbur këtë besim! — tha tjetri — Po dhe në mos ja arritsha asaj dite, ju e bëtë tuajën si mjek.

Po, ndërsa i djathti kish nisur të jepte ndonjë shenjë jete, i majti vazhdonte të bëhej keq e më keq.

«Duhet bërë sërish disa ndryshime në terapinë e caktuar! — mendoj me ankth doktor Sinah Imeri».

Dhe, me kujdes, duke i qëndruar mbi krye Gjergj Martinin, ai e vuri në zbatim këtë ndryshim të pjesëshëm terapie.

— E, Gjergj? Si ndihesh? — i thosh ngaherë.

— Më mirë, doktor! — i tha një ditë pacienti — Më duket sikur tani dritën e shikoj edhe më qartë. Por juve s'ju dalloj. Dhe më vjen keq, që s'ju kam njohur para se të humbja sytë... Të paktën, po t'ju kisha njohur që atëhere, do të mundja, edhe në këtë gjendje, ta përfytyroja njeriun që po mundohet për mua kaq shumë.

— Kjo s'ka rëndësi, Gjergj. Çështja është që ti një ditë të arrish të shikosh disi më qartë.

— Nejse, sidoqoftë doktor, unë tani nga zëri ju shquaj menjëherë. Bile, edhe sikur të flitni midis njëqind vetësh...

Mjeku u mallëngjye.

— Eh, Gjergj, Gjergj! — tha — Po, sido që të jetë, unë kam besim se shkalla e të pamit tënd do të rritet. Një farë përmirësimi do ta kesh. Veçse, ajo ditë, nuk vjen menjëherë.

Gjergj Martini buzëqeshi.



Pastaj, ditët sërish rrodhën ngadalë. Ditë në shtrat. Ditë pa dritë... Po, sado në këtë gjendje, ai mbahej fort. Mjeku me personelin sanitar të spitalit, ishin ngushëllimi i tij i parë e, po ashtu, të afërmit, e shoqja, shokët që e vizitonin shpesh. E më shpesh nga të gjithë, ndofta, vetë komisar i njësisë.

— E, doktor? Si duket sot? — e pyeste në telefon nga provinca, për çdo mëngjez.

— Disi më lehtë, shoku komisar, Po shpresat ende janë të pakta. Gjendja është afërsisht ajo e djeshmja.

Komisari, i heshtur, ulte receptorin mbi aparatit telefonik.

Po, ndërsa të tjerët mbaheshin para të plagosurit, e shoqja, ngandonjëherë, përlotej.

— Mos ashtu! — i tha një ditë me keqardhje — Ti e di... Unë kurrë s'i kam dashur lotët.

Ajo u mundua ta mbante ngashërimin, po prapë nuk mundi dot.

— Martë! — i tha ai. — Unë e kuptoj shqetësimin tënd. Por, po të ishe në vendin tim, edhe ti do të bëje atë që bëra unë...

Ajo s'foli. Fshiu lotët dhe, me dorën që i dridhej, i lëmoi ballin dhe flokët të shoqit.

Ai i buzëqeshi.

— Po kush të tha se unë nuk do të shërohem? Dhe bile plotësisht... Doktor i ka të patundur këtë besim! — dhe, megjithëse ai s'e kish një iluzion të tillë dhe as mjeku s'i kish folur ndonjë herë në atë mënyrë, prap se prap, për t'i lehtësuar dhëmbjen së shoqes, ja tha ato fjalë, duke i dhënë zërit një tingull krejt gazmor e optimist.

Ajo u çel.

— Ah, kur do të vijë ai çast, Gjergj.

Dhe ashtu me atë gjysëm shprese e bindjeje, para se të largohej i tha me një ton disi të gëzuar.

— Gjergj! — T'i lashë për në fund. Të kam sjellë edhe dy letra. Njërin nga rrafshnalta ta dërgon Dedë Maranaj kurse tjetrën ushtar Gazmend Sheti.

Ai u çua përgjysëm mbi shtrat.

— M'i lexo, Martë!

«I dashur shoku Gjergj! — i shkruante Deda. — Ak-sidenti që pësuar në punën e syve, e ka prekur gjithë kolektivin tonë të traktoristëve. Megjithëse larg, ne vazhdimisht ju ndejmë pranë... Ja, Shishtaveci prapë ka filluar të zbardhet. Kjo zbardhje na kujton dhjetorin e janarin e kaluar kur ishim bashkë. Tani frutet e para të bimës së mbjellë kemi filluar t'i vjelim. S'e merrni me mend se çfarë gëzimi ndiejnë ushtarët çdo mëngjez, kur derdhen nëpër parcelat për të vjelë. As ngrica e vazhdueshme dhe as bora që ka filluar të na kujtojë ngandonjëherë, nuk i ka stepur për asnjë çast. Sasia e grumbulluar e patates rritet papushim, megjithëse karvanë makinash vinë e ngarkohen përditë. Ju me siguri do të dëshëronit të dinit se sa është prodhuar për hektar, po këtë përgjigje e kam të vështirë t'ju jap para përfundimit të plotë. Megjithatë, në parcelat e vjela, si në Turraj, ashtu edhe në Novosej, gjer tani kemi marrë mbi 160 kuintalë për hektar.

Ndërkohë, hapja e tokave të reja vazhdon. Traktorët tanë s'pushojnë as natë, as ditë. Tani edhe Nikolin Maranaj nuk trëmbet më si atëhere...

Kështu venë punët këtej. Veç na vjen keq që s'ju kemi pranë. Kur të mbarojmë do t'ju shkruajmë për rezultatat me hollësi. Pres të na njoftoni rreth gjëndjes suaj.

Duke ju përçafuar, përherë juaji

Dedë Maranaj»

Kurse ushtar Gazmend Sheti i shkruante ndër të tjera: «Më vjen keq që s'kam mundësi të vij e t'ju shikoj, po me mendje e zëmër unë jam vazhdimisht... aty pranë jush, shoku komisar. Aty pranë jush...»

— Njerëz të mirë! — i tha së shoqes i emocionuar.

\* \* \*

Po ai që përkujdesej për gjëndjen e Gjergj Martinit vazhdimisht, ishte Gjetë Sokoli.

— Alo! Shoku doktor, jam Gjeta! Si duket Gjergji tani?



Mjeku që tanimë e njihte atë zë që vinte nga qyteti i largët verior i spjegonte me hollësi. Po Gjetë Sokoli nuk kufizohej vetëm me marrjen në telefon. Të shtunave mbasdite ai nisej kasten nga provinca, për t'i kaluar disa orë të të djelave pranë njeriut që për të kish falur dritën e syve.

— Gjergj! — i thërriste me të hyrë dhe i përmalluar me kujdes e rrokte nër krahë. Tjetri çelej e ashtu buzagaz e qortonte si ngahera:

— Po a s'të thashë herën e kaluar se s'ka nevojë të marrësh javë për javë një udhë kaq të gjatë? Po sikur të ishe në Shishtavec, ç'do të bëje? Shiko! Po të vish javën tjetër do të më vijë keq...

— Shohim gjer javën tjetër, Gjergj! Po kisha mall t'i kalonim disa çaste bashkë. Dhe mos harro.... Ti... për mua... Ti... Ah, Gjergj, Gjergj!...

— Pse flet kështu, Gjetë? Unë bëra atë që do të bënte gjithkush nga tanët. Atë që nesër, po të jetë nevoja, do ta bësh edhe ti për të tjerët. Atë që bëri edhe ushtar Çelua për një shok të panjohur, apo ushtar Zenel Metaj për mua. S'besoj ta kesh harruar hedhjen e tij sipër flakëve të asaj gisternës së ngarkuar me katërmijë litra karburant. Dhe po ashtu, pavarësisht nga fërkimet e ndonjë arrest i padrejtë që mund t'i kishe dhënë, të njëjtën gjë bëri edhe ushtar Gazmend Sheti për ty, duke shkelur i qetë mbi vdekjen. S'besoj ta kesh harruar edhe atë gjest të tij, edhe atë gjak...

— Jo. Kurrë, Gjergj. Veçse më vjen keq që tani në fund e transferuan pranë komandës së njësisë. Mbas disa muajsh, siç e di, ai do të lirohet. Kurse unë në kujtesën e tij për gjithë jetën kam për të mbetur një njeri i egër. Dhe kjo, kohët e fundit, ka filluar të më vrasë shumë. Sa i gabuar paskam qënë dhe sa vonë arrita të kuptoj se s'paska ushtarë të këqinj, po komandantë të pazotë, që s'dinë të punojnë e të merren vesh me ta...

— Më mirë vonë, se kurrë, Gjetë,

— Sidoqoftë, ja ku ta them, ajo sjellje kundër Gazmend Shetit e të tjerëve do të më brejë e do të më mendojë gjer në fund. Dhe krahas saj, edhe një goditje tjetër,

që s'më lë të qetë: ishim tre bashkë me Nikën, kurse tani, për fat të keq, kam mbetur vetëm unë! Unë i dobëti, Gjergj....

— Pse i dobëti? — tha tjetri me keqardhje të thëllë — Dhe pse mua më llogarit të humbur e të pashpresë? Gabohesh, Gjetë! Gabohesh! Unë s'kam vdekur. Unë do të ngrihem një ditë. E prap do të kthehem atje ku isha. Midis shokëve.... Midis njerëzve! Ti harron se unë e dalloj dritën nga errësira. Kurse dhe pa dritë, ka njerëz që kanë parë gjer në rrahjen e fundit të zemrës së tyre! Drita e syve varret nga fuqia e zemrës. Të kujtohet Pavel Korçaguini? S'është përrallë! Po jeta e gjallë e Nikollaj Ostrovskit? Në s'kam të drejtë, ma kundërshto hapët mendimin!

Gjetë Sokoli, i prekur nga këto fjalë, s'qe në gjendje t'i flasë.

— Përse s'më përgjigjesh, Gjetë? Apo s'është kështu si të thashë?

Kështu ai bënte sa herë që Gjetë Sokoli i fliste me zemër të vvarë. Pastaj, gazmor, pyeste me radhë për shokët, për jetën në repart, për punët dhe detyrat që kishin përballë e pastaj edhe për atë vajzën e bukur të uzinës së telave, Katrinën.

Gjeta fillonte t'i shpjegonte për të gjitha, me radhë. E, midis të tjerave, edhe për Shishtavecin, ku, në vend të tyre, për vjeljen e patates, komanda e njësisë kish çuar një nënrepart tjetër. Përgjigjen për Katrinën e linte gjithnjë për në fund. duke i rënë sa më shkurt e duke thënë se ende s'kishte dishka të përcaktuar mirë në marrëdhëniet midis tyre.

Gjergji, i mbështetur mbi jastëk, e dëgjonte me kujdes, duke i përrpirë çdo fjalë. Pas largimit të Gjetës, ato biseda bëheshin preokupacioni i tij i javës. Shokët, repartit, objektet që kish lënë për s'vësëm, Shishtaveci, i dilnin shpesh para sysh. I dukej sikur sërish i shihte ashtu siç i kish lënë, ashtu siç i kish parë, para asaj ngjarjes së hidhur e të paharruar të 23 gushtit.



Pas ndryshimit të pjesshëm të terapisë dhe luftës në të dy frontet, në muajin e tretë, pamja e syrit të djathtë u ngrit gjer në një të dhjetën e pamjes së tij të dikurshme. Në këtë kohë, edhe syri i majtë, kish arritur disi të qetësohej. Më vonë, gjendja e të djathtit nisi të përmirësohej edhe më shumë. Gjergj Martini provoi të ngrihej. Ish hera e parë që, mbas tre muajsh strukjeje, në atë shtrat lëngimi, mundi të ecte pa ndihmën e të tjerëve. I entuziazmuar, kërkoi mjekun për ta falënderuar.

— Doktor! — i tha — Ndofta ende nuk jua dalloj fytyrën, po megjithatë, tani unë e kuptoj se kam një njeri përpara vetes. Dhe kjo më jep zemër dhe shpresë për më tutje. Ju kërkova vetëm sa për t'ju falënderuar.

Tjetri, i emocionuar, e rroku dhe e përqafoi.

— Gjergj — i tha — ti në të ardhmen do të shikosh edhe më mirë... Unë këtë bindje tanimë e kam më se të plotë.

— Sidoqoftë, doktor, s'do ta harroj kurrë këtë që bëtë për mua! — dhe duke u ngritur, në sy të mjekut erdhi rrotull nëpër dhomë.

— E shihni? Mund të eci pa ndihmën e njeriut! Pa të marrë mendësh e pa u penguar. Çdo gjë përballë, ndofta jo qartë, po për të shquar e shquaj. Dhe kjo, hë për hë, s'është pak...

Doktor Sinah Imeri mori zemër nga ato fjalë.

— Çfarë besimi e kurajo! — tha me vete dhe, me miratim, hodhi vështrimin mbi atë njeri që mbas aq kohe, si fëmijët që rrëzohen, po ngrihej edhe një herë në jetë.

Po ky gëzim, tanimë, kish përfshirë tërë pacientët, shokë e miq të Gjergj Martinut.

— Erdha t'ju kthej vizitën! — u thosh shokëve, duke hyrë nëpër dhomat e tyre.

Ata, gazmorë, ngriheshin dhe e pritnin.

Kështu kaluan një varg ditësh. Dhe çdo ditë sillte diçka të re. Syri i djathtë i të plagosurit po shkonte vazhdimisht duke u përmirësuar. Kurse, ndryshe ishte puna me të majtin. Ai, jo vetëm që s'jepte asnjë shpresë shpë-

timi, po, me gjëndjen e tij të acaruar, ish duke u bërë një rrezik kërcënues edhe për tjetrin.

— Duhet vepruar pa humbje kohe! — tha më në fund doktor Sinah Imeri. Ai kish arritur në këtë përfundim, pas një studimi të gjatë të çështjes. Kështu, në këto kushte, vendosi të bënte një ndërhyrje kirurgjikale në të majtin. Pastrimi i perdes do ta qetësonte disi atë sy të acaruar. Dhe ja, një ditë vjeshte, operacioni filloi. Të gjithë ishin në ankth për përfundimin. Dora e shkathët e mjekut kish filluar të vepronte. Por në çastet kur perdja ish në të pastruar e sipër, doktor Sinah Imeri u zverdh si limoni. Brëndësia e syrit të majtë të pacientit ishte qelbëzuar. E, ajo gjendje, tronditi edhe personelin sanitar që e rrethonte.

— Ndërhyrja kirurgjikale duhet ndërprerë! — mendoj mjeku. Dhe shpejt e shpejt i dha fund punës së nisur. Gjergj Martini u çua në dhomë. Po mjeku nuk ishte i qetë. Çështja që i kish dalë përpara, kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Zgjidhje pa asnjë vonesë. Syri i majtë i pacientit ish shndrruar ç'prej ditësh në një rrezik serioz për të djathtin. Pra, ajo që ai dyshonte për më vonë, tanimë ish fakt i kryer.

Dhe doktori, i vetëm e i shqetësuar, vinte rrotull nëpër sallë. Sa mendime përbluante në ato çaste të vështira!

— A do të mund ta kuptojë Gjergji këtë rrezik? A do të pranojë ai t'ja heqim synë e majtë? Po sikur të kundërshtojë? Po sikur... sikur...?

Dhe, me këto mendime në kokë, doktor Sinah Imeri, i shkoi pranë pacientit të tij.

— Do të të flas hapët — i tha — Ashtu si flasin komunistët, Gjergj. Ashtu siç flasin ushtarët, që falin edhe jetën për shoqi shoqin.

Po, për një çast, s'mundi ta vazhdonte fjalën. I zbetë, ndjeu se pështyma ju tha në gurmaz.

— Flitni! — tha Gjergj Martini, i mbetur në ankth.

Doktori e shikoi drejt. Pastaj:

— Syri yt i majtë... — tha — Ti më kupton, besoj, Gjergj...



Pacienti psherëtiu.

— E kuptova, që kur e mbyllët aq shpejt interventin!  
— tha me dënesë.

Kaq. Pastaj, një rrufe ju duk sikur shpërtheu nër këmbët e tij.

Pra, kjo është gjendja, Gjergj! — tha mjeku me zë të shuar — Ai rrezikon që të verbohet edhe tjetri. Duhet hequr! Dhe unë pres fjalën tënde...

Gjergj Martini, i pezmatuar, s'ktheu përgjigje.

Mjeku priti.

Heshtje. Heshtje që fliste. Dhe zërin e saj e ndjeu edhe njeriu që po humbte dritën e plotë të njerit prej syve.

— Doktor! — tha më në fund — Përse kërkoni fjalën time? Juve ju takon të thoni fjalën e shkencës...

Doktor Sinah Imeri mori frymë thellë. Të zbehtit filloi t'i kthehej në një ngjyrë të çiltër, të trëndafiltë.

Të nesërmen, po në atë sallë operacioni, Gjergj Martini la përgjithmonë syrin e tij të majtë. E me të, edhe rrezikun që i kërcënonte verbimin e të djathtit. Kjo ngjau më 25 të vjeshtës së dytë. Dhe doli ajo vjeshtë. Dhe e treta hyri. E ndërsa pemët e kopshtit të spitalit po zhvisheshin pak nga pak, syri i vetëm i Gjergj Martinit për ditë e më shumë po vishej me dritë. Dhe ai, tani, nga dritaret e asaj ndërtese, jo vetëm që ndjente erën që frynte me poterë, por në mënyrë disi të mjegulltë, shihte edhe ato trungje të degëzuara e madhështore, që lëkundeshin e xhvisheshin dalëngadalë. Syri i tij i vetëm kishte arritur të ngrihej në afro dy të tretat e pamjes së tij të dikurshme.

I dukej sikur jeta zemërgjerë sërish po i jepte krahë. Krahë për t'u hedhur edhe një herë në fluturim të hapët. Drejt jetës, drejt shoqërisë, drejt majave...

## P A D R I T Ë N E S Y V E

Dalja e Gjergj Martinit bëri bujë në atë qytet provincial. Pastaj jehona u fashit, po njerëzit s'e kishin kaluar në harresë atë ngjarjen e 23 gushtit të vitit 1966, sado që, pak nga pak, ishin endur dy vjet qysh atëhere. Po as ai s'i ishte shkëputur jetës asnjëherë. Me zemër, sërish kish mbetur një agjikator i flaktë. Në mbledhjet e lagjes ishte nga të parët që ngrihej. Diskutonte e dëgjonte me seriozitet. Sado në kushte tepër të vështira, për të lexuar vetë, dhe sado që porosia e mjekut ish kategorike për të mos ta munduar syrin që i kish mbetur ai prapseprap problemet që ngrinte shtypin i ndiqte hap për hap.

— Martë!

— Erdha, Gjergj — dhe, me ngut, pasi niste Dritanin e vogël për në shkollë, gruaja rrëmbente «Zërin e popullit», e shpejtonte drejt tij. Ai ishte racioni i mëngjezit. Dhe ajo, tanimë, e dinte këtë detyrë që e priste.

— Në s'ke kohë, më lexo vetëm titujt shpejt e shpejt.

Ajo ja lexonte.

— Po kryeartikulli, shkurt, a mund të ma thuash përse flet?

Gruaja shikonte orën. Koha s'priste. Orari zyrtar po afronte. Po, megjithatë, i vinte zor t'i thoshte të vërtetën.

Ajo e dinte me sa kujdes për vite me radhë ai e kish ndjekur shtypin duke ua komentuar artikujt kryesorë edhe ushtarëve në repart. Po tani s'mund të lexonte. Syri që i kish mbetur kapte vetëm dy të tretat e pamjes së të



tij të mëparshme. Dhe kjo ishte e pamjaftueshme. Tani dhe fytyrat e njerëzve, nuk i shquante në mënyrë të plotë. Pra, ai, shihte dhe s'shihte...

Dhe gruaja e dinte këtë. Ndaj, i vinte zor t'i thoshte: «Jo!» apo t'ja linte për më vonë.

Rrëmbimthi, sytë e saj notonin mbi titujt e po ashtu mbi atë masiv gërmash të kryeartikullit apo komentit politik.

E pastaj, me dy fjalë, ja dhe përmbajtja.

Ai, i heshtur, e dëgjonte.

— Falemnderit! — i thosh më në fund — Po mos të vonova?

Ajo shikonte orën dhe i buzëqeshte. Po prapë orën e saktë nuk ja tregonte.

«Pse ta dëshpëroj? Do të shpejtoj e disi do të arrij në orar!» mendonte. Dhe heshte.

Por ai prapë e pyeste:

— S'mu përgjegje. Sa është ora?

— Tamam koha për nisje, Gjergj! — Dhe e përqafonte.

\* \* \*

Vetmia e mërziste. Ndaj shpesh herë, posa dilte e shoqja, dilte edhe ai vetë. Ecte anës rrugëve. Si gjithnjë, ngadalë. Me hap shëtitor. Po njerëzit që tashmë e njihnin, i hapnin udhë e, kur u kalonte pranë, përkulnin kryet dhe e përshëndesnin me respekt. Ai çelej në fytyrë dhe ëmbël ua kthente përshëndetjen. Por dhe kur s'ua kthente, askush s'ja merrte për ters. E, po kështu, në udhëtimet urbane, gjithkush mendohej t'i bënte nder.

— Urdhëroni, shoku Gjergj!

Ai prap çelej. Buzëqeshte e i falenderonte. Po për t'ua ulur, nuk ulej.

— Ushtari duhet të jetë gjithnjë më këmbë — mendonte.

Po njerëzit prapë e lusnin të ulej.

— Urdhëroni! Urdhëroni, shoku Gjergj!

Ata e donin dhe e nderonin që të gjithë. Madje edhe shkollarët e fëmijët. Kështu shpesh, ata i kujtonin njeri tjetrit gjithësa kishin dëgjuar rreth këtij njeriu të fortë, që ç'prej disa kohësh kalonte i heshtur e i pandjerë nëpër udhët e atij qyteti provincial.

— Ai?

Dhe gjithkush mendohej ta përfytyronte ashtu siç e kish parë dikur. Sa prej tyre, me kapotën e murme mbi trup, e patën thirrur: komandant! Sa prej tyre, me urdhër të tij, qenë derdhur në fushat e stërvitjes si në fushat e vërteta të betejës! Sa prej tyre, me urdhër të tij, patën minuar e çminuar hapësira të tëra, duke u matur me vdekjen! Sa prej tyre i pat qortuar me dashamirësi! E sa e sa nga ata i pat lavdëruar para kolektivit të tyre ushtarak!

Dhe ja, secili, kur binte fjala për të, i kujtonte ato ngjarje, ata raste, ato ditë... E, duke i kujtuar, gjithkuj i vinte e i mbehej në sy, ashtu siç e kish dëgjuar, ajo skena e 23 gushtit të vitit 1966.

Po midis tyre, ai që i kish mbetur më pranë, ai që s'e harronte e s'i ndahej kurrë në orët e lira, ishte Gjetë Sokoli.

— Askush nuk mund të flasë për Gjergj Martinin sa unë... Askush nuk mund të thotë se e njeh Gjergj Martinin si unë! — thoshte ai.



## M A L E E N J E R Ë Z S I M A L E T

Një zhurmë u dëgjua në rrugë, pastaj porta u çel e një hap i rëndë përshkoi oborrin.

— Gjeta! — tha Gjergj Martini dhe u çua.

Tjetri ngjiti shkallët, e, me të dalë në korridor, thirri:

— A je, Gjergj Martini?

— Eja, eja! — tha Gjergji buzagaz, duke i dalë përpara.

— Sa mirë që erdhe! — u ndje edhe zëri i Martës, që nga guzhina — Po ç'u bëre dje e pardje, që s'u duke? Gjergji edhe sot të ka kujtuar disa herë.

Ai ju përgjegj gruas, pastaj të dy shokët u ulën në divan dhe biseda mori shtruar rreth çështjeve të ditës.

Por më vonë Marta ua preu në mes atë bisedë.

— Gjetë! — i tha duke dalë nga guzhina — Po me Katrinën si mbeti puna?

Ai u ngrit e i dha dorën, pa i kthyer përgjigje.

— Vërtet, Gjetë — tha edhe Gjergji, duke e kapur fillin e asaj pyetjeje — Si mbeti puna me të?

— Si mirë duket — tha ai i qeshur — si mirë... Megjithatë, të shohim kur të kthehet. Ju e dini, ajo ka kohë që ndodhet në Kelmend.

— Mua s'më pëlqen kjo zgjatje — tha Marta — dhe faji s'është i Katrinës, po i yti. Ti po e zvarrit këtë çështje.

— Po, po. yti — tha edhe Gjergji.

— Kurse ne ç'prej kohe presim të na gëzosh! — tha ajo — Po kur dreqit ke vendosur t'ja bësh fora? Ç'burrrë je ti që s'guxon t'i propozosh një vajze?

Ai qeshi.

— Kësaj here, Martë, të premtoj: S'do të më mungojë guximi.

— Kësaj here? Kur kësaj here?! — tha ajo.

— E lashë për në fund — tha ai i gëzuar. Po sot, edhe unë për atje po nisem. Erdha vetëm sa t'ju tregoj e të përshëndetem.

— Për në Kelmend? — tha Gjergji i stepur.

— Po — tha tjetri — Rruga e Malësisë së Madhe që mendohej të përfundonte më 29 Nëntor, u vendos të inaugurohet më 16 të muajit të ardhshëm. Pra, më 16 Tetor, Gjergj. Në këtë betejë të fundit, me urdhër të komandës së njësisë, po nisem tani edhe nënreparti ynë. Bile, edhe vetë komandanti i njësisë. Po dhe shkuarja e dritave atje, s'është e largët. Aksioni po vazhdon me një ritëm çuditërisht të shpejtë.

— Gjetë! — tha ai me emocion të thellë — S'di, pse më duket si ëndërr këto që po më flet? S'di pse akoma s'më besohet që Kelmendi ynë do të bëhet së shpejti me rrugë automobilistike e me dritë!

— Në fillim, kështu na janë dukur që të gjitha, Gjergj. Po pastaj, një nga një, të tëra janë bërë.

Gjergj Martini u përlot.

— Mos... — tha Gjeta.

— Më vjen keq, që në këtë gëzim nuk do të mundem të marr pjesë edhe unë... e aq më keq, që s'do të mund të jem përkrah jush!

Tjetri u vra në shpirt. Gjergj Martini i kishte humbur sytë për të. Po të mos kish ngjarë ajo që ngjau afro dy vjet më parë, ai do të ishte tani në krye të atij reparti ushtarak. Në krye të atyre njerëzve, që po nisehin, për të marrë pjesë në mbylljen e këtij aksioni kaq të madh të rinisë e të ushtrisë bashkërisht.

Dhe, duke kujtuar të gjitha këto me radhë, Gjetë Sokoli u drodh.



— Gjergj! — tha — Unë...Unë t'i mbylla të gjitha shtigjet e jetës. Dhe kjo më mundon e më vret çdo ditë e më fort.

Gjergj Martini u pre në fytyrë. Ai tani porsa e kish kuptuar se, padashur, e kish lënduar keq Gjetë Sokolin.

«Si dreqit shkava ashtu» — mendoi me tronditje.

Pastaj:

— Më fal! — i tha —, në u shpreha ters. Po s'e pata me të keq. Ti e di... Unë s'kam shok më të afërt se ty...

Pastaj, një borie makine, me disa kolpo të përsëritura, u dëgjua në rrugë.

— Dërguan të më marrin — tha Gjeta — Tani vetëm mua më presin për nisje. Veç më vjen keq që po të ndahem në këtë mënyrë, Gjergj!

— Udhë të mbarë — tha tjetri i përmbajtur — Veç mos harro të më shkruash nga Vermoshi ynë...

— Pa tjetër... Pa tjetër — dhe, duke i hedhur duart, e përqafoi.

Pastaj, Marta e përcolli gjer jashtë Gjetë Sokolin.

Ai u përshëndet me gruan, dhe, menjëherë, hyri në «gaz». Në çast, një zhurmë makine që largohej, u dëgjua.

\* \* \*

«Gazi» printe. Autokolona e skodave, e ngarkuar me ushtarë, vinte pas. Në makinën që printe, përkrah shoferit, qëndronte komandanti i ri i njësisë, që vuante nga zemra, po megjithatë, ashtu sikurse edhe komisari, i kish qëndruar mbi krye këtij aksioni të madh. Ai i njihte për fytyrë e për emër, jo vetëm udhëheqësat e sektorëve të kësaj rruge 75 kilometra të gjatë, po shpesh edhe ushtarët e vullnetarët e rinisë në këta sektorë. Mbas tij, në sedilen mbrapa, ishin ulur Gjetë Sokoli dhe një nga mjekët e rinj të repartit 8001, që e bënte për herë të parë këtë rrugë. Komandanti, si një nga komandantët e komisarët e luftës, dhe bir i krahinave të atij rrethi, kish kënaqësi t'u tregonte të tjerëve rreth punës së kryer, rreth

heroizmit të ushtarëve e vullnetarëve të rinisë, si dhe rreth jetës dhe punës së banorëve të këtyre maleve, që shpesh në qëndrimin, mikpritjen dhe burrërinë e tyre, i shëmbëllenin me leberit dhe malësorët e tjerë të vendit tonë.

— Ja, kjo është maja e Leqeve të Hotit — tha ai, me të dalë mbi majë. — Ky qe edhe sektori më i vështirë në gjithë këtë front punimesh. Të duket si e pamundur, po në këtë humnerë kalon traseja për në Vermosh.

— Fantastike! — tha mjeku, duke afruar fytyrën drejt xhamit të makinës — A do kish mundësi të ndaleshim e ta kundronim më për së qeti këtë pamje sa të bukur aq edhe të egër?

— Po — tha komandanti, që shquhej për edukatën dhe sjelljen e tij të kulturuar.

Shoferi ndaloi makinën. Zbritën.

— Duke ecur — tha komandanti — do të na zbulohen pamje të tjera të kësaj gryke edhe më të mahnitshme. Pastaj makina u nis.

— Këtu, punimet e vërteta, kanë marrë fund që vjet — tha komandanti — Megjithatë, një pjesë e vogël e minatorëve tanë akoma qëndrojnë peng në këto leqe

— Përse? — pyeti mjeku me kurcshtje.

— Në disa brryle shkëmbore, zgjerimi i rrugës nuk është bërë i plotë. Kur të kalojmë, do t'i shihni së afërmi. Mjeku s'foli.

— Tani hidhni vështrimin matanë! — tha komandanti — I shikoni ata që punojnë në fund të këtij honi?

I heshtur, doktori vështroi andej. Po, për çudi, ai grumbull njerëzish ju dukën si ndonjë trumbë fëmijësh parashkollorë.

— Tani besoj e kuptoni se çfarë thëllësie ka ky hon! — tha komandanti. — Njerëzit që këtej të duken tamam si mizat e dheut.

Mjeku prap s'ktheu përgjigje. Vështrimi i tij akoma qëndronte i ngulitur mbi atë grup minatorësh, që ngjnin si fëmijë kopështesh. Gjeta, fjalët e fundit s'i dëgjoji fare. Ai kish tretur në disa kujtime të hershme të fëmijësisë së tij. Ja, andej kishin kaluar për herë të parë me Nikën,



Gjergjin e Martën. Nika u tregonte, e ata dëgjonin! E pastaj, edhe ajo ngjarja, kur Marta Prendi, duke këputur një lule buzë humnerës, kish mbetur e varur mbi hon.... Skenë e llahtarshme! Pastaj Gjergji ish derdhur dhe ja kish rrëmbyer vdekjes Marta Prendin. Po, tamam ashtu, siç ja kish rrëmbyer nga duart një ditë edhe Gjetë Sokolin... Dhe, pa e kuptuar, ju duk sikur edhe një herë e pa veten në thellësitë e atij tuneli të errët e pastaj, Gjergj Martinin, duke vrapuar e duke i thirrur: «Gjetë! Gjetë! Po përgjigjmu, more shok! Përgjigjmu!» —

Ndërkohë, makina prirej tatëpjetë. Leqet dukeshin si ndonjë spirale gjigante. Në fund të tyre, i kthjellët e i kaltër, rridhte Cemi.

— S'ka si bëhet lum më i bukur! — tha komandanti.

— Fantastik! — tha doktori — Ç'pamje e çuditshme! Të them të drejtën, natyrë të tillë s'kisha parë kurrë ndonjëherë...

Tani «gazi» kishte zbritur në Grabon, buzë lumit Cem, kurse autokolona e kamionëve akoma vazhdonte tatëpjetën gjithë dredha të Leqeve të Hotit.

— Vërtet si një spirale gjigante — tha doktori.

— Po — tha Gjeta, që posa e kishte mbledhur veten — Po t'ju them ashtu si e ndjej, s'di pse më duket sikur në këto anë kam lënë një pjesë të mirë të zemrës sime!

— Ke të drejtë — tha komandanti — Ti je kelmen-das dhe këtej e ke kaluar një pjesë të kohës së fëminisë, Gjetë.

— Dhe, si ditët e fëminisë, s'ka! — shtoi doktori — Ato, padyshim, janë dhe mbeten më të bukurat në jetën e njeriut.

— Doni ujë? — tha komandanti — Ujë Broje, megjithëse këtu ujërat ngado janë të ftohta. Ujëra bore.

— Pimë në Tamarë — tha Gjeta.

— Ç'është Tamara? — pyeti doktori.

— Fshat, po dhe qendra e lokalitetit.

— Atje mund të marrim edhe nga ndonjë kafe — tha komandanti.

— Mirë, Ahere më mirë atje....

— Atje, atje...

Shoferi ja shkeli makinës. Rruga ecte buzë Cemit. Mbas dyzet minutash, arritën dhe «gazi» u ndal tek she-shi para dyqaneve. Një mori malësorësh, me armë, ishin grumbulluar para lokalitetit. Një burrë i shkuar i binte çiftelisë dhe këndonte. Të tjerët i qëndronin rrotull dhe dëgjonin.

«Ded Gjo' Luli ka shkruar letër

Pashës Shkodrës ja ka çue.

Se shqypnia nuk don tjetër,

Veç don vedin me sundue».

— Përse janë mbledhur? — pyeti doktori një nga punonjësit e lokalitetit, që u afrua e iu dha dorën.

— Kanë dëgjuar për pushtimin e Çekoslovakisë — tha tjetri — si dhe për daljen tonë nga Traktati i Varshavës. Këtu flitet se ata i kanë kthyer sytë edhe nga Shqipëria, Jugosllavia e Rumania. Në këto vise njerëzit qëndrojnë me pushkë në duar, në mbrojtje të lirisë së fituar me aq gjak e sakrifica.

— Dhe për këtë kanë ardhur? — pyeti mjeku i ste-pur habie.

— Po — tha nëpunësi.

— Po kush i thirri? Kush i lajmëroi që të vinin?

— Askush. Dëgjuan dhe erdhën vetë. Siç e shih-ni, të gjithë janë të armatosur. Është zakoni i këtyre maleve: kur vendi është në rrezik, burrat që të gjithë në çdo moshë qofshin, rrokin armët e zënë vendin që u takon. Bile gra edhe burra.

Mjeku, një djalosh i ri, qytetar nga Shqipëria e mesme, tundi kryet i mrekulluar habie. Pastaj:

— Popull ushtar! — tha me miratim.

Po kënga vazhdonte:

«Se Shqypnia nuk don tjetër

Veç don vedin me sundue».

— Melodia e kësaj kënge gjithnjë më ka pëlqyer. Sidomos fjalët e saj... Po sot, s'di pse këta tinguj e këto fjalë po më ngjan sikur marrin një përmbajtje të re e një kuptim edhe më të thellë — tha doktori i menduar.

— Vërtet ashtu — ja bëri komandanti.



Gjeta s'foli, po mëndja i shkoi te Gjergj Martini, që e pëlqente dhe e këndonte atë shpesh atë këngë.

...Pastaj Tamara mbeti pas. E pas edhe Selca e Lëpusha. Autokolona, pak nga pak, shkeli në periferi të Vermoshit. Po, megjithatë, rruga akoma s'kishte arritur gjer në qendër të fshatit.

— Siç e shihni, nuk do të jetë e largët dita, kur këto makina do të arrijnë edhe në qendër — ja bëri komandanti. Dhe, duke zbritur i pari, prap tha:

— Ja, Gjetë! Këtu do të punojë reparti.

Në këto fjalë e sipër, zhurma e disa hapave të rrëmbyer u dëgjua në thellësi e, pastaj edhe një uturimë bubullonjëse mbi Vermosh. Mbi katund kishin filluar të grumbulloheshin re të murme.

— I shikoni? — tha befas komandanti. — Ata që po vrapojnë janë minatorët.

— Po përse vrapojnë ashtu? — tha doktori.

— Shkojnë t'u vënë zjarrin minave. Këtu çdo lëvizje bëhet me shpejtësinë e erës. Koha është thesar. Çdo minutë e fituar, do të thotë shumë për ne.

— Kini të drejtë — tha mjeku dhe me sy u mundua t'i ndiqte prej së largu ata djem të rinj me uniformë ushtari.

Bubullima edhe një herë u përsërit.

— I pari — vazhdoi komandanti — është ushtar i vitit të dytë. Tani profesionin e minatorit e zotëron më së miri. Po dhe dy të tjerët që vijnë pas tij, sado ushtarë të vitit të parë, nuk janë më të pakët se ai. Kurse i katërti...

Fjala ju pre.

— Jepni sinjalin! — u dëgjua zëri i fuqishëm i komandantit të sektorit.

— Kujdes! Kujdes! Minat! — thirri një tjetër që matanë.

Pas kësaj thirrjeje, një mori të rinjsh e të rejash, zboristësh e ushtarësh, shpejtuan drejt vendeve të tyre të mbrojtjes. Komandanti i njësisë, mjeku dhe Gjeta i ndoqën me sy njerëzit që po rendnin. Pas pak, buçima e minave filloi. Gjer tek e katërta, ato shpërthyen varg

njëra pas tjetrës. Pastaj, një farë heshtjeje e zgjatur mbuloi rrafshnaltën.

— Po kjo e pesta, pse s'po plas? — tha mjeku, me një farë ankthi në zemër.

Këtë pyetje tani po i bënte vetes edhe minatori i parë. Sytë e tij, të vrenjtur e të zes, kishin marrë një pamje të rëndë. Po kjo gjëndje shpirtërore vërehej edhe në sytë e minatorëve të tjerë. Pas pak, mina e pestë shpërtheu. Shpërthim gjysëm i heshtur.

— Duket s'bëri efekt — i tha doktori komandantit.

— Përkundrazi — tha tjetri —. Sa më e pakët të jetë krisma, aq më i madh është efekti.

Mjeku e shikoi me habi, po për të folur nuk foli.

Mbas pak sekondash, nga maja e rrafshnaltës, qindra capsa shkëmbi fluturuan në hapësirë dhe, të përziera me uturimën e shkrepëtimat e qiellit u rrukullisën me gjëmim në tatëpjetën që mbaronte në shtratinq e lumit Cem.

— A e patë?

— Po, kishit hak — tha mjeku.

Ndërkohë, shiu ia dha me gjym. Shi vere.

— Këtu bie shpesh — tha dikush — Po nuk zgjat.

Pastaj, një thirrje e fortë buçiti:

— Shokë! Lini punën gjer të mbarojë shiu!

— Përgjegjësi i sektorit — tha një vajzë.

Po brigadat e ndryshme të rinisë, si dhe ato të ushtarëve, akoma qëndronin të pashkulura nga postet e tyre të punës.

— Ja! Vështroni me çfarë shpirt sakrifice e vetmohimi punojnë këta njerëz këtu! — tha komandanti i njësisë. Tani dora e tij ishte shtrirë drejt një të riu, që po luftonte me një shkëmb të madh, pjesërisht të ndarë më dysh nga shpërthimi i minave që posa kishin plasur. Po dhe të tjerët me shkëmbenjtë po merreshin.

Mjeku u zbeh në fytyrë.

— Do të bjerë — tha.

— Jo — ja bëri komandanti i qetë — Nuk bie. Me sa kam vënë re, këtu njerëzit, zakonisht, janë të for-



të si shkëmbi. Ata u përngjajnë maleve. Unë shpesh them duke i parë: male e njerëz si malet!

— Vërtet, male e njerëz si malet! — tha dhe mjeku duke e ndjekur djaloshin me sy prej së largu.

Po tani edhe një vajzë që posht po rendëte drejt tij duke i thirrur «Kujdes! Kujdes!»

— Katrina! — tha Gjeta dhe tërë gaz bëri tutje pa u thënë gjë komandantit dhe mjekut.

— Ajo — tha dhe vullnetari, po kokën nuk e ktheu drejt saj. Mbi shkëmbin e ndarë pjesërisht, duke u përpjekur me qysqinë ndër duar, ai po hepohej sa në të majtë, në të djathtë. Masivi shkëmbor rrezistonte për tmerr. E veç kësaj, ai shkëmb ndodhej në një pozicion të keq e në një faqe krejt thikë.

«Po të shkëputet, me siguri, do ta marrë me vete edhe atë», — mendoi vajza e shqetësuar nga ajo skenë. Dhe duke u ngjitur, sërish i thirri të kish kujdes.

Ai i buzëqeshi këtë herë, sikur desh ta siguronte se rreziku kish kaluar.

Dhe vërtet tani, shkëmbi ish çarë më dysh. Masivi shkëmbor i zhbirë nga themeli kish filluar ta humbte ekulibrin e tij të mëparshëm. Pastaj, një pas një, dy blloqe të gurtë muarën të tatëpjetën drejt honit e Cemit.

— Pa shih, pa shih! — tha mjeku që gjer në ato çaste kish qëndruar si i mpirë.

— Ju thashë — tha komandanti. Këtu njerëzit janë të fortë si shkëmbenjtë.

Blloqet, si dy përbindsha, të plagosur rëndë, duke lëshuar një uturimë shqetësuese, akoma rrokulliseshin në për humnerë.

Vajza që tanimë i ish afruar djaloshit, mori frymë thellë.

— Po ç'bëre ashtu? — i tha me qortim. — Ç'bëre?

Ai i lumtur iu hodh në qafë dhe e puthi.

Që poshtë trasesë Gjetë Sokoli shtangu. Sado prej së largu, ai e pa qartë atë skenë.

«Po si është e mundur? — tha me vete — Ç'e lidh atë me këtë njeri?» Dhe ashtu i stepur habie, dikë pyeti nga të rinjtë që po punonin gjatë trasesë.

— Katrina me të fejuarin e vet — u përgjegj tjetri i qetë. — Thonë, dikur ish në fjalë me një ushtarak, po ai për dy vjet me rradhë qënkësh treguar qull e çfarë qulli! Dhe ajo e la. . . Epo kështu e ka jeta, shok. Po fjetë të ikën zogu nga duart. Kështu i ndodhi dhe atij. Duket do të ketë qënë i trashë derdimeni! — dhe pa ditur se me kë kish të bënte vuri buzën në gaz e tundi kryet sikur të desh ta përforconte edhe njëherë atë mendim të porsa shfaqur.

Gjetë Sokoli, i prerë në fytyrë, s'foli. Atij iu bë sikur toka u tund nga themelet e pastaj një humnerë u hap dhe e përpiu atë faqe mali.

— Ç'patët? — tha vullnetari, duke vënë rë tronditjen e tij të thellë.

— Jo jo, kot — tha oficeri, duke u munduar ta mban-te veten. Pastaj mëndja i shkoi te Marta e Gjergji. Atyre u kish thënë se puna këtë herë do të kryhej patjetër. Kur-se tani?

I hutuar psherëtiu.

— Ju thashë, — tha rishtaz vullnetari që s'po dinte nga ta riniste bisedën — do të ketë qënë i trashë derdimeni.

— Derdimeni? — tha Gjeta me zëmërim ndaj vetes. — Bufi, shok, bufi thua më mirë! — dhe ashtu, i bërë tym, duke dashur që ajo të mos e shikonte, u largua nëpër shiun që tanimë ish rralluar e kish filluar të pushonte. Në këto çaste edhe reja kish nisur ta kapërcente kufirin e vëndit tonë. Buzë tij, një lapidar ngrihej hijerëndë. Gjetë Sokoli e pa atë lapidar në formë piramide.

— Nika! — tha dhe disi u lehtësua. Guri i mërtë ndrinte nga pikat e shiut që e kishin lënë dhe rrezet e diellit që i binin tufë pjesës së përparme të lapidarit. Po tani nga ai shi vere edhe rrafshnalta kish marrë një shkëlqim të veçantë. Bile dhe ajri dukej sikur ish bërë më i lehtë. Vermoshi me Cemin e kaltër e gurgullonjës që i kalonte përmes, dukej si ndonië pikturë.

— Po Gjeta ç'na u bë? — tha befas me habi doktori.

— Ja — tha komandanti që s'e kish ndarë nga sytë



dhe shtriu dorën andej. — Tani edhe ai me repartin duhet të njihet me frontin e punës. Pastaj:

— Gjetë! Gjetë! — i thirri.

Gjetë Sokolin e drodhi ajo thirrje dhe në çast duke mbledhur veten, bëri përpara drejt njeriut që e kish thirrur.

— Po ç'u bëtë? — tha mjeku me kurrështje.

— Dikë desha të takoja. — tha Gjeta me gjysëm zëri.

Komandanti buzëqeshi. Ai diç kish dëgjuar për lidhjet e Katrinës me të.

— Gjetë! — i tha pastaj. — Ky është fronti. Vëndin ekzakt do të ta caktojë komandanti i sektorit. Takohu menjëherë me të.

Mbas pak, reparti i komanduar nga oficer Gjetë Sokoli, filloi punën përkrah vullnetarëve të brigadës «Manush Alimani» të Shkodrës. Në mbarim të turnit, komandanti i njësisë, mjeku dhe Gjeta shkuan dhe vendosën nga një tufëz lulesh mbi lapidarin e heroit të popullit, Nikë Pjetër Deda.

— E njihnit? — i tha mjeku.

— E kam pasur shokun më të ngushtë — tha Gjeta.

Tjetri, i prekur, vuri re sytë e përlotur të oficerit, dhe s'foli.

— Njerëz të tillë, s'vdesin kurrë — tha komandanti. — Ky lapidar, që i përngjet një piramide do të flasë edhe në botën e komunizmit, kur do të jenë zhdukur piramidat që ndajnë popujt e shtetet! — dhe heshti.

Mjeku e Gjeta nuk folën për një çast. Pastaj, një këngë burrash u dëgjua nga fronti i brigadave:

*Buzëtë te kënga,  
Ballin te liria,  
Lule Selam Labi,  
Selam Salaria.*

*Çdo tufan zbërthyer  
Gjoksin ty ta gjeti,  
Sharku si legjendë  
Përmbi tel të mbeti.*

*Duart i ke zënë,  
Ç'ke ashtu në duar?!  
Gryk' e nxeht' e topit  
T'i ka përvëluar.*

— Është grupi i ushtarëve lebër — tha Gjeta.

— Vargje fort të bukur — ja bëri mjeku, duke u munduar t'i shquante një për një ato fjalë.

— Vërtet të bukur e të fuqishëm — tha edhe komandanti.

Po grupi akoma vazhdonte me grykë:

*Ja kështu në bronx  
Ty të ka liria,  
Lule Selam Labi,  
Setam Salaria.*

— Dhe ashtu si dhe ata që ranë si ai, do të mbeten nër shekuj! — tha doktori.

— Po — tha komandanti — Ata që ranë u përkasin të gjitha kohëve dhe të gjitha gjeneratave.

Gjeta s'foli, po në atë heshtje, për një çast ju bë sikur plaku Selam Musa Salaria dhe pioneri Nikë Pjetër Deda, buzë atyre piramidave, si gjysh e nip, krenarë qëndronin krah për krah njëri tjetrit.



## T Ë F A L E M N D E R I T S H O K !

Ditë me ngjarje të mëdha. Një vit më vonë pas Letrës së hapur, fjala e shokut Enver, e mbajtur më 6 shkurt, i dha hov revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës në vend. Kuvendi i madh: Popull — Enver Hoxhë, vazhdonte papushim. Malet, e në veçanti malet e Veriut, të mjegulluar nga errësira e kryqeve, kanunit e bajraqeve, kishin filluar të hapnin sytë. Në Shkodër, Komiteti i partisë së rrethit, duke i qëndruar në krye kësaj beteje, s'prehej as ditë as natë. Komunistët qëndronin në pararojë. Në shembullin e tyre, edhe të rinjtë e të rejat ishin ngritur peshë. Flaka e revolucionit po i digjte njerën pas tjetrës fejesat në djep, sidhe aktet e shitblerjeve të vajzave dhe grave me të holla, kishat e xhamitë, veladonët, çallmat, kamillafet.

— Martë! — i tha Gjergj Martini së shoqes — Edhe gjashtëdhjetë vjeçarët, po u derdhen për t'i shkallmuar nga themelet! A s'të duket i çuditshëm ky duf i tyre, për moshën që kanë?

— Aspak, Gjergj. Kjo tregon edhe një herë, se sa fort u ka dalë boja këtyre njerëzve e këtyre tempujve. Dhe mos harro: Ishte një njeri me veladon, ai që vrau tët atë nën hijen e atyre kryqeve e atyre kambanoreve.

Ai psherëtiu.

— Ke të drejtë — tha — E mbaj mend edhe unë: ai që e vrau ishte një njeri me veladon....

Dhe ashtu, rrjedha e ngjarjeve vazhdoi. Për ditë e

më shumë, veshi dëgjonte akte patriotizmi, të padëgjua ndonjëherë. Një vajzë nga Pecaj kishte ngritur më këmbë tërë Shqipërinë; një baba kish shkuar të zëvendëson-te të birin, që i kish mbetur në krye të detyrës, para krye-rjes së plotë të shërbimit ushtarak, ndërsa një i ri, pa dri-tën e syve, thuhej se ish nisur për në vendin ku Shkurte Pal Vata kish rënë për të mbetur për jetë midis njerëzve të vendit të saj.

Pra, ish tamam ajo kohë... ishin tamam ato ditë të ngjeshura me ngjarje e heroizma, aksione e goditje, të papara ndonjëherë.

Po, ndër të gjitha këto, ajo që e kish zgjuar nga litargjia oficerin në pension, ishte ngjarja e atij të riut pa sy nga Boriza, Bato Hekurani. Dhe ja, në ato ditë, edhe ajo letra e tij drejtuar shokut Enver... E pastaj, përshëndetja dhe përgjigja e udhëheqësit.

— Si? Ai pa asnjë fije drite dhe mundet të fluturojë kaq lart? Po si është e mundur?

Pastaj, i heshtur, ai priste të shoqen, të kthehej nga puna.

— Martë! Më lexo, ç'shkruan shtypi sot për të?

Dhe gruaja, duke ju ulur pranë, i lexonte artikujt e letrat që flitnin rreth të riut nga Boriza. Dhe jo vetëm artikuj dhe letra, po edhe vjersha e poema, që i këndonin shpesh këtij akti patriotik të tij.

— Martë! — i tha një ditë — Ku bije Boriza?

— Në Jugë tha ajo e sigurtë.

— E di që në Jugë — tha ai i qetë. — Po në ç'vis të Jugut? Dua ta di sakt pozicionin. Të lutem, po munde, shikoje në hartë! — dhe heshti.

Gruaja shpalosi hartën dhe kërkoi. Pastaj:

— Në malet e Labërisë, Gjergj — i tha — Bile në një nga majat e tyre.

Ai psherëtiu.

— Po — tha i menduar. — Tani e kuptoj. Malet gjithnjë rritin shqiponja. Ata banojnë majave. Martë! Edhe par-tizanët majat kishin zgjedhur. Ndofta ky ish edhe sekreti,



që ata, edhe në netët më të errëta, dinin të fluturonin aq lart! Të thashë; ndofta ky ish edhe sekreti...

Ajo ngriu nga ato fjalë.

«Vuan shpirtërisht » tha me vete, e lënduar keq, po për të folur, s'foli. As ai s'e pyeti më gjatë. Pastaj, muzgu ra dalëngadalë mbi qytet. Dritani i vogël, i lodhur nga lodrat e ditës, fjeti herët.

— A po afrohe të hamë? — i tha ajo, duke e fshehur brengën, që kishte në shpirt.

—Po.

— U shtruan. Ajo hëngri pak, kurse ai, vetëm sa e nisi pjatën.

— Ç'ke? — tha e shoqja, mbas një pritjeje të gjatë — Përse nuk po sos?

— Nuk e di... Po nuk më kapërcehet, Martë!

— A do të të pregatis diçka tjetër? Vezë, djathë, turshi...

— Jo, Nuk më hahet.

E shqetësuar, ajo e hoqi pjatën.

Pastaj, të heshtur, shkuan në dhomën e gjumit. Ranë.

Po Gjergj Martini nuk fjeti atë natë. Në atë errësi, ai kishte parë gjithshka, që s'kish mundur ta shihte për dy vjet e kusur me radhë.

— Martë! — i tha së shoqes në mëngjes,

Ajo shpejtoi me gazetën në duar.

— Jo — tha ai — Tani e tutje nuk ka më nevojë... Unë shikoj... Dielli që më ishte fshehur, ja ku po duket përsëri! Por, të lutem, sillmë një lapës e një fill letër, po munde.

Ajo e ngurosur habie, i solli.

Dhe ai me dorën, që i dridhej, me vështirësi i shkroi këto radhë të riut nga Boriza:

«I dashur shok!

Vdekja, nëpërmjet valës goditëse, të një mine, më rrëmbeu dritën e syve. Mjeku ma ktheu një pjesë të saj. Unë s'do ta harroj kurrë atë që bëri ai për mua. Po me aq

dritë, mendoja se s'mund t'i delja jetës përballë. Kështu, unë u mbylla në guaskën time. Po ti bëre për mua atë që s'arriti ta bënte në mënyrë të plotë mjekësia. Ti ma ktheve krejt dritën që kisha humbur. Dhe unë tani shoh. Shoh, ashtu sikurse sheh edhe ti. Ndaj, të falemnderit, shok! Nesër do të jem larg qytetit, prej nga po të shkruaj këtë letër. Shokët e mij janë ngjitur majave, për t'i çuar rrugën dhe dritën bjeshkëve të Kelmendit, gjer në pikën më të largët, të tyre, gjer në Vermosh. Dhe unë, për atje po nisem. Atje, ku mbeti Nika ynë! Atje, ku një lapidar si piramidë, u bën roje kufijve të shenjta të atdheut. Unë këtë radhë do ta shoh atë lapidar, të kthyer në piramidë. Do të shikoj Nikën, që s'ka për të vdekur kurrë.... Ndaj, edhe një herë të falemnderit për këtë që bëre për mua. Të tjerat, do të t'i shkruaj që andej.

Me dashuri,  
Gjergj Martini»

Dhe si e palosi atë letër: — Dërgoja! — i tha së shoqes.  
Dhe u nis...

— F U N D —



## PËRMBAJTJA

	Faqe
Sedra .....	5
Hendeku .....	11
E kaluara .....	17
Drejt majave .....	24
Duel me vdekjen .....	29
Ajo dhe ai .....	36
Rrafshnalta .....	41
Komandanti i njësisë .....	46
Vdekja e fillrojtësit .....	52
Në familje .....	68
Letra e hapur .....	74
Një ditë e paharruar .....	87
Përsëri majave .....	98
Një trup u gjet mbi borë .....	103
Kthimi .....	106
Për shokun, jetën .....	110
Fjala e shkencës .....	121
Pa dritën e syve .....	132
Male e njerëz si malet .....	135
Të faleminderit shok .....	147